

**UNIVERSITETI I EJL**  
**ЈИЕ УНИВЕРЗИТЕТ**  
**SEE UNIVERSITY**

**FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE BASHKËKOHORE**  
**ФАКУЛТЕТ ЗА СОВРЕМЕНИ ОПШТЕСТВЕНИ НАУКИ**  
**FACULTY OF CONTEMPORARY SOCIAL SCIENCES**

## **STUDIMET PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË**

### **TEZA:**

**“Marrëdhëniet ndëretnike në shoqëritë postkomuniste – Rasti i RMV dhe marrëdhëniet mes shqiptarëve etnikë dhe maqedonasve etnikë pas vitit 2001”**

**Kandidati:**

**VALON KURTISHI**

**Mentori:**

**Prof. dr. ETEM AZIRI**

**Tetovë, qershor, 2019**

## **Deklarata e ndershmërisë**

**Unë, Valon Kurtishi, student në studimet postdiplomike në Fakultetin e Shkencave Shoqërore Bashkëkohore të Universitetit të Europës Juglindore në Tetovë, me përgjegjësi të plotë morale dhe ligjore deklaroj se ky punim magjistrature është rezultat i punës sime hulumtuese dhe asnjë pjesë e tij nuk është marrë nga autorë të tjerë, në përjashtim të pjesëve që janë dhënë me referencat përkatëse.**

**Qershor, 2019**

**Tetovë**

**Valon Kurtishi**

---

## **Mentor**

**Prof. dr. Etem Aziri**

**Universiteti i Europës Juglindore në Tetovë**

## **Komisioni**

**Prof. dr. Etem Aziri**

**Universiteti i Europës Juglindore në Tetovë**

**Prof. dr. Memet Memeti**

**Universiteti i Europës Juglindore në Tetovë**

**Prof. dr. Agron Rustemi**

**Universiteti i Europës Juglindore në Tetovë**

## **Abstrakt**

Raportet etnike në shoqëritë shumetnike janë një tregues i rëndësishëm i funksionimit të tyre. Çështja është e rëndësishme së veçantë në shoqëritë postkomuniste, që pas aplikimit të pluralizmit dhe shoqërisë së tregut të lirë u ndodhën para sfidave sociale dhe ekonomike që iu shtuan atyre me karakter etnopolitik.

Në rastin e Maqedonisë së Veriut nga këto marrëdhënie varet edhe vetë ardhmëria e vendit si subjekt i pavarur në skenën ndërkombëtare.

Zgjidhja e gjetur nga ndërkombëtarët dhe palët gjatë vitit 2001 në formë të Marrëveshjes së Ohrit, nuk është implementuar në mënyrë të plotë e gjithëpërfshirëse as në vitin 2019.

Marrëdhëniet etnike këtu nuk janë në nivele të kënaqshme apo të akceptueshme, si pasojë e dominimit të grupit më të madh etnik, si dhe diskriminimit të vazhdueshëm të komunitetit të dytë më të madh. Edhe pse ky diskriminim sot paraqitet në një format të moderuar, prapëseprapë është omniprezent në shoqëri.

Barazia e plotë kushtetuese e maqedonasve dhe shqiptarëve është kushti kryesor i përmirësimit të raporteve etnike, i ruajtjes së kohezionit social dhe i ndërtimit të një shoqërie demokratike.

**Fjalë kyçe:** Marrëdhënie ndëretnike, Marrëveshje e Ohrit, 2001, diskriminim etnik, komunitete, Maqedoni e Veriut

## **Abstract**

The ethnic relations in multiethnic societies are an important indicator of their functioning. The question is of particular importance to former communist societies, who after the introduction of political pluralism and free market economy beside the existing ethno political conflicts, came in front of serious economic and social challenges.

In case of North Macedonia, upon those same relations rests the very future of the country as an independent entity in the international scene.

The 2001 solution found by the warring parties and the international community in the form of the Ohrid Framework Agreement, has not been fully implemented even as of 2019.

As a consequence of the domination from the past of the second community by the bigger ethnic group that albeit on a more moderate scale – still continues and is omnipresent in society today, the ethnic relations here are not at a satisfactory and acceptable levels.

The full constitutional equality of Macedonians and Albanians is the main condition for the improvement of the ethnic relations, for keeping the social cohesion in the country and for building a democratic society.

**Key words:** Inter Ethnic Relations, Ohrid Agreement, 2001, Ethnic Discrimination, Communities, North Macedonia

## **Përmbajtja**

Lista e tabelave .....	9
Lista e grafikëve.....	9

## **Hyrje**

1. Lënda e hulumtimit.....	13
2. Qëllimet e hulumtimit.....	14
3. Hipotezat.....	15
4. Metodologjia e hulumtimit .....	16
5. Rëndësia e punimit.....	16
6. Përfundimi.....	16

## **Kapitulli I**

### **Historia dhe evoluimi i identiteteve etnike në Maqedoninë e Veriut**

1.1 Shqiptarët dhe maqedonasit në Maqedoninë gjeografike përgjatë historisë.....	19
1.2 Grupet etnike në Maqedoninë e Veriut - pasqyrë demografike .....	29
1.2.1 Komuniteti maqedonas .....	29
1.2.2 Komuniteti shqiptar .....	29
1.2.3 Komuniteti turk.....	30
1.2.4 Komuniteti rom.....	30
1.2.5 Komunitetit serb.....	30
1.2.6 Komuniteti boshnjak.....	31
1.2.7 Komuniteti arumun (vllah) .....	31
1.2.8 Komunitetet e tjera.....	31

## **Kapitulli II**

### **Konflikti i vitit 2001 dhe zgjidhja në formë të MO**

2.1	Diskriminimi i komunitetit shqiptar dhe konfliktualiteti konstant ndëretnik 1991 – 2001 .	36
2.1.1	Kushtetuta e vitit 1991 si shkaktare e krizës ndëretnike.....	36
2.1.2	Diskriminimi politik .....	39
2.1.3	Diskriminimi institucional. Nënperfaqësimi i shqiptarëve në të gjitha nivelet e administratës .....	42
2.1.4	Diskriminimi në sistemin edukativ arsimor, kulturë.....	45
2.1.5	Diskriminimi socio-ekonomik .....	48
2.1.6	Dhuna policore dhe shkelja e lirive e të drejtave të njeriut.....	50
2.1.7	Rekapitullim për diskriminimin dhe marrëdhëniet ndëretnike në periudhën 1991 – 2001 .	53
2.2	Demarkacioni i kufirit verior si faktor iniciues i konfliktit. Rrënjët etnike të krizës maqedonase.....	55
2.2.1	Zhvillimi i ngjarjeve deri në nënshkrimin e Marrëveshjes së Ohrit .....	58
2.3	Marrëveshja Kornizë e Ohrit si një zgjidhje gjysmake për të dyja palët .....	62
2.4	Perceptimi shqiptar për Marrëveshjen e Ohrit .....	63
2.5	Perceptimi maqedonas për Marrëveshjen e Ohrit .....	64
2.6	Etniciteti si elementi kyç në kontekstin politik të RMV .....	65

## **Kapitulli III**

### **Marrëdhëniet mes dy komuniteteve kryesore pas vitit 2001**

3.1	Konfliktualiteti dhe tensionimi permanent .....	70
3.2	Implementimi i MO .....	72
3.2.1	Ndarja e re territoriale.....	72
3.2.2	Ligji për gjuhët.....	74
3.2.3	Çështja me simbolet shtetërore dhe kombëtare .....	75
3.2.4	Arsimi i lartë në gjuhën shqipe. Zyrtarizimi i UT .....	75
3.2.5	Përfaqësimi i drejtë dhe adekuat në bazë të MO.....	76
3.3	Mosbesimi i ndërsjellë mes shqiptarëve dhe maqedonasve.....	79
3.4	Faktori ndërkombëtar si deterrent mes palëve në konflikt të vazhdueshëm politik.....	81
3.5	Prospekte për të ardhmen e marrëdhënieve ndëretnike në RMV .....	84

## **Kapitulli IV**

Shpalosja e rezultateve nga hulumtimi i mendimit të qytetarëve .....	86
--	----

<b>Përfundime dhe rekomandime .....</b>	<b>111</b>
---	------------

<b>Bibliografia .....</b>	<b>115</b>
---------------------------	------------



## **Lista e tabelave**

**Tab. 1.** Pasqyrë e komuniteteve më të mëdha etnike sipas regjistrimeve konsektive të popullsisë 1948/1994

**Tab. 2.** Shuma e subvencioneve qeveritare për kulturë dedikuar rajoneve statistikore për vitin 2012

**Tab. 3.** Pasqyra tabelore krahasuese e përfaqësimit të maqedonasve dhe shqiptarëve në institucionet buxhetore për periudhën 2007-2013

## **Lista e grafikëve**

**Graf. 1.0** Komunitetet etnike në Maqedoni sipas regjistrimit të fundit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave nga viti 2002

**Graf 1.1** Krahasim i drejtpërdrejtë i totalit dhe përqindjeve të numrit të shqiptarëve dhe maqedonasve në Maqedoninë e Veriut në regjistrimet e viteve 1948 – 2002

**Graf 2.0** Struktura gjinore – Shqiptarë: 250 meshkuj dhe 250 femra

**Graf 2.0** Struktura gjinore – Maqedonas: 100 meshkuj dhe 100 femra

**Graf. 2.1** Mosha - shqiptarët

**Graf. 2.1** Mosha - maqedonasit

**Graf. 2.2** Vendbanimi – shqiptarët

**Graf. 2.2** Vendbanimi – maqedonasit

**Graf 2.3** Në vendbanimin ku jetoni a ka pjesëtarë të komuniteteve të tjera etnike? (Maqedonas)

**Graf. 2.3** Në vendbanimin ku jetoni a ka pjesëtarë të komuniteteve të tjera etnike? (Shqiptarë)

**Graf. 2.4** A e flisni gjuhën maqedonase? (Shqiptarë)

**Graf. 2.4** A e flisni gjuhën shqipe? (Maqedonas)

**Graf. 2.5** Cilën gjuhë tjetër preferoni ta mësoni në shkollë? (Shqiptarë)

**Graf. 2.5** Cilën gjuhë tjetër preferoni ta mësoni në shkollë? (Maqedonas)

**Graf. 2.6** A e mësoni gjuhën dhe letërsinë maqedonase si obligative në shkollën tuaj? (Shqiptarë)

**Graf. 2.6** A e mësoni gjuhën dhe letërsinë shqipe si obligative në shkollën tuaj? (Maqedonas)

**Graf. 2.7** A keni shokë/shoqe pjesëtarë të komuniteteve tjera etnike? (Shqiptarë)

**Graf. 2.7** A keni shokë/shoqe pjesëtarë të komuniteteve tjera etnike? (Maqedonas)

**Graf. 2.8** A frekuentoni lokale ku dominojnë të rinjtë/rejat nga komuniteti tjetër? (Maqedonas)

**Graf. 2.8** A frekuentoni lokale ku dominojnë të rinjtë/rejat nga komuniteti tjetër? (Shqiptarë)

**Graf. 2.9** A do kishit participuar ju personalisht në skuadra sportive maqedonase? (Shqiptarë)

**Graf. 2.9** A do kishit participuar ju personalisht në skuadra sportive shqiptare? (Maqedonas)

**Graf. 3.0** A do bënit tifo për klube sportive maqedonase? (Shqiptarë)

**Graf. 3.0** A do bënit tifo për klube sportive shqiptare? (Maqedonas)

**Graf. 3.1** Për cilën kombëtare bëni tifo ju personalisht? (Shqiptarë)

**Graf. 3.1** Për cilën kombëtare bëni tifo ju personalisht? (Maqedonas)

**Graf. 3.2** A do pranoni të jeni pjesë e ndonjë subjekti politik maqedonas? (Shqiptarë)

**Graf 3.2** A do pranoni të jeni pjesë e ndonjë subjekti politik shqiptar? (Maqedonas)

**Graf. 3.3** A do kishit votuar për një kandidat maqedonas si deputetin tuaj në zgjedhjet parlamentare? (Shqiptarë)

**Graf. 3.3** A do kishit votuar për një kandidat shqiptar si deputetin tuaj në zgjedhjet parlamentare? (Maqedonas)

**Graf. 3.4** A do ishit martuar me maqedonas/maqedonase etnik? (Shqiptarë)

**Graf. 3.4** A do ishit martuar me shqiptar/shqiptare etnik? (Maqedonas)

**Graf. 3.5** Çfarë mendimi keni për popullin dhe kulturën maqedonase përgjithësisht? (Shqiptarë)

**Graf. 3.5** Çfarë mendimi keni për popullin dhe kulturën shqiptare përgjithësisht? (Maqedonas)

**Graf. 3.6** A u besoni përgjithësisht institucioneve shtetërore në Maqedoni? (Shqiptarë)

**Graf. 3.6** A u besoni përgjithësisht institucioneve shtetërore në Maqedoni? (Maqedonas)

**Graf. 3.7** A mendoni që në Maqedoni ka diskriminim në baza etnike? (Shqiptarë)

**Graf. 3.7** A mendoni që në Maqedoni ka diskriminim në baza etnike? (Maqedonas)

**Graf. 3.8** A ka dominim nga grupi më i madh etnik maqedonas ndaj atij më të vogël shqiptar? (Shqiptarë)

**Graf. 3.8** A ka dominim nga grupi më i madh etnik maqedonas ndaj atij më të vogël shqiptar? (Maqedonas)

**Graf. 3.9** Në cilin sektor mendoni që ka më së shumti diskriminim në baza etnike? (Shqiptarë)

**Graf. 3.9** Në cilin sektor mendoni që ka më së shumti diskriminim në baza etnike? (Maqedonas)

**Graf.4.0** A mendoni se marrëdhëniet ndëretnike në një të ardhme të afërt mund të përkeqësohen dhe të çojnë në konflikt të hapur? (Shqiptarë)

**Graf.4.0** A mendoni se marrëdhëniet ndëretnike në një të ardhme të afërt mund të përkeqësohen dhe të çojnë në konflikt të hapur? (Maqedonas)

**Graf. 4.1** Mendoni që mundësia e ndarjes së vendit në baza etnike është akoma sot reale? (Shqiptarë)

**Graf. 4.1** Mendoni që mundësia e ndarjes së vendit në baza etnike është akoma sot reale? (Maqedonas)

**Graf. 4.2** Mendoni që anëtarësimi i Maqedonisë së Veriut në BE dhe në NATO do t'i ulë tensionet etnike në vend? (Shqiptarë)

**Graf. 4.2** Mendoni që anëtarësimi i Maqedonisë së Veriut në BE dhe në NATO do t'i ulë tensionet etnike në vend? (Maqedonas)

**Graf.4.3** A duhet qeveria të ndërmarrë fushata kundër diskriminimit në baza etnike? (Shqiptarë)

**Graf. 4.3** A duhet qeveria të ndërmarrë fushata kundër diskriminimit në baza etnike? (Maqedonas)

# Hyrje

## 1. Lënda e hulumtimit

Lëndë hulumtimi në këtë punim janë marrëdhëniet midis shqiptarëve etnikë në Maqedoninë e Veriut dhe sllavëve etnikë të quajtur maqedonas në periudhën e paskonfliktit të armatosur të vitit 2001 deri në ditët e sotme.

Këto marrëdhënie dhe kontakte në jetën e përditshme mes individëve të etnive të ndryshme si dhe mes grupeve në jetën shoqërore mund të marrin forma bashkëpunimi apo konflikti, varësisht nga botëkuptimet, rrethanat shoqërore, planet, intencat dhe qëllimet e grupeve në fjalë.

Në këtë punim do të analizohet dinamika e raporteve midis komunitetit maqedonas dhe shqiptar pas nënshkrimit të MO, si dhe ndryshimeve kushtetuese konsekuative. Materiali do të japë argumente në favor të rrëzimit të tezës së shumëpërhapur mes studiuesve maqedonas për vendin si një shembull për respektimin e të drejtave të kolektiviteteve joshumicë, e cila që në nismë duket e gabuar.

Një diskurs tjetër akademik në lidhje me përmirësimin e dukshëm të pozitës së shqiptarëve dhe përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike pas vitit 2001, duket të mos jetë i qëndrueshëm dhe në mospërputhje të plotë me kërkesat dhe vullnetin e popullsisë shqiptare dhe përfaqësuesve të saj politikë.

Marrëdhëniet ndëretnike mbeten të tensionuara edhe 18 vjet pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje paqësore.

Demokratizimi në shoqëritë shumetnike është një proces më i vështirë dhe më i ndërlikuar se në shoqëritë më homogjene në aspekt etnik, të cilat tregohen më stabile në periudha afatgjata.

Megjithatë, Maqedonia e Veriut duhet të gjejë forca për të arritur një modus vivendi mes dy grupeve të mëdha etnike, në mënyrë që të arrijë nivele të kënaqshme demokratizimi, të cilat do ta bëjnë të gatshme për integrim evropian. Kjo është mënyra e vetme që ajo të ndërtojë institucione funksionale shtetërore dhe të mbijetojë si shoqëri e pavarur në korrelacionin ballkanik të forcave.

## 2. Qëllimet e hulumtimit

Punimi në fjalë do të shpalojë një numër të objektivave në pajtim me hipotezën e paraqitur në fillim.

Objektivi themelor i hulumtimit është të vërtetojë hipotezën kryesore se marrëdhëniet ndëretnike në vend nuk janë në nivele të duhura dhe madje shpeshherë këto marrin formë të një tensionimi të lartë, i cili kërcënon të kalojë në konflikte të pakontrolluara midis grupeve.

Një qëllim i dytë i punimit në fjalë është të vërtetojë se pa barazi të plotë politike, nacionale, ekonomike, kulturore dhe sociale në përgjithësi, marrëdhëniet mes komunitetit shqiptar dhe atij maqedonas do të jenë gjithmonë të tensionuara. Duke u karakterizuar nga keqkuptimet, mosmarrëveshjet dhe konfliktet e mundshme, ato do të bëhen pengesë për demokratizimin e vendit. Kjo, nga njëra anë, do të bllokojë shoqëritë maqedonase dhe shqiptare, e nga ana tjetër, edhe rrugën eurointegruese.

Punimi do të ofrojë edhe material të mjaftueshëm në lidhje me perceptimin që opinioni publik, elitat dhe qytetarët e dy grupeve më të mëdha etnike kanë për Marrëveshjen kornizë të Ohrit si një kornizë ligjore mbi të cilin ngritët dhe shihet e ardhmja e vendit.

Duke dhënë shpjegime të argumentuara lidhur me formësimin e identiteteve kombëtare të komuniteteve, do të japë orientime të mundshme për të ardhmen e marrëdhënieve dhe raporteve në shoqëri.

### **3. Hipotezat**

#### **Hipoteza kryesore**

1. Marrëdhëniet ndëretnike në RMV pas nënshkrimit të MO vazhdojnë të karakterizohen nga një gjendje e tensionimit permanent, shkaku i diskriminimit sistematik të shqiptarëve nga institucionet shtetërore që vazhdojnë të dominohen mbiproporcionalisht nga maqedonas etnikë.

#### **Hipotezat ndihmëse**

1. Shtresa të gjera të komunitetit shqiptar, si dhe shumica e partive politike shqiptare, në raste edhe nga radhët e vetë partnerëve qeveritarë të maqedonasve, nuk janë të kënaqur me pozitën kushtetuese-juridike dhe socio-ekonomike të shqiptarëve sot.
2. Komuniteti maqedonas, si dhe gjithë strukturat politikisht aktive që e përfaqësojnë atë, çdo përpjekje politike për avancimin e pozitës kushtetuese të shqiptarëve, e kupton dhe e percepton si rrezik për karakterin unitar, integritetin territorial të shtetit, si dhe për ardhmërinë e vet nacionale.
3. Një pjesë e madhe e qytetarëve maqedonas shtetin e sotëm të pavarur të RMV e percepton ekskluzivisht si shtet nacional të kombit maqedonas, ku jetojnë një numër i caktuar pakicash tjera etnike që shijojnë të drejta të gjera kombëtare.

## **4. Metodologjia e hulumtimit**

Në këtë punim janë përdorur më shumë metoda dhe teknika hulumtimi dhe atë: Metoda e analizës dhe sintezës, metoda krahasuese, ajo historike, statistikore, intervista dhe anketimi.

## **5. Rëndësia e punimit**

Punimi ka një sinjifikancë të natyrave të ndryshme dhe për shtresa të ndryshme të grupeve shoqërore.

Punimi mund të zbulojë mangësitë e sistemit aktual maqedonas i cili nuk është i aftë të ndërtojë raporte normale mes grupeve të ndryshme etnike. Duke zbuluar shkaqet e tensionimit dhe konfliktualitetit të vazhdueshëm me motivacion etnik, ai mund të ofrojë ide të qarta për një shtensionim të mundshëm apo përpjekje të kësaj natyre në të ardhmen.

Menaxherët e sistemit politik mund të shfrytëzojnë çdo të dhënë sado modeste qoftë, në drejtim të gjetjes dhe aplikimit të zgjidhjeve adekuate për problemet me sfond etnik. Në këtë kuptim, punimi ka rëndësi aplikative apo praktike.

Rëndësia aplikative e këtij punimi qëndron në atë se rezultatet e punimit do të jenë në dispozicion si për elitat politike, ashtu dhe për shkencëtarët, teoricienët dhe opinionin më të gjerë.

Një element tjetër i rëndësishëm është nxitja që ky hulumtim do të ketë dhe duhet të ketë për kandidatë të tjerë që të studiojnë raportet etnike, etnicitetin, identitetet nacionale, çështjet etnike etj, që janë në qendër të dinamikës së brendshme shoqërore në RMV.

## **6. Përfundimi**

Punimi do të mbyllet me vërtetimin e hipotezave të vendosura në fillim, qoftë të hipotezës kryesore apo edhe të atyre ndihmëse. Është perceptim i përgjithshëm që demokracia nuk mund të funksionojë në shoqëritë shumetnike. Këtë tezë të John Stuart Mill duket se e vërteton më së miri historia dhe praktika mëse 30 vjeçare e ndërtimit dhe funksionimit të shtetit të RMV.

I filluar si eksperiment jugosllav dhe i vazhduar për inerci edhe pas shpërbërjes së Jugosllavisë socialiste, shteti maqedonas karakterizohet nga marrëdhënie aspak të mira ndëretnike si pasojë e përpjekjes për mbisundim të një komuniteti mbi komunitetin e dytë më të madh.



Marrëveshja e Ohrit, e cila u duk si një armëpushim i përkohshëm mes grupeve, akoma nuk është realizuar në tërësinë e saj as pas 18 viteve të nënshkrimit dhe hyrjes në fuqi në trajtën e ndryshimeve kushtetuese.

Kjo dhe shumë sfida tjera të natyrave etnike bashkë me pengesat sa të arsyeshme aq edhe të paarsyeshme nga jashtë, bëjnë që e ardhmja e vendit të mos jetë aspak rozë dhe e sigurtë.

Duket se një rirregullim definitiv i raporteve kushtetuese dhe territoriale mes shqiptarëve dhe maqedonasve bashkë me një demokratizim transparent, të plotë dhe human është shpëtimi dhe zgjidhja e vetme për përmirësimin e relacioneve ndëretnike, për mbijetesën fizike të shtetit dhe për integrimin në Bashkimin European dhe në Aleancën veriatlantike.

- 1.1.1 Shqiptarët dhe maqedonasit në Maqedoninë gjeografike përgjatë historisë
- 1.1.2 Grupet etnike në Maqedoninë e Veriut - pasqyrë demografike
- 1.1.3 Komuniteti maqedonas
- 1.1.4 Komuniteti shqiptar
- 1.1.5 Komuniteti turk
- 1.1.6 Komuniteti rom
- 1.1.7 Komunitetit serb
- 1.1.8 Komuniteti boshnjak
- 1.1.9 Komuniteti arumun (vllah)
- 1.1.10 Komunitetet tjera

# Kapitulli I

## Historia dhe evoluimi i identiteteve etnike në Maqedoninë e Veriut

### 1.1 Shqiptarët dhe maqedonasit në Maqedoninë gjeografike përgjatë historisë

Maqedonia gjeografike është një provincë relativisht e madhe në Europën juglindore. Pozita e volitshme gjeografike si një udhëkryq i rrugëve nga Europa në Azinë e vogël dhe anasjelltas, ka bërë që të ketë një histori të pasur dhe turbulente duke shërbyer si vendqëndrim i përkohshëm apo edhe i përhershëm për popuj, kultura e qytetërime të shumta. Territori që në fillimet e historisë së njohur apo të shkruar është emërtuar me këtë emër, merret të jetë kufizuar nga malet e Sharrit në pjesët veriperëndimore, Mali i Zi i Shkupit gjer në territorin e Bullgarisë së sotme në lindje. Në jug kufijtë kanë shkuar gjer në zonat e sotme veriore të Greqisë me kufij përfundimtarë në detin Egje. Kufijtë perëndimorë të Maqedonisë antike përkonin deri diku me vijën aktuale të kufirit me Shqipërinë.

Gjithsesi, është e domosdoshme të potencojmë që në fillim që kufijtë e këtyre të Maqedonisë të dhënë nga autorë të hershëm evropianë, janë krejtësisht gjeografikë dhe administrativë për periudha të caktuara të pushtetit antik maqedonas apo romak dhe pa asnjë lidhje apo konotacione etnike të periudhave më të vonshme historike. Ato që njihen si identitete nacionale apo etnike moderne këtu, janë formuar më vonë nën ndikimin e faktorëve të ndryshëm politikë, ekonomikë, kulturorë dhe tjerë që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me emërtimin historik të territorit në fjalë.

Maqedonia e parë nga një këndvështrim i pastër gjeografik në periudha të ndryshme historike është banuar nga fise e popuj të shumtë si dhe ka qenë pjesë përbërëse e formacioneve të ndryshme e më të mëdha politike. Është një e kaluar e pasur me ngjarje e dukuri të shumta e cila vjen si e tillë gjer në ditët e sotme, kur vendi me emër të tillë është një nga shtetet e vogla të pavarura ballkanike.

Në periudhat e hershme të neolitit njihen kulturat e quajtura të Porodinit që janë të lidhura ngushtësisht edhe me kultura të Shqipërisë së sotme jugore<sup>1</sup>. Zhvillimi i mëtejshëm shoqëror historik i popullsive të këtushme duket të ketë qenë i lidhur ngushtësisht me atë që më vonë do të njihet si treva e banuar nga shqiptarët në Europën juglindore. Si banorë më të hershëm këtu të njohur me etnonimin e tyre të qartë janë ata që njihen si popullatat e hershme ballkanike, ilirët dhe maqedonasit antikë. Popullsia ilire shtrihej kryesisht në atë që sot është pjesa perëndimore e vendit, mes rrjedhës së Drinit të zi në perëndim dhe lumit Vardar në lindje. Këtë e kanë potencuar në shkrimet e tyre edhe autorë jugosllavë si Lahtov, të cilët janë të mendimit që

---

<sup>1</sup> Meshihati i BI në RM, Shqiptarët e Maqedonisë, Shkup, 1994, faqe 23

shumica dërmuese e popullsisë së shtetit antik maqedonas duhet të ketë qenë me përkatësi etnike ilire<sup>2</sup>.

Në këto pjesë kanë banuar edhe fise të tjera të cilat nga autorë të ndryshëm shihen si pjesë të korpusit etnik ilir kurse me raste si fise të pavarura. Këto janë pajonët ose peonët, maqedonasit dhe trakasit. Duhet thënë që gjuha e folur e fiseve antike maqedone nuk ka qenë greqishtja. Maqedonishtja e vjetër ka bërë pjesë në grupin e gjuhëve të vjetra paleoballkanike në lidhje të ngushta me ilirishten dhe trakishten. Këtë e ka pranuar edhe autori i antikës Tukididi (Thucydides), sipas të cilit maqedonasit dhe epirotët nuk dallojnë prej barbarëve të tjerë<sup>3</sup>. Termi ‘barbaroi’ është përdorur në veprat e autorëve të hershëm grekë për të evidentuar përkatësinë etnike jo greke të popullsisë të caktuara kufitare me botën greke. Qarqet sunduese greke të kohës janë ndjerë superiorë kulturalisht dhe nuk kanë pranuar si pjesë të civilizimit mbizotërues të kohës elemente etnike jogreke si maqedonasit, ilirët, peonët apo trakasit. Për maqedonasit e vjetër kjo pikëpamje ruhet gjer në periudhën e sundimit të mbretit të njohur, të atit të Aleksandrit të madh, Filipit të dytë. Prej kësaj periudhe historike, Polibi i quan maqedonasit tashmë grekë në kuptim etnik<sup>4</sup>. Duket që popullsitë jugore ballkanike, në radhë të parë maqedonasit, epirotët dhe një pjesë e fiseve jugore ilire janë ndikuar më shumë se fiset veriore nga kultura helene duke u asimiluar në masë të caktuar në atë kulturë.

Në shekujt VI dhe VII e gjithë zona romake e pushtimit në lindje përballet me atë që në histori njihet si dyndja apo kolonizimi i madh me popullsi të reja sllave. Këto dyndje që duhet të kenë filluar që në shekullin e VI<sup>5</sup>, sollën me vete shkatërrime e dëme të shumta duke përmbytur territoret e banuara nga fiset ilire, maqedonase, trakase dhe epirote nga Istria në veri e deti Adriatik e Jon në perëndim, deri në muret e Selanikut në detin Egje në jug. Kulturat dhe traditat e elementëve etnikë autoktonë pësuan dëme të mëdha e të pariparueshme. Ishte një përmbyseje e përmasave biblike e cila ndryshoi përgjithmonë strukturën e vjetër etnike duke vendosur një substrat të ri kulturor në mbarë gadishullin Ballkanik. Prej kësaj periudhe historike fillojnë të përmenden edhe fise të ndryshme sllave të cilët kolonizojnë pjesë të mëdha të Maqedonisë gjeografike.

Duhet thënë që ngulitjet e banorëve të rinj sllavë në masë të madhe mbetën jashtë territoreve ku formohet popullsia etnike arbër nga mbetjet e dikurshme ilire. Gjetjet arkeologjike në Shqipërinë e sotme politike, në territorin e Kosovës, Maqedonisë perëndimore dhe Malit të Zi jugor, flasin për një vazhdimësi të strukturës ilire të popullsisë në këto vende<sup>6</sup>. Popullsia shqiptare formohet kryesisht në territoret e sipërpërmendura duke u bazuar në atë që në histori njihet si kultura e

---

<sup>2</sup> Lahtov, V, Problem Trebeniske kulture, Ohrid, 1965, faqe 175; cituar nga: Shqiptarët e Maqedonisë, Shkup, 1994, faqe 22

<sup>3</sup> Dr. Arsim Spahiu, Iliriciteti i maqedonasve dhe epirotëve, Tiranë, 2006, faqe 48

<sup>4</sup> Aleksandër Stipceviq, Ilirët – historia, jeta, kultura, Prishtinë, 1980, faqe 39

<sup>5</sup> Kristo Frashëri, E vërteta mbi Shqiptarët e Maqedonisë, Botime Dudaj, Tiranë, 2010, faqe 12

<sup>6</sup> Kristo Frashëri, Historia e qytetërimit shqiptar (Nga kohët e lashta deri në fund të Luftës së Dytë Botërore), Tiranë, 2008, Faqe 54

Komanit nga gjetjet në Shqipërinë e sotme veriore. Kultura e Komanit ka ngjashmëri me një sërë kulturash tjera që shtrihen në ose ngjitur me territoret në Europën juglindore ku sot jetojnë shqiptarët. Me atë ajo është prova më e mirë e autoktonisë ilire dhe kontinuitetit historik të popullsisë të vjetra ilire drejt atyre arbër në mesjetën e hershme.

Zonat lindore nga ana tjetër, popullohen nga një masë e madhe e popullsisë sllave e cila shtrihet gjer në Selanik në jug të Maqedonisë gjeografike. Njihen një numër i fiseve sllave që populluan këto territore si vajunitët dhe berzitët në Maqedoninë lindore apo sagudatët, runcinët, draguvitët, smolienët në zonat etnike trakase<sup>7</sup>. Është interesante për tu përmendur tej pretendimeve tendencioze dhe joshkencore të historianëve të caktuar vendës, që një numër i autorëve të huaj janë objektivë dhe nuk japin emra të fiseve sllave për pjesën perëndimore të Maqedonisë së sotme politike. Kjo vlen sidomos për periudhën e hershme të ardhjes së këtyre bashkësive të mëdha në gadishullin ballkanik. Kështu, Andrew Rossos flet vetëm për një prej këtyre fiseve që sipas tij vendoset në veriperëndim të Maqedonisë, berzitët<sup>8</sup>, ndërsa tjerët shtrihen kryesisht në zonat lindore të gjeografisë të vendit.

Pikërisht nga një zonë e tillë me prapavijë kulturore sllavishtfolëse përreth Selanikut mbretëror, dolën edhe shenjtoret e njohur Kirili dhe Metodi, dy nëpunës bizantinë që kanë një rol dhe peshë të madhe për kulturën sllave dhe atë ballkanike përgjithësisht. Duket që Perandoria bizantine e interesuar për paqe, rend dhe qetësi në zonat e sapokolonizuara nga këto popullsi të reja për të cilat kultura greke ishte e huaj, ka arritur nëpërmjet misionit të dy shenjtoreve në fjalë pacifikimin e përkohshëm të masave sllave me anë të konvertimit në krishterimin bizantin. Shenjtoret Kirili dhe Metodi mblodhën dhe kodifikuan dialektet sllave të zonës në një gjuhë që më vonë u quajt sllavishte kishtare ose bullgarishte e vjetër<sup>9</sup>.

Një punë e madhe në këtë drejtim u bë me zhvillimin e Ohrit si qendër kulturore dhe kishtare për këtë pjesë të vendit. Këtu me gjithë rëndësinë dhe peshën që ka kjo zonë në kulturizimin e popullsisë sllave, duhet kujtuar që krishterimi ka rrënjë shumë më të hershme se shekulli IX dhe se ndikimi dhe kontributi i popullsisë autoktone shqiptare është i konsiderueshëm. Ai del në pah jo vetëm në aktin madhor të pagëzimit të mbretit dhe popullit bullgar në Balsh në shekullin e IX, por edhe më herët. Studiuesi shqiptar Dhimitër Shuteriqi ka gjetur në një prej kishave të Ohrit emrin e shenjtorit Gjon në formën “Gyion”, që tregon një prejardhje të qartë prej shqipes së hershme apo parashqipes<sup>10</sup>. Pra kontributi i kulturës shqiptare në këto zona jugore të Maqedonisë duhet të jetë më i gjerë se çështë menduar apo mëtuar deri sot.

---

<sup>7</sup> ASH e RPS të Shqipërisë, Konferenca kombëtare për formimin e popullit shqiptar, të gjuhës dhe kulturës së tij, Tiranë, 1988, faqe 55

<sup>8</sup> Andrew Rossos, Macedonia and the Macedonians. A History, Stanford, California, 2008. (Versioni online marrë nga: [research.policyarchive.org/11853.pdf](http://research.policyarchive.org/11853.pdf)), faqe 25

<sup>9</sup> Hugh Poulton, Who are the Macedonians, second edition, revised, 2000, faqe 19

<sup>10</sup> Monika Shoshori Stafa, Çështja e Shën Naumit, studim historiografik dokumentues, Tiranë, 2008, faqe 20

Zhvillimi i jetës kishtare dhe kulturore në gjuhën amtare bëri që popullsitë sllave të këtyre zonave të mos greqizohen dhe të zhvillojnë një identitet gjuhësor, kulturor dhe kishtar të ndryshëm nga ai i kulturës mbizotëruese bizantine që zhvillohej në greqishten zyrtare perandorake. Alfabeti i hershëm kishtar sllav ishte pararendës i zgjimit dhe iluminizimit të popullsisë sllave, qofshin ato bullgare në zonat më lindore të arealit etnik por jo detyrimisht maqedonase në zonat perëndimore në një kuptim paramodern të identitetit kombëtar. Zhvillimi i këtillë bëri që tek popullsitë sllave lindore të zhvillohej ndjenja shtetformuese që mori trajtë të Mbretërisë së parë bullgare në shekullin IX, e cila u zgjerua edhe në territoret e Maqedonisë së sotme duke pushtuar qytete të tilla si Ohri me Kryepeshkopatën historike në të.

Pushtimi bullgar i cili depërtoi thellë në perëndim deri në detin Adriatik, ishte përgjegjës për një numër të madh të toponimeve bullgare që gjenden gjithandej rajoneve të Ballkanit perëndimor ku shumicën e popullsisë e përbëjnë sot shqiptarët apo edhe maqedonasit<sup>11</sup>. Gjithsesi, kjo s'ka të bëjë me përkatësitë etnike të popullsisë të nënshtruara të cilat mbetën po atë që kishin qenë më herët. Duhet thënë që në mesjetë vihet re një simbiozë e fiseve sllave lindore që themeluan mbretërinë bullgare dhe atyre sllavëve që banonin në lindje të Vardarit, të cilët më vonë evoluuan në një identitet të veçantë nacional maqedonas. Është fakt i gjithëpranuar që dallimet mes bullgarishtes së vjetër dhe dialekteve që përdornin fiset sllave në pjesët lindore të Maqedonisë së sotme nuk ishin të rëndësishme, edhe pse ekzistente<sup>12</sup>. Në fakt, ka dy rryma kryesore pretendente të së vërtetës historike në lidhje me gjuhën apo gjuhët e përdorur nga shenjtorët Kirili dhe Metodi në fillimet e misionit të tyre. E para që e përcakton qartazi gjuhën e shkruar si bullgarishte të vjetër ndërsa tjetra që e jep atë si maqedonishte të vjetër.

Në fund të shekullit X dhe fillim të shekullit XI, dobësimi i autoritetit qendror bullgar çoi në pavarësimin e fisnikërisë së periferive. Ky ishte faktori bazë i formimit të mbretërisë së quajtur maqedonase të Samuilit e cila u shpërbë në përballje me bizantinët. Ishte kjo një mbretëri shumëetnike e përbërë nga shqiptarë autoktonë të pjesëve perëndimore të Maqedonisë, sllavë të Maqedonisë lindore si dhe popullsi tjera mesjetare që autoritetet mbretërore sollën atje.

Shkatërrimi i fuqisë bullgare nxori në skenë klasën feudale serbe. Kështu, territoret e Maqedonisë së sotme kaluan në duart e princave e mbretërve serbë, më i njohuri prej të cilëve, Dushani më 1331, u kurorëzua në Shkup perandor i serbëve, grekëve, bullgarëve dhe shqiptarëve<sup>13</sup>. Është interesante mungesa e etnonimit maqedonas në titullin perandorak të Dushanit, për më tepër që një ngjarje e tillë me peshë politike dhe kishtare realizohej në Shkup. Kjo tregon edhe për një ndjenjë të munguar nacionale maqedonase të pavarur ose ndarë nga ajo bullgare të popullsisë sllave të asaj kohe në Maqedoni, si dhe pamundësinë për të ndërtuar subjekte të pavarura shtetërore në mesjetë. Është e vërtetueshme prania në kontinuitet e popullsisë shqiptare në zonat perëndimore të vendit. Ekzistojnë dokumente të shumta nga shekujt

<sup>11</sup> Frashëri, vepra e cituar, faqe 64

<sup>12</sup> Tosho Popovski, Makedonskoto nacionalno malcinstvo vo Bugarija, Grcija i Albanija, Skopje, 1981, faqe 12

<sup>13</sup> Jasminka Udovicki dhe James Ridgeway, Makthi etnik i Jugosllavise, Tiranë, 1998, faqe 32

XIV dhe XV qe e vërtetojnë këtë, sidomos për rrethet e Tetovës, Gostivarit apo edhe Strugës. Nga ana tjetër, evolucioni fonetik i një numri të madh të emërvendeve si Shkupi, Shtipi, Sharri dhe tjera që është në pajtim me ligjet fonetike të shqipes flet për praninë e padiskutueshme të shqiptarëve në këto vise të Maqedonisë gjeografike<sup>14</sup>.

Formimi i formacionit të parë politik arbën, shtetit të Arbërit kishte një rëndësi të madhe për forcimin e identitetit të veçantë kulturor të popullsisë shqiptare. Edhe pse ky shtet ishte jetëshkurtër dhe nuk arriti të zgjerohet në lindje aq sa të përfshijë edhe territore të banuara nga popullsia shqiptare në perëndim të Maqedonisë, prapëseprapë kontribuoi në mënyrë të dukshme në forcimin e ndjenjave kolektive tek elementi shqiptar këtu.

Me gjithë pushtimet e përkohshme serbe dhe bullgare, provinca historike e Maqedonisë mbeti pjesë e Bizantit deri në pushtimin final nga Perandoria otomane më 1389<sup>15</sup>. Autoritet e reja otomane sollën me vete një botëkuptim krejtësisht të ri aziatik të rregullimit të raporteve shtetërore si dhe atyre private. Një pjesë e konsiderueshme e popullsisë u largua për në veri, shqipfolës dhe sllavishtfolës bashkë. Pjesa e mbetur u detyrua t'ju përshtatet rrethanave të reja sociale duke pranuar madje edhe ndryshimin e religjionit me një të ri të ardhur me pushtetin otoman. Popullsia e pushtuar e ndodhur në një gjendje të rëndë tentoi në disa raste çlirimin me anë të rebelimit të armatosur. Janë të njohura përpjekjet të cilat u bënë gjatë luftërave austro – turke në shekujt XVII dhe XVIII. Duhet thënë këtu që të dy komunitetet historike u përpoqën për çlirim kombëtar nga pushtuesi i huaj. Tezat për shqiptarët si shërbëtorë të pushtuesve otomanë që shërbyen për të nënshtruar popullsinë autoktone maqedonase nuk janë objektive dhe nuk mund të merren si serioze. Gjithashtu, përpjekja për të arsyetuar prezencën masive të shqiptarëve në pjesët perëndimore të vendit nuk mund të shpjegohen me tezat e kolonizimit të shqiptarëve myslimanë nga perëndimi në Maqedoni<sup>16</sup>.

Kundër këtyre tezave të çuditshme të kohërave moderne dëshmojnë edhe vetë dokumentet e autoriteteve mesjetare shtetërore serbe në këto treva. Prezenca masive shqiptare duket nga krisobulat e famshme mesjetare që i lëshonin mbretërit serbë të kohës për manastiret e ndryshme ortodokse që gjendeshin në zonat perëndimore të Maqedonisë<sup>17</sup>. Prej tyre dhe jo vetëm del qartë që shqiptarët kanë një prezencë historike në kontinuitet në këto territore. Edhe gjatë periudhës otomane, shqiptarët në përpjekjet e tyre të vazhdueshme për të larguar sundimin e huaj kontribuan edhe në vetëdijesimin dhe çlirimin e popullsisë sllavishtfolëse.

Gjatë shekullit të XIX në vëmendjen e opinionit europian ishte çështja e quajtur, “lindore”. Çlirimi dhe shtetformimi i popujve grekë, serbë dhe bullgarë bëri që të dalë me forcë në pah

<sup>14</sup> Meshihati i BI në RM, vepra e cituar, faqe 48

<sup>15</sup> Risto Stefov, Very Short History of the Macedonian People From Prehistory to the Present, Toronto, 2008, e – book), faqe 22. (<http://www.pollitecon.com/html/ebooks/risto-stefov/Very-Short-History-of-the-Macedonian-People.pdf>)

<sup>16</sup> Jovan Trifunovski, Albansko Stanovnistvo u Makedoniji, Beograd, 1988, faqe 14.

<sup>17</sup> Nijazi Muhamedi, red: Maqedonia shqiptare në dritën e teksteve dhe dokumenteve historike, Vëllimi I, Tetovë, 2009, faqe 44

çështja shqiptare dhe ajo maqedonase. Në këtë periudhë pati disa lëvizje rebeluese si tek shqiptarët ashtu edhe tek maqedonasit. Kryengritja e njohur e Dervish Carës pati një përhapje të gjerë gjer në viset veriore apo edhe jugore shqiptare të Shqipërisë së sotme.<sup>18</sup> Lëvizje të ngjashme rebeluese pati edhe në Maqedoninë lindore ku bien në sy lëvizjet e Razlogut dhe Kresnës, më 1876 dhe 1878 përkatësisht. Pikërisht në këtë periudhë, monarkitë ballkanike të interesuara për ekspansion territorial i drejtuan sytë e tyre drejt Shqipërisë dhe Maqedonisë gjeografike. Në këtë drejtim, qarqet pushtetare ballkanike filluan propagandat e tyre në gjirin e popullsisë sllave të Maqedonisë. U hapën një numër i madh shkollash serbe, bullgare dhe greke për bashkësitë maqedonase. Prania e shkollave dhe kishave respektive ballkanike në territore të caktuara, shënjonte edhe përkatësinë etnike të banorëve në fjalë.

U shtua edhe veprimtaria e bandave të armatosura të shteteve ballkanike në Maqedoni nga përplasjet e të cilave e pësonte popullsia civile maqedonase por edhe ajo shqiptare. Bashkësia maqedonase në këto kohë të vështira u vu para zgjedhjes së ndonjëres prej shkollave apo kishave prezente në vend, bullgare, serbe dhe greke<sup>19</sup>. Duket që shumica e popullsisë bënte pjesë në kishën apo Ekzarkatin bullgar duke paravendosur kështu në njëfarë mënyrë edhe përkatësinë e vet nacionale. Edhe një pjesë e shqiptarëve ortodoksë ishin nën presion për të bërë zgjedhjen e njëjtë. Shqiptarët myslimanë nga ana tjetër regjistroheshin me automatizëm si turq duke pasur për bazë sistemin otoman të mileteve që nuk lejonte identifikimin etnik të popullsisë myslimane. Edhe kështu shihet një prezencë e fuqishme e elementit shqiptar në perëndim të vendit.

Nga ana tjetër, Perandoria Austro-Hungareze nëpërmjet prezencës së saj në Ballkan, u përpoq të ndikonte në ngritjen kulturore dhe nacionale të elementit shqiptar. Konsullatat e saj në Manastir dhe Shkup financuan dhe përkrahën shkollat e pakta që ekzistonin dhe lejoheshin nga autoritet otomane<sup>20</sup>. Po ashtu, diplomacia austro-hungareze ndërhynte shpesh tek autoritetet otomane për të përmbajtur këto të fundit nga veprimet e tyre diskriminuese irracionale ndaj popullsisë civile në Maqedoninë otomane.

Më 2 gusht 1903, organizata patriotike maqedonase me lidhje të fuqishme bullgare VMRO, organizoi kryengritjen e quajtur të Ilindenit, me qëllimin e shprehur për të themeluar një Maqedoni të lirë dhe autonome<sup>21</sup>. Kryengritja shtrihet kryesisht në Maqedoninë perëndimore me epiqendër qytetin shumetnik të Krushevës. Ndër udhëheqësit kryesorë të saj janë edhe shqiptarët e asaj ane së bashku me elementin arumun ose vllah. Kryengritja shuhet me viktima dhe dëme të mëdha materiale për popullsitë lokale nga forca të mëdha otomane të ardhura nga Manastiri.

Në korrik 1908, pikërisht në pjesët perëndimore të Maqedonisë do të nisë revolucioni i turqve të rinj pas rebelimit të njësiteve ushtarake të Resnjës me në krye Nijazi Resnjën. Shpallja e

---

<sup>18</sup> Aleksandar Matkovski, Kryengritja e Dervish Cares, Tetovë, 2012, faqe 59

<sup>19</sup> Poulton, vepra e cituar, faqe 51

<sup>20</sup> Fehari Ramadani, Kontributi i Austro – Hungarisë për zhvillimin e arsimit dhe kulturës shqiptare 1900 – 1912, Tetovë, 2010, Faqe 96

<sup>21</sup> Rossos, vepra e cituar, faqe 99



kushtetutës bëri që popullsitë e robëruara të kenë mundësinë të organizohen më lirshëm në organizata autonome kulturore apo dhe politike. Në këtë kohë në qytetin e Manastirit mbahet edhe Kongresi i intelektualëve dhe veprimtarëve shqiptarë për të përcaktuar alfabetin e gjuhës shqipe.

Në vitin 1912 shpërthen kryengritja e përgjithshme shqiptare kundër autoriteteve otomane kurse kryengritësit në një fazë finale arrijnë më 12 gusht të çlirojnë Shkupin. Sukseset e këtilla të kryengritësve do të alarmojnë monarkitë ballkanike të cilat nënshkruajnë marrëveshje të veçantë për ndarjen e trashëgimisë ballkanike otomane, në fakt territoreve etnike shqiptare dhe atyre maqedonase. Më 18 tetor 1912 fillon lufta e parë ballkanike<sup>22</sup>, nga e cila dalin të humbur si shqiptarët të cilët në pjesë të madhe mbeten jashtë shtetit të tyre kombëtar ashtu edhe maqedonasit që ndahen mes Serbisë, Greqisë dhe në një pjesë më të vogël, Bullgarisë. Si pika kulmore negative në këtë respekt merren Konferenca e Londrës, 1912 – 1913 për shqiptarët dhe Marrëveshja e aleatëve ballkanikë në Bukuresht, gusht 1913 për maqedonasit.

Edhe një pjesë e qyteteve me shumicë shqiptare të popullsisë sot në Maqedoni, mbeten nën sundimin e Mbretërisë së re të serbëve, kroatëve dhe sllovenëve (SKS). Është interesante të analizohen shifrat e gjeografit të njohur bullgar Kanchov në lidhje me përbërjen etnike të Manastirit, për vitin 1890. Sipas tij, popullsia myslimane numëron rreth 8500 – 9000 banorë dhe përbëhet nga shqiptarët dhe turqit mes të cilëve nuk kishte një diferencim të qartë. Hebrenjtë ishin pakëz mbi 5000 kurse komunitetet e krishtera përbëheshin nga sllavë (rreth 9500), Vllehë (rreth 6500), Shqiptarë dhe romë (rreth 1500) dhe disa pak shtëpi grekësh e armenësh<sup>23</sup>. Termi turq etnikë këtu duhet marrë me shumë rezervë pasi njihet praktika e regjistrimit të detyrueshëm si turq të shqiptarëve myslimanë gjatë sundimit otoman.

Nga këto të dhëna shihet qartësisht prevalimi i elementit etnik shqiptar në qytetin shumetnik të Manastirit, që me 10, 500 banorë është para çdo grupi tjetër. Veç çështjes me regjistrimin si turq të një numri të shqiptarëve myslimanë, këtu duhet pasur kujdes edhe numrat e shqiptarëve ortodoksë pasi me shumë gjasa një pjesë e tyre është regjistruar si arumune, sllave ose greke vetëm duke u bazuar në përkatësinë apo anëtarësimin e tyre tek kishat respektive në atë qytet. Duke pasur parasysh edhe misionin e vetë autorit që si i dërguar i qeverisë bullgare kishte për synim dhe obligim të nxirrte sa më shumë bullgarë në Manastir, shifrat flasin qartësisht në favor të shqiptarësisë së këtij qyteti të dytë kryesor tregtar në vend, pas Selanikut në jug.

Gjatë periudhës së sundimit të parë jugosllav, pozita e popullsisë shqiptare por edhe asaj maqedonase paraqitet si e rëndë dhe pa rrugëdalje. Monarkia jugosllave kishte synim të shpallur largimin e shqiptarëve nga vendi dhe asimilimin e maqedonasve etnikë duke i debullgarizuar ata që ndjeheshin si bullgarë apo si maqedonas dhe duke serbizuar popullsinë e gjithmbarshme sllave të Maqedonisë. Në fakt dhe parë historikisht, popullsia sllavishtfolëse e Maqedonisë ka

---

<sup>22</sup> Jovan Pavlovski, ed, Sto makedonski godini 1903 – 2003, Skopje, 2004, faqe 118

<sup>23</sup> Poulton, vepra e cituar, faqe 52

qenë gjatë kohë mollë sherri me serbëve dhe bullgarëve<sup>24</sup>. Territoret u riorganizuan me anë të reformës administrative e cila vendin e quajti banovina e Vardarit. Për të drejtat etnike apo tjera as që bëhej fjalë. Maqedonasit u quajtën serbë të jugut kurse shqiptarët myslimanë ose turq të cilët duhej zhvendosur sa më parë drejt Anadollit. Emrat dhe mbiemrat personalë të maqedonasve u serbizuan kurse shkollimi në të gjitha shkallët ishte vetëm serbisht.

Për shqiptarët ishte paraparë lënia e qëllimshme në stadin e injorancës kolektive, kështu që në vendbanimet me shumicë shqiptare të popullsisë u hapën rrallë shkolla dhe atë vetëm në gjuhën serbe. Nga ana tjetër u zhvillua në mënyrë të planizuar procesi i rritjes së fanatizmit fetar tek masat shqiptare dhe asimilimi në turq. Madje u përpiluan edhe memorandumet të tëra për pastrimin final të shqiptarëve nga Jugosllavia dhe dërgimin e tyre në Turqi. Një nga zonat për tu pastruar etnikisht nga shqiptarët që parashikon plani i Vasa Çubriloviç është edhe ai që e emërton si blloku i Sharrit. Kësaj çështje ai i rikthehet edhe njëherë në vitin 1944, kur paraqet edhe një memorandum të ri ku përsëri kërkon pastrimin apo zhvendosjen e shqiptarëve nga ajo që e quan Serbia e vjetër për Kosovën dhe Maqedonia<sup>25</sup>.

Më 29 nëntor 1943, në mbledhjen e mbajtur në qytetin Jajce të Bosnjë Hercegovinës, PKJ vendosi që Jugosllavia e vjetër mbretërore të federalizohet duke paraparë themelimin e gjashtë republikave të reja, njëra prej të cilave edhe Maqedonia e quajtur e Vardarit në kufijtë e përcaktuar pas luftërave ballkanike. Me këtë për herë të parë popullsia sllavishtfolëse e këtyre territoreve u njoh si grup i veçantë etnik, për më shumë edhe si bartëse e sovranitetit shtetëror në një nga gjashtë njësitë federale të shtetit të ri komunist. Popullsia shqiptare nga ana tjetër u trajtua si minoritet duke u ndarë mes republikave të Serbisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë.

Pozita politike dhe ekonomike e saj mbeti e rëndë përgjatë ekzistencës së të quajturës Republika Socialiste e Maqedonisë. Ajo mbeti e nënëpërfaqësuar në organet e pushtetit qendror e lokal kurse territoret e banuara me shqiptarë mbeten zonat më të pazhvilluara të republikës më të pazhvilluar në federatë. Në vitet 1989/90 në kuadër të ndryshimeve të përgjithshme në Europën qendrore dhe lindore, Maqedonia adoptoi rregullativën e re ligjore e cila hapi rrugën drejt sistemit politik pluralist. Në këtë drejtim, më 15 prill të vitit 1990 u formua edhe partia e parë politike shqiptare në periudhën e demokracisë, Partia për Prosperitet Demokratik<sup>26</sup>. Kriza e vazhdueshme e sistemit jugosllav e shkaktuar nga përplasja e konceptit konfederalist slloven dhe kroat me atë centralizues serb çoi në shpërbërjen e RSF të Jugosllavisë. Krizat të tilla njihen edhe në shtete tjera europiane, por në RSFJ ishin unike dhe të vazhdueshme duke filluar që me themelimin e këtij vendi, ku serbët donin një shtet të tipit francez kurse kroatët një sipas modelit të Zvicrës<sup>27</sup>.

---

<sup>24</sup> Yugoslavia Transformed, DCI, NIE 15 -90, October 1990, Faqe 13,

<sup>25</sup> Vasa Cubrilovic, The minority problem in the new Yugoslavia, Memorandum of 3 november 1944,. Versioni online, faqe 5. quelle: Elsie, Robert (Hg): Kosovo: In the Heart of the Powder Keg. New York 1997, S. 449 – 464

<sup>26</sup> Etem Aziri, Organizimi politik i shqiptarëve në Maqedoni, 2004, Faqe 83

<sup>27</sup> Hakan Wiberg, Former Yugoslavia in 1990: Why it had a bad Prognosis, Appears as a chapter (pp. 31 - 49) in Miroslav Hadzic ed: The Violent Dissolution of Yugoslavia. Causes, Dynamics, Effects, Belgrade: Centre for Civil-

Një numër autorësh të huaj kërkojnë apo shohin arsyen e shpërbërjes së vendit edhe në pabarazitë e vazhdueshme ekonomike mes veriut dhe jugut. Kështu sipas Stavenhagen<sup>28</sup>, PBB për kokë banori në Kosovë më 1952 ishte sa ¼ e produktit të tillë në Republikën veriore të Sllovenisë.

Përfaqësuesit politikë të popullsisë maqedonase duke parë interesat e tyre partikulare dhe pa konsultime me përfaqësuesit e interesave politike të popullsisë shqiptare, organizuan referendumin monoetnik të 8 shtatorit 1991, ku u shprehën për pavarësimin e vendit nga federata jugosllave. Një zhvillim i tillë i njëanshëm do ketë pasoja për raportet ndëretnike për gjithë periudhën e post pavarësisë siç do shihet më vonë. Komuniteti shqiptar së bashku me një pjesë të strukturave të tij politike i përgjigjet këtij vendimi me referendumin për autonomi politike territoriale të 11 dhe 12 janarit 1992, me një pjesëmarrje të 90% të popullsisë, tre të katërtat e të cilëve votuan pro<sup>29</sup>. Organet maqedonase nga ana tjetër e shpallën këtë referendum ilegal e joligjor. Edhe rruga e dytë për zgjerimin e të drejtave kolektive të shqiptarëve, ajo e integritit dhe përfaqësimit në organet përfaqësuese të pushtetit nuk dha rezultate më të mira. Deputetët shqiptarë në Kuvendin republikan mbivotoheshin vazhdimisht.

Veç problemeve serioze ndëretnike që kishin të bënin me lojalitetet e ndryshme të komuniteteve të ndryshme ndaj qeverisjes, vendi përballëj edhe me sfida në politikën e jashtme. Më 8 prill 1993, Maqedonia e Veriut pranohet në OKB me emrin e përkohshëm, Ish Republika jugosllave e Maqedonisë<sup>30</sup>. Një kompromis i tillë ishte i domosdoshëm pas presioneve të fqinjët jugor në lidhje me çështjen e emrit të shtetit.

Më 1994, me iniciativë të një grupi të intelektualëve shqiptarë, në Tetovë themelohet universiteti më mësim në gjuhën shqipe. Reagimi i qeverisë qendrore të kontrolluar nga maqedonasit etnikë ishte jashtëzakonisht i ashpër dhe mbiproporcional. Dërgimi i forcave policore për të rrënuar objektet ku mbahej mësimi pati për pasojë përballjen me qytetarë shqiptarë që mbronin paqësisht këto objekte. Situata degradoi gjer në humbjen e jetës së një protestuesi të pafajshëm. Ka pasur edhe raste kur autoritetet policore në të cilat nuk kishte fare ose shumë pak shqiptarë, kanë përdorur dhunë ndaj qytetarëve shqiptarë në raste të pasqaruara.

Intervenimi i forcave të NATO në Kosovë dhe çlirimi i saj nga kontrolli i Beogradit, solli një gjendje të re kualitative edhe për shqiptarët në Maqedoni. Mungesat serioze në të drejtat kolektive të komunitetit shqiptar si dhe mospasja e strategjive të qarta për dalje nga kjo situatë e klasës politike, solli tek acarimi serioz i gjendjes së sigurisë gjatë vitit 2001. Një numër i të

---

Military Relations, 2004, Faqe 12 (Marrë online si PDF nga:

<https://www.uibk.ac.at/peacestudies/downloads/peaceclibrary/yugoslavia.pdf>)

<sup>28</sup> Rodolfo Stavenhagen, *Ethnic Conflicts and the Nation State*, Macmillan Press LTD, 1996, Faqe 155

<sup>29</sup> Thede Kahl, Izer Maksuti, Albert Ramaj (Hg), *Die Albaner in der Republik Makedonien. Fakten, Analysen, Meinungen zur interethnischen Koexistenz*, faqe 254

<sup>30</sup> Poulton, *vepra e cituar*, faqe 177

rinjve shqiptarë dukeshin të frustruar edhe si pasojë e mosqarjes para të të drejtave kolektive të komunitetit të tyre<sup>31</sup>.

Konfliktet mes grupeve të armatosura dhe forcave policore u përhapën me shpejtësi nga zonat kufitare drejt atyre të banuara. Ishte kjo një përballje e vërtetë e armatosur mes aparatit policor ushtarak shtetëror të përbërë thuajse plotësisht nga maqedonas etnikë me një guerilje të armatosur shqiptare e cila kërkonte më shumë liri dhe të drejta për komunitetin shqiptar. Ndërhyrja e shpejtë dhe gjithëpërfshirëse e komunitetit ndërkombëtar i dha një zgjidhje krizës në formën e Marrëveshjes së quajtur të Ohrit.

Implementimi i marrëveshjes në fjalë ka kaluar nëpër një numër problemesh, sfidash e mosmarrëveshjesh që ka bërë që edhe më 2019, plot 18 vite pas nënshkrimit të mos shihet si e implementuar plotësisht. Për më tepër, MO akoma shihet si burim ndasish në shoqëri duke u parë nga njëra si anë si marrëveshje që komunitetit maqedonas iu imponua nga jashtë dhe nga ana tjetër si kornizë e pamjaftueshme për realizimin e plotë nacional të komunitetit shqiptar.

---

<sup>31</sup> Katie Paintin, States of Conflict: A Case study on conflict prevention in Macedonia, IPPR, 2009, faqe 13. Versioni online: ([https://www.ippr.org/files/images/media/files/publication/2011/05/states%20of%20conflict%20Macedonia\\_1717.pdf](https://www.ippr.org/files/images/media/files/publication/2011/05/states%20of%20conflict%20Macedonia_1717.pdf))

## **1.2 Grupet etnike në Maqedoninë e Veriut - pasqyrë demografike**

Maqedonia e sotme e veriut përbëhet nga një numër i madh i komuniteteve etnike prej të cilave një pjesë mund të konsiderohen historike kurse pjesa tjetër të ardhur më vonë, si pasojë e rrethanave politike, ushtarake, ekonomike apo edhe rrjedhave të ndryshme migruese. Dy janë komunitetet kryesore, maqedonasit dhe shqiptarët. Numri i banorëve është afërsisht dy milionë brenda një territori që përfshin një sipërfaqe prej 25.713 kilometër katrorë<sup>32</sup>.

### **1.2.1 Komuniteti maqedonas**

Maqedonasit etnikë janë komuniteti më i madh brenda kufijve të sotëm politikë të Maqedonisë së Veriut. Rrjedhin nga fiset sllave që në shekujt VI dhe më tej erdhën në Ballkan nga viset qendrore të Europës. Pas luftës së dytë botërore komuniteti autokton sllavishtfolës në suaza të Republikës Socialiste të Maqedonisë pati aftësinë për të ndërtuar dhe konsoliduar një identitet kombëtar maqedonas<sup>33</sup>. Shtrihen kryesisht në zonën lindore dhe qendrore të Republikës. Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Republikën e Maqedonisë nga viti 2002, maqedonasit përbëjnë 64.17% të numrit të përgjithshëm të popullsisë në vend<sup>34</sup>. Maqedonasit etnikë gjenden gjithandej territorit të republikës. Në zonat lindore ata përbëjnë një shumicë të madhe të popullsisë kurse në zonat veriperëndimore dhe perëndimore gjenden në një numër më të vogël. Kryeqyteti është një pikë tjetër e rëndësishme e koncentrimit të këtij komuniteti.

### **1.2.2 Komuniteti shqiptar**

Shqiptarët etnikë janë bashkësia e dytë më e madhe në territorin e Maqedonisë së sotme. Shqiptarët e këtushëm janë popullsi historike dhe autoktone mbetur brenda kufijve të Republikës së Maqedonisë së Veriut si rezultat i marrëveshjeve të ndryshme për ndarjen e territoreve ndërmjet shteteve ballkanike dhe shpërbërjes së Jugosllavisë më 1991/92. Numri zyrtar i shqiptarëve etnikë sipas Entit shtetëror të statistikave nga regjistrimi i vitit 2002, është afërsisht 25.17 % e numrit të përgjithshëm prej mëse 2 milionë banorëve. Komuniteti shqiptar është i përfaqësuar fuqishëm në zonat veriperëndimore dhe perëndimore të vendit si dhe në kryeqytet Shkup, bashkë me zonën veriore në kufi me Republikën e Kosovës.

<sup>32</sup> Slavko Milosavljević, Fakti za Republika Makedonia, Skopje, 2004, faqe 68

<sup>33</sup> Jane K. Cowan ed: Macedonia, The Politics of Identity and Difference, Pluto Press, 2000, faqe XIV

<sup>34</sup> Drzaven Zavod za Statistika, Popis na naselenieto, domacinstvata i stanovite vo Republika Makedonija, Skopje, 2002

### 1.2.3 Komuniteti turk

Turqit etnikë në Maqedoni janë mbetje e periudhës së sundimit otoman<sup>35</sup>, kur një numër i madh i kolonëve dhe administratorëve turq u vendosën në territoret ballkanike për të pacifikuar dhe sunduar me popullsitë vendëse ballkanike. Gjithsesi, numri real i popullsisë së deklaruar si e tillë nuk ka qenë asnjëherë i madh. Në vitet 30 dhe 50/60 të shekullit të kaluar ka ndodhur një rritje drastike dhe artificiale e numrave turq në Maqedoni. Kjo ka ardhur si pasojë e presionit të autoriteteve jugosllave në popullsitë shqiptare dhe sllave myslimane qoftë torbeshe apo edhe boshnjake për tu deklaruar si turq dhe emigruar në Turqi. Ka edhe një pikëpamje të dhënë nga studiues turq, serbë e maqedonas, sipas të cilës turqit këtu janë asimiluar më herët nga shqiptarët dhe me uljen e presionit pas luftës së dytë botërore kanë shprehur lirshëm subjektivitetin e tyre etnik, por kjo tezë duket krejtësisht e pabazë dhe spekulative. Vetë autorë të huaj objektivë (Babuna: 2000) kanë pranuar që një numër i madh i shqiptarëve myslimanë gjatë viteve 50/60 janë detyruar të deklarohen si turq etnikë dhe të largohen nga Jugosllavia për në Turqi<sup>36</sup>. Turqit etnikë sot jetojnë kryesisht në pjesët lindore të vendit, por edhe në kryeqytet. Ishuj më të vegjël gjenden edhe në pjesët perëndimore të Republikës.

### 1.2.4 Komuniteti rom

Romët në Maqedoninë e Veriut sot janë komuniteti i katërt më i madh dhe përbëjnë afërsisht 2.7% të numrit të përgjithshëm të popullsisë, por sipas vlerësimeve tjera numri i tyre zakonisht është më i madh se ai zyrtar dhe mund të lëvizë nga 6.5 – 13% nga numri i përgjithshëm i banorëve këtu<sup>37</sup>. Komuniteti rom është i shpërndarë nëpër gjithë republikën, kurse shumica dërmuese e tyre është e koncentruar në kryeqytet Shkup, në komunën e Shuto Orizari. Brenda grupit rom, që në vitet 90 ekziston një nënndarje e vetëdeklaruar si egjiptase. Kjo më shumë se grup i ri etnik, paraqet një vetëdistancim të një numri të caktuar të romëve nga grupi i tyre etnik si pasojë e përjashtimit social, stigmatizimit dhe diskriminimit konstant me të cilin përballen historikisht në shoqëri.

---

<sup>35</sup> Ilhan Uzgel, The Role of the Muslim Minorities in Interstate Relations in the Balkans, The Turkish Yearbook, Vol. XXI, VIII. The Turks of Macedonia: Silent Minority in a Turbulent Area, faqe 124.

<sup>36</sup> Aydin Babuna, The Albanians of Kosovo and Macedonia: Ethnic Identity supersiding religion, Nationalities Papers, Volume 28, No. 1, 2000, faqe 69 dhe 70

<sup>37</sup> CIA, The World Factbook, Europe: Macedonia. Peoples and Society. Ethnic groups. Versioni online: (<https://www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook/geos/mk.html>)

### **1.2.5 Komuniteti serb**

Serbët në Maqedoni janë prezentë në numra simbolikë që nga periudhat më të hershme historike. Numri i tyre u shtua shumë pas pushtimit të Maqedonisë së Vardarit nga Mbretëria serbe gjatë luftërave ballkanike si dhe gjatë procesit të kolonizimit të saj me serbë nga viset tjera të Jugosllavisë, në periudhën mes dy luftërave botërore. Sot bashkësia serbe përbën 1.5% të numrit të përgjithshëm të banorëve në Maqedoni. Vendbanimet me shumicë serbe të popullsisë gjenden në kufirin verior me Republikën e Serbisë si dhe përgjatë rrugëve me rëndësi strategjike në gjatësinë e lumit Vardar deri në kufirin shtetëror me Greqinë në jug.

### **1.2.6 Komuniteti boshnjak**

Komuniteti boshnjak në Maqedoni është një trashëgimi e politikës serbe për pastrimin e popullsisë myslimane sllavishtfolëse nga rajoni i Sanxhakut dhe emigrimit të saj në Turqi. Një numër i caktuar i këtyre elementëve janë ngulitur në pjesët qendrore të vendit, ndërsa një pjesë tjetër jeton kryesisht në Shkup.

### **1.2.7 Komuniteti arumun (vllah)**

Arumunët janë komunitet autokton ballkanik të shpërndarë në Maqedoni dhe gjithë Ballkanin. Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë, arumunët përbëjnë vetëm 0.5 % të popullsisë maqedonase. Këto shifra duhet parë me rezerva, pasi një numër disproporcionalisht i madh i pjesëtarëve të këtij komuniteti shfaq prirjen historike të integritit të shpejtë në shoqëri dhe asimilimit gradual e të pandalshëm në korpusin etnik maqedonas. Numri më i madh i arumunëve sot jetojnë në Shtip si dhe në kryeqytetin e vendit Shkup, me një prezencë më të vogël edhe në zona tjera kryesisht urbane<sup>38</sup>.

### **1.2.8 Komunitetet tjera**

Në territorin e Republikës jetojnë në numra simbolikë edhe grupe tjera etnike ose edhe individë që në regjistrimet e popullsisë japin identitete tjera nacionale nga të lartpërmendurat. Regjistrimi i fundit ka dhënë edhe kroatë, myslimanë, malazezë, bullgarë etj. Gjithsesi përqindjet e tyre mbeten simbolike dhe gjithë bashkë nuk kalojnë 2 % e numrit të gjithmbarshëm të banorëve.

---

<sup>38</sup> Victor A. Fridman, *The Vlach Minority in the Republic of Macedonia: Language, Identity, Dialectology and Standardisation*, Selected Papers in Slavic, Balkan, and Balkan Studies, ed. by Juhani Nuoluo, Martii Leiwo, Jussi Halla-aho, (Slavica Helsingiensia 21). Helsinki: University of Helsinki. 2001. 26-50. Faqe 6/7.  
(<http://www.farsarotul.org/The%20Vlah%20Minority%20in%20Macedonia.pdf>)

**Tabela 1** Pasqyrë e komuniteteve më të mëdha etnike sipas regjistrimeve konsektive të popullsisë 1948/1994<sup>39</sup>

Viti	Totali	Maqedonas		Shqiptarë		Turq		Romë		Serbë		Boshnjakë		Arumunë	
		Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
1948	1, 152, 986	789, 603	68.5	197, 603	17.1	95, 940	8.3	19, 500	1.7	29, 721	2.6	-	-	9511	0.8
1953	1, 394, 514	860, 699	66	162, 000	12.4	203, 928	15.6	20,4 62	1.6	35,1 12	2.7	-	-	-	-
1961	1, 406, 003	900, 685	71.2	183, 108	13	131, 481	9.4	20,6 06	1.5	42,7 28	2.7	-	-	-	-
1971	1, 647, 308	1,14 2,37 5	69.3	279, 871	17	108, 552	6.6	24,5 05	1.5	46,4 65	2.85	-	-	7,000	0.42
1981	1, 909, 146	1,27 9,32 3	67	377, 208	19, 8	86,5 91	4.5	43,1 25	2,3	44,6 13	2.3	-	-	6,384	0.3
1991 *	2, 033, 964	1,32 8,18 7	65,3	441, 987	21.73	77,0 80	3.79	52,1 03	2.56	42,7 55	2.1	-	-	7,764	0.38
1994	1, 936, 877	1,28 8,33 0	66.5	441, 104	22.86	77,2 52	4	43,7 32	2.25	39,6 20	2.04	-	-	8,467	0.44


<sup>39</sup> Republic of Macedonia, State Statistical Office, Versioni online: [http://www.stat.gov.mk/english/glavna\\_eng.asp?br=18](http://www.stat.gov.mk/english/glavna_eng.asp?br=18)



\*Regjistrimi i popullsisë Jugosllave më 1991 u realizua mes debateve të fuqishme, mosmarrëveshjeve politike si dhe gjendjes së rënduar të sigurisë të lidhura me shpërbërjen e dhunshme të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë. Komuniteti shqiptar e bojkotoi masivisht procesin regjistruar në Maqedoni, Kosovë dhe në trevat tjera të këtij vendi.


### Graf 1.0

Komunitetet etnike në Maqedoni sipas regjistrimit të fundit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave nga viti 2002



## Graf 1.1

Krahasim i drejtpërdrejtë i totalit dhe përqindjeve të numrit të shqiptarëve dhe maqedonasve në Maqedoninë e Veriut në regjistrimet e viteve 1948 – 2002



Sipas regjistrimit zyrtar të popullsisë së vitit 2002, maqedonishtja është gjuhë amtare e 66.49% kurse shqipja e 25.125 të banorëve<sup>40</sup>.

Regjistrimi i popullsisë së vitit 2011 që filloi si një proces i rregullt u ndërpre nga vetë Enti shtetëror i statistikave dhe Kuvendi republikan duke mos u çuar deri në fund. Administratorët anëtarë dhe udhëheqës të Komisionit për regjistrim dhanë dorëheqje duke mos u dakordësuar me metodologjinë e përdorur në regjistrim.

<sup>40</sup> Centre for Regional Policy Research and Cooperation "Studiorum". Effective Political Participation of the Smaller Ethnic Communities in Local Self Government. Skopje 2011. Faqe 9  
[http://pdc.ceu.hu/archive/00006492/01/CRPRC\\_Studiorum\\_Effective\\_participation\\_of\\_minorities-study\(ENG\).pdf](http://pdc.ceu.hu/archive/00006492/01/CRPRC_Studiorum_Effective_participation_of_minorities-study(ENG).pdf)

Një numër i kryetarëve të komunave me shumicë shqiptare të popullsisë patën vërejtje për kohën dhe mënyrën e regjistrimit të banorëve rezidentë dhe atyre me qëndrim të përkohshëm jashtë vendit<sup>41</sup>. Në qarqe të caktuara të brendshme por edhe të jashtme si një ndër arsyt kryesore të tërheqjes së kryetarit të Komisionit dhe anëtarëve tjerë të tij, u panë mosmarrëveshjet në lidhje me numrin e popullsisë shqiptare si dhe një rënie e dukshme e numrit të popullsisë maqedonase<sup>42</sup>. Shifrat e fundit zyrtare për popullsinë në RMV, mbeten nga regjistrimi i fundit i pranuar përgjithësisht, ai vitit 2002.

---

<sup>41</sup> Се проблематизира почетокот на пописот, DW, 30.09.2011, <http://dw.com/p/12jV5>; Оставки на членовите Албанци во пописната комисија, DW, 30.09.2011, <http://dw.com/p/12jY1>

<sup>42</sup> Prekinut popis stanovništva u Makedoniji zbog Albanaca, Dnevnik, 16.10.2011, <http://dnevnik.hr/vijesti/svijet/prekinut-popis-stanovnistva-u-makedoniji-zbog-albanaca.html>

**II**

**dhe zgjidhja në formë të MO**

---

2.1 Diskriminimi i komunitetit shqiptar dhe konfliktualiteti konstant ndëretnik 1991 – 2001

2.1.1 Kushtetuta e vitit 1991 si shkaktare e krizës ndëretnike

2.1.2 Diskriminimi politik

2.1.3 Diskriminimi institucional. Nënperfaqësimi i shqiptarëve në të gjitha nivelet e administratës

2.1.4 Diskriminimi në sistemin edukativ arsimor, kulturë

2.1.5 Diskriminimi socio-ekonomik

2.1.6 Dhuna policore dhe shkelja e lirive e të drejtave të njeriut

2.1.7 Rekapitullim për diskriminimin dhe marrëdhëniet ndëretnike në periudhën 1991 – 2001

2.2 Demarkacioni i kufirit verior si faktor iniciues për nisjen e konfliktit. Rrënjët etnike

të krizës maqedonase

2.2.1 Zhvillimi i ngjarjeve deri në nënshkrimin e Marrëveshjes së Ohrit

2.3 Marrëveshja e Ohrit si një zgjidhje gjysmake për të dyja palët

2.4 Perceptimi shqiptar për Marrëveshjen e Ohrit

2.5 Perceptimi maqedonas për Marrëveshjen e Ohrit

## 2.6 Etniciteti si elementi kyç në kontekstin politik të RMV

# Kapitulli II

## 2.1 Diskriminimi i komunitetit shqiptar dhe konfliktualiteti permanent ndëretnik 1991 – 2001

### 2.1.1 Kushtetuta e vitit 1991 si shkaktare e krizës ndëretnike

Republika socialiste federative e Jugosllavisë miratoi kushtetutën e re në vitin 1974. Ishte ky një akt politiko-juridik që solli një frymë të re, disi më liberale në trajtimin e çështjeve nacionale të këtij shteti shumëkombësh në Europën juglindore. Me këtë kushtetutë u definua edhe natyra e sistemit politik dhe ekonomik në Maqedoninë e Veriut si një nga tetë njësitë konstituive të federatës. Kushtetuta në fjalë e definoi Republikën socialiste të Maqedonisë si shtet nacional të popullit maqedonas dhe njëkohësisht, shtet të kombësisë shqiptare dhe turke në të. Me këtë së paku parimisht dhe formalisht, komuniteti shqiptar u bë bartës i sovranitetit shtetëror në një republikë sovraane në kuadër të federatës jugosllave. Një zhvillim i tillë nuk mund të thuhet se pati aplikim në praktikën e rregullimit të marrëdhënieve shoqërore në vend, me shqiptarët që vazhdonin të diskriminoheshin qartazi në të gjitha sferat shoqërore.

Shpërbërja e federatës Jugosllave dhe vendimi për pavarësi në referendumin monoetnik të tetë shtatorit 1991, solli me vete edhe nevojën e miratimit të kushtetutës së re të shtetit të pavarur maqedonas. Kushtetuta u miratua më 17 nëntor 1991<sup>43</sup>, e përcjellë përsëri me bojkotin e deputetëve shqiptarë dhe e miratuar nga votat e shumicës maqedonase në kuvendin republikan.

Miratimit të saj i parapriu një debat serioz dhe zhvillime të shumta politike. Qytetarët shqiptarë të organizuar nga partitë e tyre politike, organizuan një numër protestash masive<sup>44</sup>, me të cilat paralajmëruan politikën maqedonase të mos miratojë një kushtetutë në formën e dhënë përjashtuese ndaj shqiptarëve. Edhe përfaqësuesit politikë të shqiptarëve, Partia për Prosperitet Demokratik dhe Partia Demokratike Popullore, shprehën publikisht pakënaqësinë dhe njëherit parashtruan kërkesat dhe kushtet e tyre për miratimin e Kushtetutës. Ata miratuan Deklaratën e grupit parlamentar të PPD dhe PDP për status të barabartë të shqiptarëve në Republikën e

---

<sup>43</sup> Etem Aziri, vepra e cituar, faqe 144

<sup>44</sup> Etem Aziri, vepra e cituar, faqe 142

Maqedonisë<sup>45</sup>. Por këto kërkesa nuk u pranuan nga lidershipi shtetëror që në atë periudhë përfaqësonte dhe mbronte ekskluzivisht interesa monoetnike.

Miratimi i kushtetutës së re si akti më i lartë politik duke mos respektuar vullnetin e shqiptarëve të shprehur nëpërmjet qëndrimeve të përfaqësuesve të tyre në organin ligjvënës, ishte një goditje e rëndë për demokracinë dhe marrëdhëniet ndëretnike në vend. Që në preambulë ajo dallonte qartë nga kushtetuta komuniste e 1974. Kushtetuta e parë e Maqedonisë demokratike dhe të pavarur, në preambulë e përcakton prerazi dhe pa ekuivoke që Republika është konstituuar si shtet nacional i popullit maqedonas<sup>46</sup>. Përcaktimi i këtyre pasqyron realisht, degradimin e statusit kushtetues të komunitetit të dytë më të madh, atij shqiptar i cili në preambulë përcaktohet si kombësi, një lloj eufemizmi i terminologjisë komuniste për të emërtuar pakicat kombëtare. Në vijim të pjesës hyrëse shteti definohej edhe si qytetar dhe demokratik. Një koncept i tillë nuk mund të thuhet që përcakton apo garanton një barazi të plotë nacionale pasi siç vërejmë edhe autorë të huaj, barazia kushtetuese si shtetas nuk është e njëjtë me barazinë kushtetuese si komunitet etnik<sup>47</sup>.

Një çështje tjetër e rëndësishme dhe komplekse në shoqëritë dy ose shumëetnike janë edhe rregullimet kushtetuese në lidhje me gjuhët në përdorim zyrtar në republikë. Kushtetuta e nëntorit 1991, në nenin 7 të saj, definoi qartë që në vend, gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe shkrimi i saj cirilik. Ajo lejoi përdorimin e gjuhëve të quajtura, të kombësive, në njësitë e vetadministrimit lokal në të cilat këta janë në shumicë ose në numër të konsiderueshëm<sup>48</sup>. Një përcaktim i tillë mund të përshtatet një vendi ku dallimet në numra mes komunitetit të parë dhe tjerëve janë të mëdha, por s'mund të jetë optimale për një vend si Maqedonia ku komuniteti i dytë më i madh përbën mëse 1/3 e popullsisë, përveç komuniteteve tjera më të vogla që përfshijnë mbi 10 % të numrit të gjithmbarshëm të popullsisë.

Neni 19 garantonte lirinë e religjionit, por i jepte një pozitë të veçantë në shoqëri komunitetit ortodoks, kurse komunitetet tjera religjioze aty të emërtuara si “bashkësi fetare”, nuk emërtohen fare edhe pse potencohet që janë të barabarta para ligjit<sup>49</sup>.

Neni 48 i Kushtetutës së vitit 1991, rregullon edhe problematikën e arsimit të pjesëtarëve të kombësive ose nacionaliteteve, që efektivisht i bie pakicave kombëtare. Neni rregullon çështjen e arsimit në gjuhën amtare, por nuk rregullon të njëjtën për arsimin e lartë në gjuhën e kombësive. Këtu del në pah shkelja e rëndë e të drejtave të komunitetit të dytë më të madh, atij shqiptar, që nuk i garantohet në fakt arsimi i lartë në gjuhën amtare.

---

<sup>45</sup> Zeqirja Rexhepi, Zhvillimet politiko-shoqërore të shqiptarët në Maqedoni 1990 – 2001, 2005, faqe 46

<sup>46</sup> Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Nëntor, 1991, faqe 2

<sup>47</sup> Jenny Engstrom, The power of perception: The Impact of the Macedonian question on Inter-ethnic Relations in the Republic of Macedonia, The Global Review of Ethnopolitics, Vol. 1, no. 3, March 2002, 3-17. Versioni online: [https://www.pmf.unizg.hr/\\_download/repository/makedonija%5B1%5D.pdf](https://www.pmf.unizg.hr/_download/repository/makedonija%5B1%5D.pdf), faqe 12

<sup>48</sup> Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, vepra e cituar, faqet 4 dhe 5

<sup>49</sup> Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, vepra e cituar, faqe 9

Neni 8 i Ligjit kushtetues për zbatimin e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, kërkon që në afat prej 6 muajsh nga miratimi i kushtetutës, të nxiret ligj i ri për stemën, flamurin dhe himnin shtetëror. Gjithsesi duke qenë një shoqëri shumetnike, miratimi i ligjeve në lidhje me koncepte identitare nacionale si stema, flamuri apo himni është kompleks dhe nuk mund të bëhet pa miratimin e grupeve etnike që jetojnë në vend. Kushtetuta e vitit 1991 dhe ligjet e miratuara që burojnë prej saj, nuk i mori fare parasysh qëndrimet, ndjenjat dhe preferencat identitare të grupit të dytë etnik, atij shqiptar, gjatë përcaktimit të pamjes, tekstit, gjuhës së përdorur dhe mesazhit që japin simbole të tilla shtetërore si stema, flamuri dhe himni. Me këtë Kushtetuta e vitit 1991 dështoi të rregullojë në mënyrë të paanshme, të drejtë dhe demokratike edhe këtë sferë sensibil të raporteve ndëretnike, çështjen me simbolet përfaqësuese dhe identitetdhënëse të shtetit.

Parë realisht, Kushtetuta e vitit 1991, nuk arriti të plotësojë dhe çojë në vend kërkesat legjitime dhe vullnetin politik të komunitetit të dytë në vend. Ajo ishte dhe mbeti burim i kritikave, pakënaqësive dhe përballjeve konstante politike, mes subjekteve përfaqësuese të interesave shqiptare dhe atyre maqedonase në gjithë dekadën vijuese. Në fakt, kushtetuta e vitit 1991 ishte korniza juridike përgjegjëse në masë të madhe për përçarjen etnike, diskriminimin etnik dhe mosarritjen e standardeve demokratike europiane në shoqëri. Përfaqësuesit politikë maqedonas kapën shtetin dhe e përdorën atë për interesa partikulare komunitare duke u thirrur dhe bazuar në kushtetutën në fuqi, e cila bllokonte në masë të madhe energjitë politike të shqiptarëve të këtushëm. Që kushtetuta e miratuar nga shumica etnike maqedonase pa vullnetin e përfaqësuesve politikë shqiptarë ishte burim pakënaqësie të gjerë, është pranuar më vonë edhe nga pjesëtarë të veçantë të nomenklaturës maqedonase, përgjegjës të drejtpërdrejtë të politikave shtetërore përgjatë kësaj periudhe<sup>50</sup>.

### **2.1.2 Diskriminimi politik**

Miratimi i një kushtetute të tillë si ajo e vitit 1991, si shprehje e vullnetit të komunitetit maqedonas duke mos marrë parasysh opinionet dhe vërejtjet parimore të shqiptarëve, u bë burim i diskriminimit institucional, krizës së stërzgjatur dhe konstante politike dhe tensionimit permanent ndëretnik. Marrëdhëniet ndërkomunitare ishin gjithnjë të acaruar dhe një klimë e thellë mosbesimi mbizotëronte në shoqëri. Në fakt, sistemi politik kontrollohej në masë të madhe dhe vetë kahet e zhvillimit shoqëror përcaktoheshin thuajse krejtësisht, nga përfaqësuesit politikë të komunitetit shumicë relative e popullsisë.

Zgjedhjet e para të periudhës së pas pavarësisë janë një shembull eklatant i këtij konstatimi. Me vendosjen e sistemit shumëpartiak lindi nevoja për formimin e partive politike që mbronin

---

<sup>50</sup> CSRC. Pan-Albanianism: How Big a Threat to Balkan stability? ICG. April 2004. Central & Eastern European Series 04/10, faqe 17 ([https://www.files.ethz.ch/isn/97315/04\\_May.pdf](https://www.files.ethz.ch/isn/97315/04_May.pdf))

interesat kolektive të shqiptarëve këtu. Kjo me arsyen e vetme pasi sistemi politik dhe vetë shteti që në fillimet e veta u koncipua dhe u nda në fakt përgjatë vijave etnike<sup>51</sup>.

Partitë politike shqiptare u formuan me fillimin e pluralizmit politik në vitin 1990, konkretisht Partia për Prosperitet Demokratik. Që në fillimet e veta iniciativa dhe mundësia e formimit të një partie politike etnike u pa me dyshim nga institucionet shtetërore të kontrolluara nga maqedonasit etnikë. Kjo bëri që paradoksalisht, sekretari i parë i partisë së parë politike shqiptare të jetë një maqedonas etnik. Po gjatë vitit 1990 u formua edhe organizmi i dytë politik i shqiptarëve, Partia Demokratike Popullore. Funkcionimi i partive politike shqiptare në këtë fazë të hershme të pluralizmit politik është penguar shpeshherë nga autoritetet policore në forma të drejtpërdrejta dhe tjera.

Në zgjedhjet e para parlamentare shumëpartiake të vitit 1990, PPD që më tepër shihej si lëvizje popullore sesa parti politike, fitoi zyrtarisht 22 deputetë në koalicion me PDP<sup>52</sup>. Ishte përshtypje e përgjithshme që numri i deputetëve shqiptarë nuk korrespondoi me numrin e votuesve realë dhe banorëve shqiptarë. Duke pasur parasysh që si rezultat i gjuhës së përdorur dhe mungesës totale të përfaqësimit shqiptar në Komisionin e regjistrimit të popullsisë, shqiptarët e bojkotuan atë, vërtetohet teza e manipulimeve serioze me numrin e trupit votues dhe deputetëve shqiptarë në zgjedhjet e para shumëpartiake në vend.

Në qeverinë e parë maqedonase të quajtur teknike të Nikola Klusev në vitin 1991, kishte tre ministra shqiptarë që duhej të përfaqësonin interesat shqiptare në ekzekutivin republikan. Kjo ishte përpjekja e parë e ndrojtur e establishmentit monoetnik shtetëror për të kooptuar edhe pjesëtarët e komunitetit shqiptar në sistemin vendimmarrës politik. Në fakt, përfshirja e ministrave shqiptarë në qeverisjen qendrore ishte edhe një ndër sugjerimet e diplomacisë ndërkombëtare të kohës për politikën maqedonase. Kjo është edhe një nga indikatorët përmes të cilit mund të vlerësohet shkalla dhe përmasat e përfshirjes së komuniteteve të caktuara në sistemin politik. Në pesë kabinetet vijuese që kanë qeverisur vendin në periudhën 1991 – 2001, partitë politike shqiptare janë përfaqësuar në pozitë më të larta të administratës shtetërore, atë të ministrave e z.ministrave, kryesisht me 5 ministra, veç qeverisë së quajtur të unitetit gjatë vitit 2001, kur pati gjashtë ministra shqiptarë<sup>53</sup>.

Ndërhyrja e institucioneve maqedonase nëpërmjet formave të ndryshme u vërejt edhe gjatë angazhimeve politike në fund të vitit 1991 dhe fillim të vitit 1992. Në referendumin për autonomi politike territoriale të shqiptarëve në Maqedoni, morën pjesë 276.921 votues, një pjesëmarrje prej 92.56 % e elektoratit potencial, prej të cilëve 99.9 % votuan pro propozimit për

---

<sup>51</sup> Mirjana Maleska, *Etnickiot konflikt i prilagoduvanjeta*, Shkup, 1998, faqe 54

<sup>52</sup> Kubo Keichi, *Democratization and Inter-ethnic Relations in Multiethnic Countries: A Comparative Analyses of Croatia and Macedonia*, *Acta Slavica Iaponica*, Tomus 21, pp. 181 – 201, 2004, faqe 191 (<http://src-h.slav.hokudai.ac.jp/publictn/acta/21/kubo.pdf>)

<sup>53</sup> Jeton Shasivari, *Statusi i shqiptarëve në sistemin kushtetues, juridik dhe politik të Republikës së Maqedonisë*, *E drejta*, Revistë për çështje juridike dhe shoqërore, Viti XXXV - No. 1. 2012, faqe 103



autonomi<sup>54</sup>. Gjithsesi, nga autorë shqiptarë janë dhënë shifra tjera burimore për referendumin në fjalë. Kështu numri i përgjithshëm i trupit votues të regjistruar shqiptar në Maqedoni ishte 383.539 vetë prej të cilëve 360.928 kanë votuar pro autonomisë, kurse 57 kundër<sup>55</sup>. Autoritetet tentuan ndalimin e referendumit dhe sekuestrimin e dokumenteve tjera në lidhje me të.

Një problem tjetër serioz politik gjatë kësaj periudhe ishte bllokimi i punës së Kuvendit komunal të Tetovës nga pushteti qendror, si rezultat i obstrukcioneve dhe pengesave të maqedonasve lokalë në këtë qytet me shumicë shqiptare në veriperëndim të vendit. Probleme të ngjashme me prapavijë nacionaliste shfaqeshin edhe në një qytet të dytë të madh perëndimor me shumicë shqiptare të popullsisë, Gostivar. Bllokimi krejtësisht jonormal dhe antidemokratik i pushtetit komunal të zgjedhur në zgjedhje të lira shumëpartiake, u zgjodh me marrëveshjen e liderëve partiakë të PPD dhe presidentit të Republikës.

Në të gjitha zgjedhjet e kësaj periudhe qofshin të përgjithshme parlamentare ose lokale, vërehet një përfaqësim jo i drejtë i shqiptarëve në krahasim me numrin real të popullsisë dhe votuesve shqiptarë. Çështja me përbërjen etnike të popullsisë së Maqedonisë së Veriut, dhe me këtë edhe të trupit votues dhe votuesve potencialë të partive politike etnike, nuk gjen zgjidhje as 28 vite pas pavarësimit të vendit. Duke u nisur nga ky fakt duket e pamundur të jepen të dhëna dhe shifra të sakta për numrin e deputetëve shqiptarë apo tjerë që do dilnin nga një regjistrim i drejtë dhe i paanshëm i popullsisë dhe nga një listë e pastruar dhe e besueshme zgjedhore.

Një zhvillim tjetër i rëndë diskriminues i kategorisë politike i shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut me pasoja të drejtpërdrejta për qeverisjen lokale dhe autonominë e saj si dhe për marrëdhëniet ndëretnike, ishte miratimi i ligjeve kundër përdorimit të simboleve të pakicave dhe ndërhyrja kundër shpalesjes së simboleve nacionale shqiptare në Gostivar dhe Tetovë më 1997. Veprimet e policisë monoetnike më 9 dhe 10 qershor 1997 ndaj qytetarëve që protestuan në mënyrë paqësore ishin krejtësisht jonormale me tre të vrarë dhe mbi 200 të lënduar<sup>56</sup>. Vendimi për një ndërhyrje të tillë të dhunshme ishte krejtësisht politik dhe në kundërshtim me kushtetutën në fuqi, sipas të cilës garantohet përdorimi i lirë i simboleve të kombësive përkrah simbolit maqedonas. Ndërhyrja madje është bërë me urdhër qeveritar, por pa lajmëruar fare ministrat shqiptarë pjesë e po të njëjtës qeveri, siç del nga vetë fjala e tyre mbajtur në Kuvend në lidhje me rastin<sup>57</sup>.

---

<sup>54</sup> Stephen Iwan Griffiths, Nationalism and Ethnic Conflict Threats to European Security, SIPRI Research Report No. 5, Oxford University Press, 1993, cit. Summary of World Broadcast, EE/1279 I, 16 Jan. 1992. faqe 58 (<https://www.sipri.org/sites/default/files/files/RR/SIPRIRR05.pdf>)

<sup>55</sup> Zeqirja Rexhepi, vepra e cituar, faqe 57

<sup>56</sup> K.S Brown, In the realm of the Double-Headed Eagle: Parapolitics in Macedonia, 1994-99, në: Macedonia, The Politics of Identity and Difference, Edited by: Jane K. Cowan, Pluto Press 2000, Faqe 131

<sup>57</sup> Parliamentary Debate on the Gostivar Events, OSCE, Spillover Monitor Mission to Skopje, Excerpts from OSCE Fortnightly Report 102, 22 September 1997, <https://www.hrw.org/legacy/reports/reports98/macedonia/maced2a.htm>

Zgjedhjet e vitit 1998 u fituan nga opozita e djathtë maqedonase e VMRO-DPMNE, e cila kishte shumicë absolute dhe mund të formonte qeverinë e re edhe e vetme<sup>58</sup>. Për herë të parë pas një periudhe krizash dhe përballjesh politike, një pjesë e elitës maqedonase dukej e gatshme për të pranuar gabimet e së shkuarës në trajtimin e shqiptarëve dhe përfaqësuesve të tyre politikë. Në qeverisjen e re të djathtistëve maqedonas me në krye Ljupço Georgievskin, si pjesë e koalicionit ishte Partia Demokratike Shqiptare (PDSH), e cila mori 11 mandate deputetësh dhe 5 poste ministrore. Qeverisja e re ndërmori disa hapa politikë në drejtim të relaksimit të marrëdhënieve ndëretnike si lirimi nga burgu i disa politikanëve shqiptarë në fillim të 1999 pas një ligji për amnisti të votuar nga shumica e re parlamentare<sup>59</sup>, themelimi në qytetin perëndimor të Tetovës i një institucioni privat tregjuhësor të arsimit të lartë me ndërmjetësimin e OSBE, si dhe disa përpjekje modeste në drejtim të rritjes së pjesëmarrjes së pjesëtarëve të komunitetit shqiptar në organet shtetërore.

Gjithashtu, qeverisja maqedonase, me gjithë rezistencën serioze të strukturave të caktuara maqedonase brenda saj, e menaxhoi deri diku me sukses krizën e rëndë të refugjatëve që pasoi luftimet në Kosovë përgjatë viteve 1998/99, si dhe intervenimin humanitar të NATO atje, gjatë periudhës mars–qershor 1999. Duke thënë këtë, duhet pranuar që ministrat maqedonas në qeverisje shpeshherë kanë qenë tejet arrogantë dhe bllokues në punën e qeverisë, sidomos në çështjet që kishin të bëjnë me interesat shqiptare, duke detyruar këta të fundit në disa raste të vënë në pyetje vazhdimin e koalicionit qeverisës.

Me gjithë përmirësime të caktuara të statusit politik të komunitetit shqiptar, në krahasim me qeverisjet e mëhershme, duke rritur përfaqësimin institucional, sukseset në dukje në menaxhimin me krizën e rëndë të refugjatëve nga Kosova, si dhe disa rezultateve modeste të relaksimit ndëretnik maqedono–shqiptar që kjo politikë solli, fakt është që qeverisja maqedonase edhe në periudhën 1998/2001 ishte disproporcionalisht në duart e elementit etnik maqedonas, i cili merrte vendimet thelbësore qeverisëse pa përfillur interesat substanciale të elementit etnik shqiptar.

### **2.1.3 Diskriminimi institucional. Nënperfaqësimi i shqiptarëve në të gjitha nivelet e administratës**

Përfytyrimi për shtetin i elitës politike dhe intelektuale maqedonase në fillimet e pavarësisë nuk dallonte nga periudhat e mëhershme jugosllave. Ai mbetej i ngurtë, i mbyllur, ksenofob,

<sup>58</sup> Nikola Ambarkov. Features of the Macedonian Power Sharing Model and its Future. DOI. 10.20554/Horizons.

A.19.1.16 P07.UDC 342.33 (497.7). Faqe 80

(<http://www.uklo.edu.mk/filemanager/HORIZONTI%202017/Horizontali%20serija%20A%20volume%2019/7.%20Features%20of%20the%20Macedonian%20power-sharing%20model%20and%20its%20future-%20Nikola%20Ambarkov.pdf>)

<sup>59</sup> Macedonia: Towards destabilisation? The Kosovo crisis takes it toll on Macedonia, ICG South Balkan Report, 17 January 2001, Faqe 9,

([https://www1.essex.ac.uk/armedcon/world/europe/south\\_east\\_europe/macedonia/MacedoniaTowardsDestabilisation.pdf](https://www1.essex.ac.uk/armedcon/world/europe/south_east_europe/macedonia/MacedoniaTowardsDestabilisation.pdf))

etnocentrik dhe nacionalist. Shteti shihej si monoetnik, si shtet kombëtar i popullit maqedonas, kurse institucionet shtetërore si mbrojtëse të interesave partikulare të pronarit të tij. Në këtë drejtim, elementi shqiptar e kishte të rëndë në mos të pamundur të integrohej në administratën shtetërore e publike edhe po të donte një gjë të tillë.

Institucionet publike në vend mbetën edhe përgjatë periudhës demokratike në masë të madhe monoetnike me një dominancë të madhe të elementit maqedonas në to. Edhe pse partitë politike shqiptare ishin pjesë e qeverisjeve të ndryshme qendrore kurse pushteti lokal në disa komuna urbane dhe rurale ishte në duart e shumicës shqiptare, përsëri kjo ndikonte në masë të vogël ose aspak në përfaqësimin e shqiptarëve në institucionet shtetërore.

Në fakt përqindja e shqiptarëve në administratën shtetërore, nëpër ministri, në agjencitë e ndryshme qeveritare, në pushtetin gjyqësor dhe përgjithësisht në administratën publike mbeti e ulët. Shqiptarët ishin të diskriminuar dhe të nënperfaqësuar në administratë përgjatë dekadës 1991-2001.

Një numër institucioneesh kanë dhënë në periudha të ndryshme kohore raporte të ndryshme dhe shpeshherë kontradiktore në lidhje me përfaqësimin e grupeve etnike në institucionet e shtetit.

Sipas liderit të PPD, Nevzat Halili, në qershor 1993, asnjë Kryetar Gjykate në Republikë nuk ishte shqiptar, ndërsa në Shtabin e Përgjithshëm të Armatës së Maqedonisë, në Ministrinë e Brendshme dhe të Jashtme nuk kishte asnjë shqiptar<sup>60</sup>. Kështu, për vitin 1994, sipas të dhënave të publikuara në Flakën e Vëllazërimit, një gazetë e vetme në gjuhën shqipe që dilte tre herë në javë në Shkup, të punësuarit maqedonas në sektorin publik ishin 80.6% e numrit të përgjithshëm, kurse numri i shqiptarëve vetëm 10.4<sup>61</sup>.

Në vitin 1995, në Ministrinë e Urbanizimit, Financave, edhe në atë për Punë dhe Politikë Sociale pa njësitë rajonale nga 400 të punësuar, vetëm dy kanë qenë pjesëtarë të komunitetit shqiptar; në forcat e mbrojtjes, përkatësisht në armatë, nga 3.700 eprorë ushtarakë, shqiptarë ishin 63 ose vetëm 1%; në Ministrinë e Punëve të Brendshme, vetëm 3% e gjithë të punësuarve ishin shqiptarë; në Ministrinë e Shkencës dhe Kulturës kishte vetëm një të punësuar shqiptar, në Ministrinë e Jashtme, asnjë të vetëm; në sistemin juridik, që përfshin gjykatës, prokurorë, avokatë publikë dhe gjykatës për kundërvajtje, nga 702 të punësuar, shqiptarë ishin 32 ose vetëm 4.5%; në Doganë nga 430 të punësuar, vetëm 6 ishin shqiptarë, kurse në Entin Shtetëror Statistikor nga 192 të punësuar, vetëm 1 ishte shqiptar<sup>62</sup>.

Këto shifra tregojnë diskrepancën e madhe që ekzistonte mes shifrës zyrtare prej 22.86% të shqiptarëve në numrin e përgjithshëm të popullsisë sipas regjistrimit të vitit 1994 dhe përqindjes së tyre në organet e administratës shtetërore dhe publike. Këto të dhëna tregojnë diskriminimin e

<sup>60</sup> Hugh Poulton, vepra e cituar, faqe 188

<sup>61</sup> Michael Mandelbaum edit, The New European Diasporas. National Minorities and Conflict in Eastern Europe, Council on Foreign Relations, 2000, faqe 244

<sup>62</sup> Etem Aziri, vepra e cituar, faqe 129

rëndë që i bëhej komunitetit shqiptar në përfaqësimin institucional në Maqedoni dhe vërtetojnë empirikisht tezën politike të kapjes së shtetit nga elita e komunitetit maqedonas në vitet e paspavarësisimit e thënë shumë herë si nga përfaqësuesit politikë shqiptarë, ashtu edhe nga përfaqësues të caktuar ndërkombëtarë.

Në vitin 1998, kur pati edhe ndryshim të qeverisë, në administratën publike dallimet mes të punësuarve shqiptarë dhe maqedonas mbeteshin të mëdha. Përqindja e përgjithshme e shqiptarëve në sektorët publikë shtetërorë ishte 7, ndërsa e maqedonasve 85<sup>63</sup>.

Sipas Departamentit Amerikan të Shtetit, në vitin 1998, shqiptarët etnikë ishin vetëm 8% e të punësuarve në Ministrinë e Punëve të Brendshme, kurse në Ministrinë e Mbrojtjes edhe pse zv. ministri ishte shqiptar, vetëm një nga tetë gjeneralët ishte i tillë, por vetëm 3% e të punësuarve civilë ishin shqiptarë<sup>64</sup>.

Në vitet 1991–1998, në qytetet ku shqiptarët ishin pakicë e popullsisë, nuk ka pasur asnjë shqiptar në pozita udhëheqëse; në qytete me numër të konsiderueshëm të popullsisë shqiptare, si Struga apo Kërçova, kishte vetëm një të vetëm, në Shkup dy, ndërsa në qytete me shumicë të madhe shqiptare të popullsisë, pozitat e tilla kanë qenë të pakta, edhe atë: Në Tetovë 6, Gostivar 4 dhe Dibër 7 persona të përkatësisë shqiptare kanë udhëhequr me sektorët publikë<sup>65</sup>.

Në vitet 1998–2001, në kuadër të politikave të qeverisë së re djathtë maqedonase, vërehet një relaksim i rezistencës maqedonase ndaj inkuadrimit të pjesëtarëve të komunitetit shqiptar në organet shtetërore. Me këtë, përfaqësimi shqiptar u shtua në shifra modeste nëpër të gjitha institucionet shtetërore, qofshin qendrore a lokale. U rrit numri i diplomatëve shqiptarë në përfaqësitë jashtë vendit, në MPB, si dhe në institucionet e vetëqeverisjes lokale. Për herë të parë edhe disa shefa në sektorë sensibilë si ato të policisë, i morën kuadro shqiptare<sup>66</sup>.

Të dhëna të këtilla për periudhën e njëjtë kohore jepen edhe nga autorë të caktuar maqedonas. Kështu (sipas Maleska.1998), nga 477 gjykatës të Gjykatave Themelore, 6.9% janë shqiptarë, në Gjykatat e Apelit, nga 88 gjykatës, 9.15% janë shqiptarë, ndërsa nga 25 gjykatës të Gjykatës Supreme, katër janë shqiptarë<sup>67</sup>.

Sipas një autori tjetër (Ortakovski.2001), në të dhënat për vitin 2000, shqiptarët në Armatë, varësisht nga viti i rekrutimit, përbënin 16–26% të rekrutëve, kurse numri i punonjësve civilë në Ministrinë e Mbrojtjes ishte 2.87%. Në gjykatat themelore, 87% e gjykatësve ishin maqedonas dhe vetëm 6.9% shqiptarë<sup>68</sup>.

---

<sup>63</sup> Jeton Shasivari, vepra e cituar, faqe 102

<sup>64</sup> Poulton, vepra e cituar, faqe 189

<sup>65</sup> Zeqirja Rexhepi, vepra e cituar, informacione nga gazeta ditore, Flaka 19 -24 gusht 2002, faqe 148

<sup>66</sup> Zeqirja Rexhepi, vepra e cituar, informacione nga Flaka, 31.08.2002, faqe 149

<sup>67</sup> Mirjana Maleska, vepra e cituar, faqe 52

<sup>68</sup> Vladimir T. Ortakovski, *Interethnic Relations and Minorities in the Republic of Macedonia*, Në: Southeast European Politics, Vol. 2, No. 1, pp. 24 – 45, May 2001, faqe 33

Të dhënat e autorëve vendës dhe të huaj si dhe të dhënat nga vetë autoritetet shtetërore në lidhje me problematikën në fjalë, edhe pse të mangëta dhe të pakta, vërtetojnë faktin e gjithëpranuar që popullsia shqiptare në gjithë periudhën në fjalë 1991–2001, me gjithë ndryshimet pozitive modeste për vitet 1998–2001, nuk është përfaqësuar në institucionet publike në proporcion të drejtë me pjesëmarrjen e saj në numrin e përgjithshëm të popullsisë në shtet.

Kjo ka bërë që lojaliteti i komunitetit shqiptar ndaj shtetit, aq i kërkuar nga elitat maqedonase, të mos jetë në shkallë të njëjtë me atë të komunitetit maqedonas. Shqiptarët në fakt, duke mos qenë të përfaqësuar në mënyrë proporcionale dhe adekuate në administratën shtetërore dhe atë publike, e kanë perceptuar shtetin si të maqedonasve etnikë. Paradoksalisht sa më e madhe distanca e shqiptarëve nga shteti, aq më i afërt ose i madh identifikimi i maqedonasve etnikë me të. Në fakt në gjithë këtë periudhë kohore, maqedonasit e kanë ndjerë shtetin si të tyrin dhe si mekanizëm apo instrument që i mbron ata nga rreziku minues i një pakice të huaj, si ajo shqiptare.

Mospërfaqësimi i drejtë dhe adekuat i shqiptarëve në institucionet e sistemit, mbeti edhe në këtë kohë ndër shkaqet themelore të pakënaqësisë kolektive shqiptare. Me këtë edhe burim i drejtpërdrejtë i tensioneve dhe animoziteteve etnike, për pasojë edhe i marrëdhënieve jo të mira etnike.

#### **2.1.4 Diskriminimi në sistemin edukativ-arsimor, kulturë**

Arsimi në gjuhën amtare është ndër objektivat primarë politikë të grupeve etnike në shoqëritë shumetnike. Kjo pasi vetëm një arsim gjithëpërfshirës në gjuhën amtare është garanti i vazhdimësisë kulturore dhe mbijetesës identitete të grupeve etnike, gjuhësore në një shoqëri. Në Maqedoninë e Veriut gjuha maqedonase, duke qenë gjuhë amtare e shumicës relative të popullsisë është përdorur e papenguar në të gjitha nivelet e arsimit në vend.

Shqipja nga ana tjetër është përdorur në një hapësirë më të ngushtë gjeografike si pasojë e vendimeve restriktive politike që i kanë pamundësuar një përdorim më të gjerë. Në periudhën 1991–2001, komuniteti i dytë më i madh i popullsisë është përballur me sfida të rënda edhe në këtë sferë.

Kështu, në gjithë periudhën 1991–1996, shifrat zyrtare e nxënësve të shkollave të mesme me mësim në gjuhën shqipe, ka qenë shumë poshtë përfshirjes reale kur të krahasohen me përqindjen e shqiptarëve në numrin e gjithmbarshëm të popullsisë. Kështu, sipas informacioneve zyrtare, përqindjet e nxënësve shqiptarë në arsimin sekondar kanë shkuar nga pika më e ulët

historike, 2.875 ose 4.0% në vitin shkollor 1991/92 deri te 8.812 ose 11.0 për vitin shkollor 1995/6<sup>69</sup>.

Në vitin 1998, duket një rritje tjetër e numrit të nxënësve nga të quajturat “minoritete” bashkë, me 14% nga numri i përgjithshëm i nxënësve në arsimin e mesëm në Maqedoni<sup>70</sup>. Në gjithë periudhën në fjalë është parë edhe një përpjekje e vazhdueshme e politikës maqedonase që të fshehë dhe mjegullojë shifrat e nxënësve shqiptarë në sistemin edukativ arsimor, duke publikuar në të shumtën e rasteve të dhëna statistikore për totalin e nxënësve të siç thuhej në terminologjinë e kohës, “pakicave tjera kombëtare”. Me këtë fshihej fakti i diskriminimit të rëndë dhe masiv të grupit të dytë më të madh etnik, i cili ishte shumë herë më i madh në numër se gjithë pakicat e tjera marrë së bashku.

Me gjithë rritjen e ngadalshme dhe të vazhdueshme të numrit të nxënësve shqiptarë në arsimin e mesëm, pjesa më e madhe e tyre, me gjithë vullnetin e shprehur, nuk mundej të regjistrohej në arsimin e mesëm. Shifrat e nxënësve shqiptarë në arsimin e mesëm nuk kaluan asnjëherë 30% të totalit të gjithë atyre nxënësve që mbaronin arsimin fillor në gjuhën shqipe.

Çështje serioze në arsimin shqip dhe tensionuese e përhershme e marrëdhënieve qeveri – përfaqësues shqiptarë, mbetej edhe arsimi i lartë për studentët shqiptarë. Kurset në gjuhën shqipe në Fakultetin Pedagogjik në Shkup apo kuotat thellësisht diskriminuese për pakicat kombëtare nuk plotësonin asesi nevojat e shkollarëve shqiptarë për arsim të lartë. Kështu, shumica prej tyre ishin të detyruar të largohen për studime jashtë vendit. Por, mundësitë e tilla ishin të kufizuara duke bërë që numrat të jenë simbolikë, kurse përqindja e studentëve shqiptarë tek ajo e studentëve të larguar nga vendi për studime të larta të jetë më e madhe edhe se e vetë studentëve maqedonas.

Një gjendje e tillë krejtësisht e palakmueshme në arsimin e lartë, si dhe pengesat serioze në opinionin publik e shoqëror maqedonas ndaj shtimit të numrit të studentëve shqiptarë në Fakultetin Pedagogjik në Shkup, e shprehur publikisht dhe në shumë raste nga parti, struktura, politikanë dhe aktivistë të shumtë, bënë që forca të caktuara intelektuale dhe politike tek komuniteti shqiptar të ndërmarrin hapa për themelimin e institucionit të lartë arsimor në gjuhën shqipe, Universitetit të Tetovës.

Më 17.12.1994, një numër deputetësh shqiptarë të Kuvendit Republikan, përfaqësues komunalë nga komunat me shumicë shqiptare të popullsisë, përfaqësues të partive politike shqiptare dhe të shoqatave të ndryshme, mbajti kuvend themelues dhe vendosi formimin e Universitetit të

---

<sup>69</sup> Vladimir T. Ortakovski, vepra e cituar, nga: The Ministry of Education and Physical Culture, Table 2: Number of students in secondary schools according to the language of instruction, faqe 31

<sup>70</sup> Poulton, vepra e cituar, faqe 185

Tetovës me gjashtë fakultete dhe 600 studentë, brenda ligjeve dhe kurikulave maqedonase për arsimin e lartë<sup>71</sup>.

Reagimi i politikës maqedonase ishte i menjëhershëm dhe agresiv. Përderisa zyrtarët më të lartë shtetërorë e dënuan atë si akt nacionalist shqiptar, organet e Punëve të Brendshme ndërmoren aksione të dhunshme, që çuan në burgosjen e rektorit të zgjedhur, z. Fadil Sulejmani, një numri ligjëruesish si dhe vrasjen e një protestuesi gjatë aksionit për shkatërrimin e objektit universitar që për autoritetet ishte ilegal.

Në vitin 1995, numri i studentëve shqiptarë në dy universitetet e vetme shtetërore në Maqedoni, atë të Shkupit dhe Manastirit, ishte 764 ose vetëm 2.8 e numrit të përgjithshëm të studentëve në nivel republike<sup>72</sup>. Në vitet në vijim pati përmirësime kozmetike që nuk ishin as për së afërmi në raport të drejtë me kërkesat dhe nevojat e nxënësve shqiptarë që përfundonin arsimin e mesëm. Kështu në vitin akademik 2001/02, numri i shqiptarëve në arsimin e lartë ishte vetëm 4% e numrit të përgjithshëm të studentëve të regjistruar në arsimin terciar, kurse ai i maqedonasve 88.9 %<sup>73</sup>.

Duke qenë një temë eksplozive, për sa u përket marrëdhënieve etnike dhe duke i tensionuar në vazhdimësi ato, bashkësia ndërkombëtare nëpërmjet përfaqësuesit të saj në Maqedoni, ambasadorit të OSBE për pakicat kombëtare, Max van der Stoel, bëri përpjekje të vazhdueshme për zgjidhjen e kontestit në fjalë. Si rezultat i këtyre përpjekjeve, i ndryshimit në skenën politike të vendit dhe i ndryshimit të qëndrimit në lidhje me statusin e Universitetit të papranuar të Tetovës nga një pjesë e politikës shqiptare, në vitin 2001 u themelua në Tetovë, Institucioni privat i arsimit të lartë, Universiteti i Europës Juglindore, në tre gjuhë, shqip, maqedonisht dhe anglisht, fillimisht me 4000 studentë<sup>74</sup>.

Gjithsesi, çështja me arsimin e lartë publik në gjuhën shqipe në vend, mbeti e paadresuar sa dhe si duhet edhe në këtë periudhë të zhvillimeve shoqërore në Maqedoni, duke qenë një ndër faktorët kryesorë të marrëdhënieve jo të mira politike, sociale dhe etnike në shoqëri, si dhe duke tensionuar me raste dhe në vijimësi marrëdhëniet mes dy grupeve të mëdha etnike.

Në sferën e kulturës, një përbërës me rëndësi për ruajtjen dhe afirmimin e identiteteve kolektive në shoqëritë shumetnike dhe përgjithësisht, në periudhën në fjalë gjendja ishte skandaloze. Ekzistonte një diskriminim i thellë, i gjithanshëm, një lloj refuzimi dhe bojkoti i organizuar shtetëror ndaj kulturës shqiptare. Kjo shihet në prezencën e kulturës shqiptare në mediat publike,

---

<sup>71</sup> Kahl, Maksuti, Ramaj (Hg), vepra e cituar. Vor dem Sturm: Makedoniens Albaner am Ende des 20. Jahrhunderts, Michael Schmidt – Neke, Faqe 79

<sup>72</sup> Kahl, Maksuti, Ramaj (hg)., vepra e cituar, Tab.2 Studenten auf makedonischen Universitäten nach Nationalität 1995, faqe 78

<sup>73</sup> Alajdin Abazi, Kontributi I UEJL në Tetovë për implementimin e Marrëveshjes së Ohrit, faqe 208, në: Implementimi I Marrëveshjes të Ohrit, Shkup 2003

<sup>74</sup> Kahl, Maksuti, Ramaj (Hg), vepra e cituar, Minderheiten in der Republik Makedonien: Eine Chance für die Interkulturalität, Thede Kahl, faqe 158, 159

TV, gazeta, revista, periodikë, në shumat që ministria përgjegjëse e kulturës ka alokuar për të promovuar projekte me rëndësi për kulturën shqipe, si botime të ndryshme shkencore, në sferën e arteve pamore, dramatike. Në gjithë këto sektorë vitalë për kulturën shqiptare dhe atë komunitare përgjithësisht, në dekadën e parë të pavarësisë ajo është diskriminuar rëndshëm dhe në mënyrë konstante.

Sidomos e rëndë paraqitej gjendja në mediat vizive publike që financohen në mënyrë të barabartë nga gjithë taksapaguesit vendorë. Kështu gjatë vitit 1993, Televizioni i Shkupit në të gjitha kanalet e tij, kishte vetëm 55 minuta program ditor në gjuhën shqipe, kurse nga 64 orë programe ditore të gjitha radiove në vend, vetëm 6 ishin në shqip<sup>75</sup>. Me gjithë përparimet e bëra në këtë drejtim, në vitin 1998, programi ditor në gjuhën shqipe në transmetuesin e vetëm publik të vendit ishte vetëm dy orë. Pas vitit 1992 u themeluan edhe transmetues tjerë privatë prej të cilave disa pak edhe në gjuhën shqipe, por problemi kryesor ishte me transmetuesit publikë të cilët janë të besueshëm, pasqyrojnë interesat komunitare pa dallim dhe mbrojnë interesin publik.

Në momente të caktuara qeveria e kontrolluar nga maqedonas etnikë ka bërë përpjekje për të goditur transmetuesit privatë në gjuhën shqipe, duke u arsyetuar me argumente të natyrave teknike. Kështu më 19 maj të vitit 1995, qeveria ka urdhëruar mbylljen e menjëhershme të tetëdhjetë e tetë stacioneve radiofonike dhe televizive private<sup>76</sup>. Duket që motivet prapa kësaj urdhërese kanë qenë dëmtimi ose eliminimi i transmetuesve privatë në gjuhën shqipe në vend. Nga totali i lejeve të dhëna përgjatë viteve, për transmetues në gjuhën shqipe, për radio ishin 14 leje dhe për televizione, 13 të tjera.<sup>77</sup>

Në sferën e shtypit të shkruar deri në vitin 1998, kur u themelua privatisht gazeta në gjuhën shqipe, Fakti, botohej vetëm një gazetë në gjuhën shqipe, Flaka e Vëllazërimit.

Në mbarë territorin e Republikës kishte vetëm një teatër profesionist në gjuhën shqipe, ai i quajtur i pakicës shqiptare në Shkup, kurse mjetet e ndara nga buxheti shtetëror për kulturën shqiptare ishin krejtësisht të papërfillshme. Ato jepeshin kryesisht për disa shoqëri të quajtura kulturore – artistike, që si objekt primar kishin ruajtjen e melosit popullor të pakicave kombëtare.

Pjesa dërmuese e mjeteve të parapara për kulturë në dekadën në fjalë, shkonin vazhdimisht për projekte të rëndësishme dhe të kushtueshme për kulturën e komunitetit maqedonas.

### **2.1.5 Diskriminimi socio-ekonomik**

---

<sup>75</sup> Poulton, vepra e cituar, faqe 188, sipas Albanian Radio, Tirana, 12 June 1993 in BBC SWB EE/1714 C1/22, 14 June 1993

<sup>76</sup> Fred Abrahams, A Threat to "Stability". Human Rights Violations in Macedonia, HRW/Helsinki, June 1996, faqe 50 (Google E-Book: [https://books.google.mk/books?id=A\\_mfZfytdiEC&printsec=frontcover&source=gbs\\_ge\\_summary\\_r&cad=0#v=onepage&q&f=false](https://books.google.mk/books?id=A_mfZfytdiEC&printsec=frontcover&source=gbs_ge_summary_r&cad=0#v=onepage&q&f=false))

<sup>77</sup> An Assesment of Ethnic Relations in Macedonia, USAID/Macedonia, December 2000, faqe 16; versioni online: [https://pdf.usaid.gov/pdf\\_docs/PNACK427.pdf](https://pdf.usaid.gov/pdf_docs/PNACK427.pdf)



Një aspekt me rëndësi ose faktor i rëndësishëm i demokratizimit dhe zhvillimit të drejtë të një shoqërie është gjendja e përgjithshme ekonomike e saj. Situata e përgjithshme sociale është ndër faktorët me rëndësi edhe pse jo vendimtar që kanë ndikimin e tyre në marrëdhëniet e përgjithshme sociale, në ndërkomunikimin njerëzor e me këtë edhe në sferën e marrëdhënieve mes grupeve të ndryshme etnike. Gjendja e pasigurisë sociale në momente jo se shkakton por ka prirjen të përkeqësojë edhe raportet tjera. Në fakt, në çdo shoqëri, përballja ose lufta për resurse si dhe ndarja e drejtë e tyre mes përbërësve të saj, është ndër burimet kryesore të atij që mund të quhet konflikti shoqëror në kohën e sotme.

Mosmarrëveshjet dhe përballjet janë të zakonshme edhe në shoqëritë kryesisht monoetnike ose homogjene ku mosmarrëveshjet dhe konfliktet mund të jenë të motivuara apo të shkojnë përgjatë vijave klasore, regjionale, partiake politike, religjioze apo tjera. Në shoqëritë shumetnike nga ana tjetër, ku përkatësia etnike merret si burim mundësie ose nga ana tjetër si burim diskriminimi apo pengese për progres social, faktorët ekonomikë socialë marrin një dimension të ri e të rrezikshëm për baraspeshat shoqërore.

Në këtë drejtim, gjendja ekonomike e përgjithshme në Maqedoninë e Veriut përgjatë viteve 1991/2001 nuk është se ka qenë në nivele të larta apo edhe afër mesatares europiane. E gjithë periudha në fjalë mund të ndahet në atë të rënies ekonomike që përfshin vitet 1990 – 1993, fazën vijuese të stanjacionit përgjatë viteve 1994 – 1997 dhe atë të një ringjallje relative për vitet 1998-1999<sup>78</sup>.

Duke trashëguar një ekonomi të centralizuar socialiste të paaftë për të përballuar tregun e përbashkët europian si dhe e ballafaquar me një embargo nga fqinji i saj jugor, vendi u zhyt në një recesion të thellë ekonomik në vitet e para të pavarësisht. Vështirësitë ekonomike i goditën më së shumti shtresat më të ekspozuara sociale si dhe rajonet më të pazhvilluara të vendit. Këto janë kryesisht zonat veriperëndimore që kanë nivelin e industrializimit dhe urbanizimit më të ulët në Republikë. Këto janë edhe pjesët që në shumicë banojnë nga shqiptarë etnikë. Që shqiptarët në masë të madhe kanë qenë të përjashtuar nga procesi industrializues dhe urbanizues tregojnë edhe të dhënat e strukturës profesionale të popullsisë nga viti 1994 sipas së cilës vetëm 6. 438 shqiptarë në Maqedoni ka qenë angazhuar në profesionet e nëpunësve aktivë përkundrejt 92. 812 personave të bashkësisë etnike maqedonase<sup>79</sup>.

Në këtë periudhë u bë edhe privatizimi i ekonomisë shoqërore, pra kalimi i kapitalit ekonomik nga kontrolli shtetëror në duart e personave privatë. Ky ishte një proces kryesisht i menaxhuar e kontrolluar nga elita maqedonase për më shumë arsye.

---

<sup>78</sup> Macedonia, 1989/1999, Skopje 2001. Svetlana Antonovska. Economic and Statistical Analyses of the Macedonian Economy in the Period 1989 – 1999, faqe 14

<sup>79</sup> Rahmi Veliu, Shtrirja gjeografike dhe lëvizja e numrit të popullsisë shqiptare në Maqedoni, Çabej, Tetovë, 2002, Faqe 67

Së pari numri i shqiptarëve të punësuar në ekonominë shtetërore jugosllave ishte simbolik. Komuniteti shqiptar ishte në masë të madhe i përjashtuar nga jeta ekonomike e vendit, në kuptim të punësimit në ndërmarrje publike. Me këtë blerja e pronës dhe ndërmarrjes nga blerësit e brendshëm apo internë penalizoi me automatizëm shqiptarët e pa ose shumë pak të përfaqësuar në sektorin e ekonomisë publike. Së dyti, modeli i zgjedhur nga autoritetet shtetërore maqedonase me ndërhyrjen e drejtpërdrejtë të autoriteteve më të larta shtetërore ishte i tillë që të përjashtojë sa më shumë shqiptarët nga privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore<sup>80</sup>.

Kështu mbi 90% e ndërmarrjeve dhe ekonomisë në përgjithësi u privatizua nga elementë maqedonas të afërt me pushtetin qendror. Nga ana tjetër, edhe pse jo në mënyrë të deklaruar, publike e ligjore, komuniteti shqiptar nuk mundi të jetë partner dhe pjesëmarrës i barabartë dhe meritator në privatizimin e aseteve shoqërore përgjatë viteve 1989-1995. Kapitali i privatizuar që ishte krijuar me punë të përbashkët në vlerë nominale prej 2 miliardë e 330 milionë euro u nda në një mënyrë krejtësisht të padrejtë nga ana etnike, me Tetovën si shembull përfaqësues, ku 80% popullsisë shqiptare privatizoi vetëm 10% të pronës shoqërore<sup>81</sup>.

Mospjesëmarrja në privatizim si mundësi për gjenerim të të hyrave dhe progres social, prezenca e paktë në jetën ekonomike, si dhe situata e përgjithshme e rënduar ekonomike, bëri që largimi i popullsisë nga vendi të godasë rëndë dhe më së shumti popullsinë shqiptare. Të kushtëzuar nga gjendja e rëndë ekonomike, të diskriminuar dhe të kufizuar nga ana sociale, pjesa produktive e shoqërisë shqiptare u largua me ritme të shpejta. Kjo jo vetëm që nuk kontribuoi në qetësimin, por i tensionoi edhe më shumë marrëdhëniet mes grupeve kryesore etnike në Maqedoni.

Investimet publike të financuara në mënyrë të drejtpërdrejtë nga buxheti republikan, në rajone dhe vendbanime të ndryshme janë po ashtu një tregues i qartë i barazisë ose diskriminimit në ndarjen e tyre. Në Maqedoni tradicionalisht ndarja është në disfavor të rajoneve ku shumica e popullsisë është shqiptare. Kjo praktikë vazhdonte edhe në dekadën e parë ta pavarësisë. Investimet në shkolla, rrugë, spitale, dhe objekte të tjera me rëndësi publike në zonat perëndimore të vendit ishin të pakta në krahasim me zonat lindore apo gjetiu, kurse dotacionet ekonomike të buxhetit për Maqedoninë perëndimore ishin të papërfillshme (30 milionë për zonën veriperëndimore përkundër 285 milionë dollarë për pjesën tjetër gjatë vitit 2000) po të krahasohen me mjetet e dhëna për zonat qendrore e lindore të Republikës<sup>82</sup>.

Si rezultatë finale e diskriminimit të vazhdueshëm social-ekonomik erdhi gjer tek varfërimi në shkallë të gjerë i popullsisë shqiptare saqë në vitin 1997 rreth 17,321 familje shqiptare<sup>83</sup> qenë të

---

<sup>80</sup> Jeton Shasivari, vepra e cituar, faqe 102 dhe 103

<sup>81</sup> Abdylmenaf Bexheti, Një dekadë e mendimit ekonomik dhe politik. Analiza, vlerësime e projeksione në prizmin e sfidave vendore, 2006, faqe 378

<sup>82</sup> Abdylmenaf Bexheti, vepra e cituar, faqe 156, 157 dhe 191

<sup>83</sup> Jordan Jovanovski, Socijalnata sigurnost na graganite korisnici na socijalna pomos vo Makedonija, në: Socijalnata sigurnost na naselenieto vo Republika Makedonija vo uslovi na tranzicija, Skopje 1998, Faqe 87

detyruar të shfrytëzojnë ndihmat sociale, si mjetin e fundit të mbijetesës, pasi nuk ishin në gjendje të sigurojnë minimumin e nivelit të ekzistencës.

### **2.1.6 Dhuna policore dhe shkelja e të drejtave e lirive të njeriut**

Një aspekt mjaft i rëndë dhe i dukshëm i gjendjes aspak të mira me liritë dhe të drejtat individuale dhe kolektive të shqiptarëve në Maqedoni përgjatë periudhës postpavarësi dhe para konfliktit të armatosur, ishte përdorimi në momente të caktuara i dhunës së drejtpërdrejtë fizike ndaj qytetarëve shqiptarë. Autoritetet shtetërore në raste keqpërdorën aparatit gati ekskluzivisht njëetnik të Ministrisë së Punëve të Brendshme për të intimiduar dhe dëmtuar individë të veçantë, aktivistë të ndryshëm shoqërorë apo edhe grupe politike nga radhët e komunitetit shqiptar. Në të shumtën e rasteve organet policore kanë vepruar, duke tejkaluar kompetencat e tyre ligjore dhe duke ndërhyrë në çështje me karakter politik.

Incidentet ndërmjet qeverisë maqedonase në disa raste kanë qenë serioze, gjë që ka çuar tek ndërhyrja politike e faktorëve ndërkombëtarë si Bashkimi Europian, OSBE apo edhe UNPREDEP në çështjet e brendshme maqedonase<sup>84</sup>.

Por, problemet e para të kësaj natyre në Maqedoninë e pavarur filluan që në vitin 1992. Kur themi ndërhyrjet e para e kemi parasysh periudhën e pas konsolidimit të shtetit të ri maqedonas, domethënë periudhën pas shtator/tetorit 1991 dhe në vazhdim, kur kontrollin e forcave të sigurisë e mori qeveria e Maqedonisë së pavarur, kurse në përbërjen e organeve të rendit nuk kishte më elementë nga rajonet tjera të ish shtetit jugosllav.

Në fund të vitit 1991 dhe në fillim të vitit 1992, përfaqësuesit politikë shqiptarë organizuan referendumin për autonomi territoriale politike të shqiptarëve në Maqedoni. Ishte një shprehje e lirë dhe demokratike e vullnetit politik të qytetarëve shqiptarë e shprehur publikisht për t'u organizuar në një njësi territoriale politike pas dështimit të klasës politike maqedonase për të miratuar me kompromis një kushtetutë binacionale. Ishte kjo një përpjekje e klasës politike shqiptare që në pamundësi të integritit në shoqërinë maqedonase dhe para refuzimit maqedonas për bashkëpunim dhe përfshirje, për të krijuar institucione paralele shqiptare në shoqëri. Reagimi i organeve policore ishte i ashpër. Një numër i aktivistëve u burgosën, organizatorët u përdoqën, i gjithë procesi u vëzhgua drejtpërsëdrejti nga agjentë policorë, kurse një pjesë e madhe e materialeve votuese u sekuestruan. Me këtë organet legjitime komunitare u pamundësuan në punën e tyre nga organet policore që paraqiste një shkelje të rëndë të lirive e të drejtave si individuale, ashtu edhe kolektive të individëve dhe grupeve të përfshira në këtë organizim.

---

<sup>84</sup> Ladislav Lesnikovski, Macedonia's Ontological Insecurity and the Challenges of Stabilizing Inter-ethnic Relations, faqe 66. Versioni online: ([http://src-h.slav.hokudai.ac.jp/publictn/eurasia\\_border\\_review/ebr2/5\\_lesnikovski.pdf](http://src-h.slav.hokudai.ac.jp/publictn/eurasia_border_review/ebr2/5_lesnikovski.pdf))

Më 15 qershor 1992 rreth 850 policë të shtetit<sup>85</sup>, ekskluzivisht maqedonas etnikë bënë një ndërhyrje brutale në disa fshatra të banuara nga komuniteti shqiptar në zonën e Strugës. Arsyetimi publik u dha më vonë. Sipas versionit zyrtar, kërkoheshin të arrestohen 13 persona në kërkim si dhe atyre që posedonin armë pa leje.

Muaji nëntor 1992 solli intervenimin e radhës në Shkup, brutal dhe jashtë çdo standardi apo norme të akceptueshme ligjore. Intervenimi ishte masiv saqë në mediat e huaja bëhej fjalë për përplasje të përgjakshme mes mijëra qytetarëve të etnisë shqiptare dhe qindra policëve maqedonas<sup>86</sup>. Në këtë aksion të dhunshëm dhe krejtësisht të panevojshëm humbën jetën katër qytetarë, dhjetëra u plagosën, kurse shumë të tjerë u arrestuan pa asnjë bazë ligjore. Ishte hera e parë që shteti i ri përdorte dhunë të organizuar, mbiproporcionale kundër qytetarëve shtetas të vet, duke shfrytëzuar policinë në radhët e së cilës nuk kishte fare prezencë të policëve prej grupit etnik kundër të cilit drejtohej dhuna. Në raportin e Mazovjeckit për Asamblenë e përgjithshme dhe Këshillin e Sigurimit të OKB, marrëdhëniet ndëretnike në vend cilësohen si delikate dhe larg stabile<sup>87</sup>.

Intervenimi i tretë i rrezikshëm për stabilitetin edhe ashtu delikat të brendshëm dhe për marrëdhëniet ndëretnike u bë në fund të nëntorit 1993, me zbulimin e të quajturës Ushtri paramilitare shqiptare në Maqedoni, e cila funksiononte jashtë sistemit legal të vendit. Edhe këtu informacionet e dhëna ishin krejtësisht jo të provueshme pasi aksionet e këtilla organizoheshin nga struktura shtetërore gati të pastra etnikisht, si policia dhe gjykatat. Nga ky aksion i policisë së shtetit humbi jetën në paraburgim një qytetar shqiptar, kurse një numër i madh u dënuan me burgime të gjata. Pati një numër shkeljesh ligjore në gjithë këtë proces që bën të mendosh për aksionin si të motivuar politikisht<sup>88</sup>.

Në vitin 1995, gjatë përpjekjeve për të rrënuar objektin e cilësuar si ilegal dhe të egër nga qeveria maqedonase në Reçicë të Tetovës, Policia u përball dhunshëm me një numër të qytetarëve paqësorë e të paarmatosur, të cilët mbronin atë që e shihnin si universitet të tyrin. Në mbrojtje të këtij institucioni ilegal për pjesën maqedonase të qeverisë, dolën edhe politikanë shqiptarë anëtarë të parlamentit të kohës, elita intelektuale shqiptare pa përjashtim, shoqata të ndryshme civile, si dhe organizma të pavarur ndërkombëtarë që mbronin liritë e të drejtat themelore të njeriut e kolektiviteteve. Ishte një konsensus i plotë komunitar për nevojën e arsimit të lartë në gjuhë amtare si e drejtë e patjetërsueshme e shqiptarëve këtu.

Ndërhyrja nga ana tjetër ishte e rëndë dhe jonormale për çështje apo konteste të një natyre të tillë edukative arsimore. Ndërtesa ku studentët duhej të mbanin ligjëratat e tyre u shkatërrua me buldozerë, pajisjet u konfiskuan, ndërsa u arrestuan zyrtarët e universitetit së bashku me rektorin e tij, z.Sulejmani. Në përballje humbi jetën një protestues dhe u plagosën me lëndime më të lehta

<sup>85</sup> Etem Aziri, vepra e cituar, faqe 159

<sup>86</sup> Drashko Antov, *Nezavisna Makedonija vo Germanskite Mediumi*, Skopje 2003, faqe 30

<sup>87</sup> Mirjana Maleska, vepra e cituar, faqe 101

<sup>88</sup> Fred Abrahams, *A Threat to "Stability"*. Human Rights Violations in Macedonia. HRW/Helsinki. 1996. faqe 45

apo të rënda dhjetëra të tjerë. Aksioni i forcave policore u arsyetua nga presidenti Kiro Gligorov, i cili u kërkoi forcave të sigurisë të vendosin rend dhe ligj në zonat në fjalë dhe t'u shpallin luftë separatistëve militantë<sup>89</sup>. Shihet qartë që vendimi për ndërhyrje të dhunshme ishte i krerëve më të lartë shtetërorë të kohës, përfaqësues të interesave të maqedonasve në institucionet shtetërore.

Në korrik 1997 në një skenar të përgatitur më herët autoritetet policore shtetërore, përsëri të përbëra nga efektivë krejtësisht të përkatësisë etnike maqedonase, ndërhyjnë dhunshëm duke larguar flamurin e bashkësisë shqiptare nga ndërtesat e qeverive lokale në dy qytete me shumicë etnike shqiptare në perëndim të vendit. Ndërhyrja erdhi si pasojë e vendimit jo të drejtë të Gjykatës Kushtetuese, një organ i pastër etnikisht edhe ky pa përfaqësim të drejtë të komunitetit të dytë më të madh, për joligjshmërinë e shpalosjes së flamujve të shpreheshin në atë kohë, “pakicave kombëtare” në objektet e institucioneve shtetërore.

Në Tetovë, largimi i flamurit nga objekti i qeverisjes lokale u bë natën dhe në fshehtësi të plotë. Përpjekja e njëjtë në qytetin e dytë me shumicë shqiptare në fushëgropën e Pollogut, ishte e dhunshme, me 3 të vrarë, shtatëdhjetë të plagosur, si dhe burgosjen e kryetarit të Komunës dhe 400 qytetarëve tjerë<sup>90</sup>. Një numër i studiuesve shqiptarë (Aziri. 2004 dhe Rexhepi. 2005) japin një pasqyrë reale të dhunës së rëndë dhe krejtësisht joproporcionale që është ushtruar kundër qytetarëve të rastit dhe protestuesve paqësorë në Gostivar. Personat e lënduar rëndë numëroheshin në mbi 200, rreth 700 ishin të rrahur dhe keqtrajtuar, 300 të arrestuar, 50 të paditur për veprime kundërvajtëse, si dhe një numër i madh i qytetarëve i keqtrajtuar fizikisht dhe psikikisht në ditët vijuese në të a.q biseda informative, një mbetje kjo e sistemit represiv komunist jugosllav për të intimiduar dhe kërcënuar disidencën politike të kohës. Aktet represive vazhduan edhe me padinë, burgosjen dhe dënimin me burg në kohëzgjatje më të shkurtër për kryetarin dhe kryesuesin e këshillit komunal të Tetovës.

Ndërhyrjet e dhunshme me përdorim masiv të forcave monoetnike policore dhe humbje e dëmtim në shkallë të gjerë të jetëve njerëzore të pjesëtarëve të komunitetit shqiptar në Maqedoni, në Ladorishtë dhe Bit Pazar në Shkup, procesi i montuar politik i të quajturit grupit paramilitar shqiptar më 1993, ndërhyrja në Reçicë të vogël të Tetovës, si dhe më 1997 në Gostivar, ishin kulmet e dhunës së drejtpërdrejtë policore që ushtronte shteti i kontrolluar nga maqedonasit etnikë ndaj shqiptarëve etnikë në vitet 1991/2001.

Nga ana tjetër, në këtë kohë marrëdhëniet ndëretnike janë tensionuar në vazhdimësi nga ndërhyrje dhe padrejtësi të tjera më të vogla që u janë bërë pjesëtarëve të caktuar të komunitetit shqiptar sidomos nga radhët e rekrutëve në Armatë, në organet e rendit, në stadione, në organizime e evente tjera partiake, apo raste e vende tjera të panumërta. Duke qenë se sistemi gjyqësor nuk ka qenë i predisponuar të zbulojë dhe dënojë autorët e uniformuar dhe me pushtet

---

<sup>89</sup> Drashko Antov, vepra e cituar, faqe 42, artikull I gazetës gjermane, Tages Zeitung 21.02.1995: Makedonija; Nasilno okoncuvanje na eden universitet, od Karl Kersuni

<sup>90</sup> Poulton, vepra e cituar, faqe 189

të këtyre akteve të dhunës, besimi i qytetarëve shqiptarë në këto institucione ka qenë dukshëm i ulët ose edhe non ekzistent. Në fakt ato janë parë nga shqiptarët si monoetnike dhe antishqiptare.

### **2.1.7 Rekapitullim për marrëdhëniet ndëretnike në periudhën 1991–2001**

Periudha kohore 1991-2001 është karakterizuar nga përpjekje të natyrave të ndryshme të dy komuniteteve kryesore në Maqedoninë e Veriut. Komuniteti maqedonas e ka parë shtetin maqedonas si rrumbullakësim të përpjekjeve shekullore për shtet të pavarur dhe sovran. Andaj në referendumin për pavarësi të vitit 1991, një shumicë e madhe e maqedonasve etnikë ka votuar për një shtet të pavarur dhe sovran. Në periudhën vijuese kur vendi është përballur me sanksione nga Greqia fqinje, si dhe me pengesa reale në procesin e njohjes ndërkombëtare, përfaqësuesit politikë të maqedonasve etnikë janë përpjekur për të afirmuar dhe etabluar republikën në skenën ndërkombëtare.

Duke qenë në masë të madhe bartës i funksionimit të shtetit, i mbipërfaqësuar në institucionet shtetërore, në pushtetin gjyqësor, në sistemin ekonomik etj, komuniteti maqedonas e ka parë shtetin si ekskluzivisht nacional maqedonas. Prania e tjerëve thjesht është toleruar. Shqiptarët janë parë si minorancë etnike e barabartë me pakicat tjera, e cila gëzon të gjithë të drejtat minoritare. Kërkesat politike të komunitetit shqiptar janë perceptuar si sulme kundër rendin juridik, kundër integritetit të shtetit dhe madje edhe kundër identitetit nacional maqedonas.

Partitë politike maqedonase janë parë si gardiane të modelit monoetnik qeverisës dhe me këto platforma janë votuar në të gjitha zgjedhjet parlamentare të kësaj periudhe të parë të postpavarësisë.

Komuniteti shqiptar nga ana tjetër është ndjerë i huaj në vend që në ditën e parë të referendumit për pavarësi, i cili u bojkotua masivisht ashtu si edhe procesi i regjistrimit të popullsisë së vitit 1994. Kurba e veprimtarisë politike të shqiptarëve ka shkuar nga modeli i bojkotit të plotë deri tek ai i një pjesëmarrjeje të detyruar në jetën politike si në zgjedhjet lokale dhe parlamentare me qëllimin e deklaruar të angazhimit për arritjen e barazisë nacionale dhe ekonomike.

Gjithsesi, definimi kushtetues i Maqedonisë si shtet i kombit maqedonas si bartës i sovranitetit, ka treguar që në fillim për një rrugëtim konfliktuoz dhe përjashtues ndërkombëtar në vend. Një sërë çështjesh kanë qenë problematike për zhvillimin e mirë të raporteve ndëretnike. Dhe kjo jo vetëm nga një pikëpamje shqiptare e çështjes.

Kushtetuta e vitit 1991 degradoi statusin kolektiv shqiptar në atë të një pakice të vogël e periferike kombëtare. Me këtë gjuha shqipe, si dhe simbolet me karakter kombëtar u releguan në po të njëjtin status, atë të një gjuhe minoritare dhe simbolesh në përdorim të kufizuar ose rajonal.

Një çështje mjaft sensibil që ishte burim tensioni permanent ndëretnik ishte nënpërfaqësimi i pjesëtarëve të komunitetit shqiptar në institucionet e shtetit. Këtu dallimet ndërmjet grupit

shumicë relative e popullsisë dhe atij të një pakice të konsiderueshme, ishin skandaloze. Përqindja e ulët e shqiptarëve, sidomos në organe apo trupa të tillë shtetërorë si forcat e mbrojtjes, ato të sigurisë apo edhe në sistemin gjyqësor, bënte që sentimentet shqiptare ndaj rendit juridik në fuqi, ndaj vetë shtetit të jenë të fuqishme dhe kryesisht negative.

Edhe diskriminimi i madh dhe i shprehur në sferën e rëndësishme të arsimit, si çështja me arsimin e lartë në gjuhën shqipe në vend dhe refuzimin permanent të një universiteti publik nga autoritetet shtetërore, ishin një burim serioz tensionimi dhe përplasjesh politike komunitare. Dhuna policore e shprehur brutalisht në një numër rastesh të lartpërmendura, bënte që komuniteti shqiptar të tëhujasohej nga shteti dhe biles të kërkonte forma dhe mënyra mbrojtëse nga një politikë e tillë agresive. Që këtu edhe vota e përhershme për struktura, subjekte e grupe politike që garonin me platformë afirmuese shqiptare ku përfshiheshin kryesisht çështjet kushtetuese, të zyrtarizimit të gjuhëve dhe shtimit të numrave të shqiptarëve në trupat shtetërorë.

Një zhvillim i këtillë i ngjarjeve në vend bëri që të paraqiten dy qëndrime krejtësisht të kundërta te dy komunitetet e mëdha etnike në raport me shtetin. Kështu shumica relative etnike maqedonase e konsideronte shtetin si të vetin duke e apropriuuar atë. Komuniteti shqiptar nga ana tjetër shfaqte shenja të një refuzimi parcial të sistemit politik dhe juridik i cili bëhej më i shprehur në momente të caktuara dhe për çështje me rëndësi si ajo e arsimit si shembull.

Ngushtësisht e lidhur më aproprijimin dhe refuzimin është edhe fenomeni i lojalitetit të grupit që e shihte shtetin si të tijin dhe dislojaliteti i grupit që e shihte veten në pozita inferiore në shtet dhe shoqëri. Në fakt përgjatë kësaj periudhe të antagonizmit politik, vija ndarëse apo edhe konfliktuoze kanë qenë këto dy perceptime dhe realitete paralele, por krejt të kundërta për shtetin dhe shoqërinë të dy grupeve të mëdha etnike.

Kjo bëri marrëdhëniet ndëretnike në këtë periudhë të jenë të tensionuara<sup>91</sup> që ishte pengesë thelbësore për zhvillimin e demokracisë, konsolidimin e shtetit të së drejtës, forcimin e kohezionit shoqëror, stabilitetin ekonomik, forcimin e kapaciteteve shtetërore dhe integrimin e shpejtë të vendit në familjen europiane.

## **2.2 Demarkacioni i kufirit verior si faktor iniciues për fillimin e konfliktit. Rrënjët etnike të krizës**

---

<sup>91</sup> Ilija Todorovski, Basic Information on Local Governments in Macedonia, faqe 142. Në: Local Governments in the CEE and CIS, 1994 An anthology of descriptive papers

Konflikti ndëretnik në Kosovën fqinje dhe ndërhyrjet e dhunshme të forcave serbe të sigurisë me qëllim pastrimin etnik të popullsisë shqiptare nga Kosova, bënë që deri në mesin e majit në territorin e RMV të vendosen afërsisht 230.000 mijë të dëbuar shqiptarë.<sup>92</sup>

Në vitin 2000, vitin e dytë të qeverisjes së koalicionit shumetnik në Maqedoni, gati e gjithë popullsia shqiptare me origjinë nga Kosova e akomoduar si refugjate në Maqedoni, ishte kthyer në Kosovë, kurse marrëdhëniet ndërkomunitare në Maqedoni dukeshin së paku në aparençën e tyre të jashtme stabile. Struktura maqedonase në qeverisje duket që i kishte lënë një hapësirë modeste manovrimi partnerit të tyre shqiptar. Kjo vërehej në një shtim të lehtë të numrit të shqiptarëve etnikë në pozita qeverisëse në organet e qeverisjes lokale, si dhe në disa agjenci të tjera shtetërore. Gjithashtu, në këtë periudhë u arrit një marrëveshje për lejimin e një kolegjii privat tregjuhësh që duhej të akomodonte kërkesat e vazhdueshme për arsim të lartë në gjuhën shqipe. Një zgjidhje e këtillë dukej se nuk plotësonte nevojat e shqiptarëve për arsim të lartë dhe në atë periudhë u pa me dyshim nga shtesa të gjera të shoqërisë shqiptare në Maqedoni.

Pikërisht në këtë kohë qeveria maqedonase dhe ajo jugosllave shpeshuan takimet e tyre në lidhje me përcaktimin final të vijës kufitare mes dy shteteve. Marrëveshja u nënshkrua në shkurt të vitit 2001 nga presidentët maqedonas dhe jugosllavë respektivisht, Trajkovski dhe Koshtunica<sup>93</sup>. Marrëveshja në parim nuk merrte parasysh realitetet e reja të krijuara në Kosovë pas ndërhyrjes së NATO nga viti 1999, si dhe statusin e pazgjidhur final politik të Kosovës. Në një mënyrë, qeveritë maqedonase dhe jugosllave përcaktuan kufirin e përbashkët mes dy vendeve edhe në pjesën që ndante territorin e Kosovës dhe Maqedonisë sipas kufijve të vjetër administrativë të periudhës jugosllave. Gjithashtu, në këtë periudhë kohore, trupat e NATO në Kosovë nënshkruan me përfaqësuesit e qeverisë serbe marrëveshjen për kthimin e policisë në të quajturën zonë të sigurisë, e cila përfshinte edhe trekëndëshin kufitar mes Republikës Federale Jugosllave, Maqedonisë dhe Kosovës, e ndodhur në atë kohë nën administrimin e misionit të OKB, UNMIK.

Nënshkrimi i këtyre dy marrëveshjeve, sidomos e para në lidhje me përcaktimin e kufirit mes Maqedonisë dhe të quajturës Republikë Federale Jugosllave edhe në pjesën e kufirit Kosovë – Maqedoni e Veriut, nuk u pranua mirë nga opinioni publik shqiptar në Maqedoni dhe Kosovë. Kjo i tensionoi marrëdhëniet politike në Maqedoni por nuk mund të thuhet që ishte shkaku kryesor i fillimit të konfliktit të armatosur të vitit 2001. Megjithëse zona në fjalë duke qenë afër trekëndëshit kufitar që më herët kishte njohur konflikte të natyrave të ndryshme ekonomike por edhe me prapavijë etnike apo politike, si kidnapimi i disa ushtarëve maqedonas në prill të vitit 2000 dhe negociatat pasuese në lidhje me rastin Hasani<sup>94</sup>, nuk mund të jetë shkaku kryesor i

---

<sup>92</sup> Macedonia; Towards Destabilisation. The Kosovo crisis takes it toll on Macedonia, ICG Report No. 67, 21 May 1999, Skopje, faqe 2

([https://www1.essex.ac.uk/armedcon/world/europe/south\\_east\\_europe/macedonia/MacedoniaTowardsDestabilisation.pdf](https://www1.essex.ac.uk/armedcon/world/europe/south_east_europe/macedonia/MacedoniaTowardsDestabilisation.pdf))

<sup>93</sup> Nehat Sadiku, Turbulenca politike, 2004, faqe 188

<sup>94</sup> The Macedonian Question: Reform or Rebellion, ICG Balkan Report No 109, 5 April 2001, faqe 2

([https://www1.essex.ac.uk/armedcon/world/europe/south\\_east\\_europe/macedonia/MacedonianRefororRbellion.pdf](https://www1.essex.ac.uk/armedcon/world/europe/south_east_europe/macedonia/MacedonianRefororRbellion.pdf))



ngjarjeve serioze të mëvonshme me të cilat u ballafaqua vendi. Gjithsesi, mund të thuhet që marrëveshja për kufirin ishte një faktor që ndikoi në përsheptimin e momentit të shpërthimit të dhunshëm të tensionit ekzistues në shoqërinë maqedonase, që buronte nga diskriminimi i gjerë dhe i gjithanshëm i komunitetit shqiptar nga institucione përgjithësisht një etnike të sistemit.

Elita politike maqedonase, nga ana tjetër, në fillim të krizës së sigurisë, i dha një rëndësi mbiproporcionale marrëveshjes maqedono–jugosllave për kufirin si shkak për prishjen e rendit dhe sigurisë në këtë zonë, duke e ndërlidhur rastin me grupe kriminale, të cilëve, gjithnjë sipas zërave të caktuar qeveritarë, u janë prerë rrugët e kontrabandës. Me zgjerimin e zonave të përfshira në konflikt, si dhe me rritjen e numrit të guerilasve të armatosur, establishmenti maqedonas filloi të deklarohej për konflikt të iniciuar apo importuar nga qarqe politike nga Kosova në bashkëpunim me rrjete trafikantësh me synime irredentiste të rrezikshme për stabilitetin rajonal<sup>95</sup>.

Edhe autorë të caktuar maqedonas flasin për përballje të forcave maqedonase të sigurisë me grupe shqiptarësh që besohet se janë infiltruar në Maqedoninë veriperëndimore nga Kosova<sup>96</sup>, apo autorë të veçantë të huaj ku vetë kriza shihet si vazhdim dhe përhapje në Maqedoni e asaj kosovare<sup>97</sup>. Një pjesë tjerë e këtyre autorëve edhe pse e pranon që përveç ndikimeve të jashtme kishte edhe faktorë të brendshëm për këtë krizë, prapëseprapë peshën kryesore të përgjegjësisë e sheh tek faktori i huaj, dhe këtu kryesisht mendohet në Kosovën apo edhe tek forca tjera të jashtme që ndihmuan UÇK në Kosovë apo edhe tek paafësia e Policisë maqedonase për të mbrojtur kufirin në mënyrë më të mirë ose për të qenë më efikasë në luftë kundër mafies me origjinë shqiptare<sup>98</sup>. Ka edhe autorë të huaj që në një mënyrë shumë më të matur flasin për krizën e vitit 2001 jo si të shkaktuar nga institucionet kosovare por si një pasojë e luftës së Kosovës, përkrahjes amerikane për UÇK në luftën e saj kundër regjimit serb dhe kalimit të një pjese të guerilasve në drejtim të Maqedonisë në jug<sup>99</sup>. Qëndrime të këtilla të autorëve maqedonas por edhe disa pak të huajve, duket të vijnë edhe si rrjedhojë e mbështetjes më të madhe në burime maqedonase të informimit.

Edhe pse vetë akti i nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje mund të merret si një kasus lokal për nisjen e veprimeve të dhunshme, shkaqet dhe arsyet kryesore të saj janë dhe duhen kërkuar në

---

<sup>95</sup> Nadege Ragaru, Macedonia: Between Ohrid and Brussels, CERI/CNRS, September, 2008, faqe 4. Versioni online në: (<https://spire.sciencespo.fr/hdl:/2441/1d1vlhp8p7t3k7k972q97ek4g/resources/macedonia-betëeen-ohrid-and-brussels-long-version.pdf>)

<sup>96</sup> Vladimir T. Ortakovski, vepra e cituar, faqe 40

<sup>97</sup> Andrew Rossos, The disintegration of Yugoslavia, Macedonia's independence and stability in the Balkans, faqe 113, në: Brad K. Blitz (Ed). War and change in the Balkans. Nationalism, Conflict and Cooperation. Cambridge University Press 2006

<sup>98</sup> Kristina Balalovska, A Historical Background to the Macedonian - Albanian Inter - Ethnic Conflict, Në Balkan Politics, NO ¾ - 2002, (<http://www.newbalkanpolitics.org.mk/item/A-Historical-Background-to-the-Macedonian-Albanian-Inter-Ethnic-Conflict#.XPOQIIgzBIU>)

<sup>99</sup> Lars Jerker Lock, Macedonia A conflict analysis, SIDA, Division for South east Europe, October, 2003, faqe 13 ([https://www.sida.se/contentassets/a4319f99cc124339800aecd53db36bfa/macedonia-a-conflict-analysis\\_936.pdf](https://www.sida.se/contentassets/a4319f99cc124339800aecd53db36bfa/macedonia-a-conflict-analysis_936.pdf))

mllefin e akumuluar nga diskriminimi i gjithanshëm, sistemor më se një dekadësh i shqiptarëve në këtë republikë të vogël ish-Jugosllave.

Diskriminimi që shihej qartë që në preambulën e kushtetutës dhe në një varg sfidash dhe mosmarrëveshjesh kardinale ndërkomunitare, si çështjet e arsimit në gjuhën shqipe, gjuhës dhe zyrtarizimit të saj, përdorimit të lirë e të papenguar të simboleve nacionale si dhe një përfshirjeje sa më të drejtë të mundshme të shqiptarëve në institucionet e sistemit në vend.

Kombinimi i këtyre faktorëve të rëndësishëm si dhe pozita e ndryshuar e faktorit shqiptar në Ballkan pas largimit të forcave pushtuese serbe nga Kosova, bënë që kontradiktat etnike deri atëherë të kontrolluara dhe evituara me çmimin e moszgjidhjes së çështjes shqiptare në Maqedoninë e Veriut, të marrin një formë të re, atë të dhunshme. Nënshkrimi i një marrëveshjeje të tillë ishte një lloj akti final apo ‘casus belli’, por jo shkak i përballjes së armatosur mes një organizate politike ushtarake shqiptare dhe forcave kryesisht monoetnike maqedonase të sigurisë. Me këtë mund të thuhet që konflikti i armatosur i vitit 2001 ka rrënjë etnike që vjen si pasojë e ankesave nga diskriminimi me natyrë etnike, u zhvillua si pasojë e faktorëve burimorë në Maqedoninë e Veriut, u zhvillua kryesisht nga aktorë lokalë maqedonas apo shqiptarë etnikë; nuk kishte ngjyrë apo konotacione religjioze si dhe nuk ishte i importuar nga jashtë. Aktorë e faktorë të jashtëm shtetërorë e joshtetërorë në varësi të interesave dhe politikave të tyre ndërhyjnë me kalimin e kohës në drejtim të zgjidhjes apo edhe thellimit të konfliktit, por nuk ishin ata faktorët që shkaktuan konfliktin e dhunshëm ndëretnik të vitit 2001.

### **2.2.1 Zhvillimi i ngjarjeve deri në nënshkrimin e MO**

Ngjarjeve serioze të vitit 2001 në fakt u kanë paraprirë disa aksione të mëhershme në vitet 1997, 1998 dhe 1999, të një organizate shqiptare të panjohur më parë për opinionin e gjerë publik. Në janar dhe shkurt të vitit 2001 ndodhën edhe dy përballje tjera të dhunshme, në Tanushë dhe në Tearcë të Tetovës. Pas ngjarjeve në Tearcë, formacioni ushtarak politik shqiptar i quajtur Ushtria Çlirimtare Kombëtare, lëshoi komunikatën e katërt për opinionin publik në të cilën paralajmëronte ata që i quante pushtuesit maqedonë dhe bashkëpunëtorët e tyre shqipfolës<sup>100</sup>. Intervenimi policor i radhës në Tanushë me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë të autoriteteve të larta shtetërore të fushës së sigurisë<sup>101</sup> dështoi të risillte nën kontroll shtetëror këtë zonë problematike në kufi me Kosovën. Banorët e fshatit qëndruan në mbrojtje të shtëpive të tyre.

Situata ishte e tensionuar dhe në prag të luftës civile. Faktori politik shqiptar ishte konfuz dhe pjesë e qeverisë qendrore në Shkup. Me këtë aksionet e forcave njëetnike maqedonase të sigurisë merrnin në sytë e faktorëve ndërkombëtarë legjitimitetin e përfaqësuesve politikë shqiptarë të zgjedhur në mënyrë demokratike në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 1998. Edhe partitë politike

<sup>100</sup> Zeqirja Rexhepi, vepra e cituar, faqe 183

<sup>101</sup> The Macedonian question; Reform or Rebellion, ICG Report No 109, 5 April 2001, faqe 6

([https://www1.essex.ac.uk/armedcon/world/europe/south\\_east\\_europe/macedonia/MacedonianRefororRbellion.pdf](https://www1.essex.ac.uk/armedcon/world/europe/south_east_europe/macedonia/MacedonianRefororRbellion.pdf))

shqiptare në Kosovë refuzuan me anë të një deklarate publike formacionin e ri ushtarak të shqiptarëve etnikë në Maqedoni<sup>102</sup>.

Institucionet ndërkombëtare me gjithë kërkesat e vazhdueshme drejtuar qeverisë maqedonase për të reformuar sistemin politik, ishin të qartë në deklaratat e tyre në dënimin e përdorimit të dhunës për arritjen e qëllimeve të caktuara të shqiptarëve në Maqedoni. Dukej në këto momente që elementët e armatosur shqiptarë u izoluan si nga faktorët e jashtëm ashtu edhe nga faktorët politikë shqiptarë. Pas zgjerimit të përplasjeve edhe në zonën perëndimore të vendit, në Tetovë, qyteti më i madh i banuar nga një shumicë shqiptare, qeveria lëshoi ultimatum për UÇK duke filluar bombardimin e pakontrolluar të zonave të banuara malore të qytetit. Bombardimi shkaktoi një numër të madh refugjatësh<sup>103</sup>, të gjithë shqiptarë etnikë që u detyruan të lëshojnë shtëpitë e tyre nga ky aksion i gjerë dhe masiv i forcave monoetnike maqedonase të sigurisë.

Veprime të dhunshme nga forcat maqedonase të sigurisë dhe përballje të armatosura me forcat e UÇK pati edhe në pjesë tjera të Republikës të banuara me shqiptarë si në pjesët periferike të kryeqytetit Shkup apo në zonën e Kumanovës në drejtim të kufirit me Kosovën dhe RF Jugosllave. Aksionet disproporcionale të Policisë dhe Ushtrisë maqedonase me bombardime masive sidomos në zonat në veri lindje të Shkupit shkaktuan viktima të shumta civile dhe dëme të mëdha në pronat e banorëve shqiptarë të këtyre zonave, duke detyruar një pjesë të madhe të largohen si refugjatë në Kosovë apo jashtë vendit<sup>104</sup>, siç raportonin edhe nga OKB<sup>105</sup>.

Rol të veçantë në shtimin e interesit ndërkombëtar për përballjet e armatosura kishte edhe beteja për Haraçinën e cila gjendej në një pozicion strategjik dhe rrezikonte të zgjeronte hartën e konfliktit në kryeqytet. E ndodhur para një mundësie të tillë qeveria Maqedonase angazhoi një numër forcash në drejtim të këtij fshati të banuar me shumicë shqiptare të popullsisë, por pa mundur të depërtojë brenda në fshat. Pas negociatave të tensionuara me ndërmjetësimin e ndërkombëtarëve, 320 luftëtarë të UÇK u largua nga fshati<sup>106</sup> për ti dhënë një shans procesit paqësor dhe gjetjes së një zgjidhje finale. Se tërheqja nuk ka ardhur si rezultat i fitores ushtarake maqedonase apo i presioneve të ndryshme politike nga faktorë të jashtëm, e tregon edhe dëshmia e një prej udhëheqësve të UÇK në atë kohë dhënë në gjykatën e Hagës<sup>107</sup>. Gjithsesi, përballjet e armatosura vazhduan edhe gjatë muajve korrik dhe gusht në zonat malore në afërsi por edhe brenda në qytetin e Tetovës, kryeqytetit jozyrtar të shqiptarëve si dhe në raste të përsëritura në

<sup>102</sup> Nehat Sadiku, vepra e cituar, faqe 197

<sup>103</sup> Macedonia: The Last Chance for Peace, ICG Balkan Report No 113, 20 June 2001, faqe 3

([https://www1.essex.ac.uk/armedcon/€orld/europe/south\\_east\\_europe/macedonia/MacedoniaTheLastChanceforPeace.pdf](https://www1.essex.ac.uk/armedcon/€orld/europe/south_east_europe/macedonia/MacedoniaTheLastChanceforPeace.pdf))

<sup>104</sup> Refugees pour into Kosovo, Special Report: Macedonia, The Guardian,

(<https://www.theguardian.com/world/2001/jun/11/balkans>)

<sup>105</sup> Thousands of ethnic Albanians flee Macedonia, UNHCR, 11 June 2001,

(<https://www.unhcr.org/news/press/2001/6/3b24d5ad9/thousands-ethnic-albanians-flee-macedonia.html>)

<sup>106</sup> Ian Fisher, Macedonian Leader, Warning of Civil War, Urges Calm, New York Times, June 27, 2001, (Marrë nga:

<https://www.nytimes.com/2001/06/27/world/macedonian-leader-warning-of-civil-war-urges-calm.html>)

<sup>107</sup> Gëzim Ostreni, Dëshmia e Gjeneralit, Tetovë, 2011, faqe 83

zonat e banuara me shqiptarë në verilindje të vendit. Në gusht ndodhi edhe një masakër e Policisë maqedonase në Çair të Shkupit, pjesë e kryeqytetit e banuar në shumicë nga shqiptarë etnikë ku 5 pjesëtarë të UÇK humbën jetën. Në një akt të tjetër një numër i pjesëtarëve të sigurisë humbi jetën në një pritë në autostradën Shkup - Tetovë. Me këtë gjendja u tensionua përsëri.

Pasuan përballje në Radushë në rajonin e Shkupit, në kufi me Kosovën si dhe në Luboten, fshat po ashtu në zonën e thellë malore të kryeqytetit të vendit. Në Luboten forcat maqedonase të sigurisë kryen një masakër të vërtetë ndaj banorëve lokalë shqiptarë duke vrarë 7 dhe torturuar mëse 100 të tjerë për të cilën raportuan me tituj të qartë edhe media të rëndësishme të huaja<sup>108</sup>. Pas përfundimit të konfliktit të armatosur, Tribunali Ndërkombëtar për krimet e luftës në Ish Jugosllavi ngriti padi<sup>109</sup>, shpalli fajtor dhe dënoi me dënime të plotfuqishme për këtë masakër më të madhe të gjithë luftës së vitit 2001, një oficer të lartë të Policisë maqedonase. Gjyqi më shumë për motive politike sesa prova materiale, liroi Ministrin e Punëve të Brendshme të Republikës së Maqedonisë i cili kishte përgjegjësi politike dhe institucionale për aksionet e vartësve të tij në Luboten dhe me gjerë gjatë gjithë periudhës së përballjeve të armatosura në vitin 2001.

Nga ana tjetër dënime për pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare e cila përbëhej nga shqiptarë etnikë, nuk pati. Kjo vërtetohet tezën e sipërthënë që aksionet e forcave maqedonase të sigurisë kanë qenë disproporcionale, të dhunshme, në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare humanitare dhe të panevojshme. Duket se këto veprime më tepër se nga domosdoshmëria ushtarake janë shtyrë nga ndjenja hakmarrëse dhe urrejtja etnike e pjesëtarëve maqedonas të MPB ndaj pjesëtarëve të bashkësisë etnike shqiptare në atë periudhë.

Pas disa armëpushimeve të kumtuara publikisht nga Presidenti i atëhershëm Trajkovski si dhe lideri i UÇK Ahmeti, brenda disa ditëve ndodhën dy ngjarje të rënda dhe me impakt në situatën e përgjithshme të sigurisë dhe politike. Fillimisht, më 10 gusht nga minat humbën jetën 8 ushtarëve maqedonas në afërsi të Shkupit, më 11 gusht siç u përmend më lartë në Luboten, forcat maqedonase të sigurisë masakruan 7 civilë shqiptarë si dhe torturuan 100 të tjerë. Pas aktivitetit dhe presionit të shtuar ndërkombëtar, më 13 Gusht 2001 në qytetin jugperëndimor të Ohrit u nënshkrua Marrëveshja që i dha fund konfliktit të armatosur të vitit 2001. Nënshkrimin nga pala shqiptare e përbërë nga liderët e dy partive shqiptare pjesë e Qeverisë maqedonase, z.Xhaferri nga PDSH dhe Ymeri nga PPD i parapriu Marrëveshja e Prizrenit mes përfaqësuesve politikë e ushtarakë shqiptarë. Në cilësi të përfaqësuesit të interesave maqedonase, Marrëveshja u nënshkrua nga Kryeministri në detyrë Z.Georgievski si dhe lideri i opozitës, socialdemokrati Cërvenkovski. Boris Trajkovski nënshkroi si President në detyrë, garantues i saj dhe nominalisht mbi palët.

<sup>108</sup> Ian Fisher, Report Says Macedonians Killed Civilians in Revenge, New York Times, Sept. 5, 2001

(<https://www.nytimes.com/2001/09/05/world/report-says-macedonians-killed-civilians-in-revenge.html>)

<sup>109</sup> United Nations, International Tribunal for the Prosecution of Persons Responsible for Serious Violations of International Humanitarian Law Committed in the Territory of the Former Yugoslavia since 1991. Case No. 04-82-T. Date. 10 July 2008. Faqe 244. ([http://www.icty.org/x/cases/boskoski\\_tarculovski/tjug/en/080710.pdf](http://www.icty.org/x/cases/boskoski_tarculovski/tjug/en/080710.pdf))

Merita kryesore në fakt i shkon faktorit ndërkombëtar që në dokumentin final përfaqësohet me nënshkrimet e ndërmjetësve, Fransoa Leotard si përfaqësues i Bashkimit Europian dhe James Pardew si i dërguar i SHBA. Meritorë ishin edhe përfaqësuesit politikë të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare të cilët hoqën dorë nga modelet territoriale të zgjidhjes së çështjeve etnike si dhe forcat e moderuara kryesisht përreth Presidentit Trajkovski, që të ndodhur nën presionin e fortë të diplomacisë ndërkombëtare kuptuan se kjo ishte mënyra e vetme për të evituar skenarë tjerë të rrezikshëm për vendin.

Pas nënshkrimit të Dokumentit final u nënshkrua një Marrëveshje për amnisti po me ndërmjetësi ndërkombëtare. Këtë radhë ndërmjetës ishte diplomati holandez, Pieter Feith. Kjo i hapi rrugë misionit të quajtur “Essential Harvest” në bazë të të cilit Organizata e Paktit të Atlantikut të Veriut dërgoi trupa në vend me ftesë të Maqedonisë për të çarmatosur dhe shkatërruar armët e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare. Misioni në përbërjen e të cilit kishte rreth 3500 ushtarë filloi punën më 27 Gusht dhe e vazhdoi për një periudhë 30 ditore<sup>110</sup>. Pas kësaj mandati vazhdoi edhe me misionin e radhës për mbrojtjen e pjesëtarëve të organizmave të ndryshëm ndërkombëtarë prezentë në Maqedoninë e veriut gjatë kësaj periudhe kohore.

Numri i viktimave civile dhe ushtarake ishte i lartë. Sipas të dhënave zyrtare të autoriteteve maqedonase, 78 pjesëtarë të forcave maqedonase të sigurisë duke përfshirë forca ushtarake dhe policore kanë humbur jetën gjatë vitit 2001. Ushtria Çlirimtare Kombëtare nga ana tjetër ka listën me afër 90 heronj që dhanë jetën për një të ardhme më të mirë për shqiptarët në Maqedoninë e veriut.

Duhet thënë se përgjatë gjithë kohës së konfliktit të armatosur, situatës së tensionuar dhe marrëdhënies të përkeqësuar ndëretnike si dhe krizës së gjithmbarshme shoqërore të vitit 2001, në pjesën më të madhe të territorit të Republikës, Forcat monoetnike të sigurisë kanë ushtruar dhunë të drejtpërdrejtë si dhe presion psikologjik në shkallë të gjerë ndaj shtetasve me përkatësi etnike shqiptare. Numri i refugjatëve shqiptarë të larguar në drejtim të Kosovës, Shqipërisë apo vendeve perëndimore është shumëfishi i numrit të maqedonasve etnikë të larguar nga shtëpitë e tyre kryesisht në Shkup apo persona tjerë të zhvendosur brenda territorit të Republikës.

Një ngjarje e shëmtuar e situatës eksplozive të asaj kohe është edhe pastrimi etnik i qytetit të Manastirit nga gjithë popullsia shqiptare e tij nga shovinistë maqedonas me tolerancën dhe inaktivitetin e forcave maqedonase të sigurisë në qytet<sup>111</sup>. Nga ana tjetër ka pasur raste të izoluara të dhunës fizike, shkatërrimit të pronës e monumenteve të caktuara nga persona të

---

<sup>110</sup> NATO's role in the FYR of Macedonia. Operation Essential Harvest. 27 August – 26 September 2001.

(<https://www.nato.int/fyrom/tfh/home.htm>)

<sup>111</sup> Macedonia: Rioters Burn Albanian Homes in Bitola, HRW, June 7, 2001

(<https://www.hrw.org/news/2001/06/07/macedonia-rioters-burn-albanian-homes-bitola>)

uniformuar të supozuar se i takojnë UÇK<sup>112</sup> apo edhe largime të banorëve maqedonas nga shtëpitë e tyre si ato nga fshatrat e Komunës Tetovë në drejtim të kufirit me Kosovën, por në përmasa shumëfish më të vogla se ato të pësura nga popullsia civile shqiptare e Maqedonisë. Menjëherë UÇK ka reaguar ndaj këtyre veprimeve duke shprehur publikisht indinjatën ndaj akteve të qarqeve të caktuara kriminale. Nga ana tjetër, numri më i madh i 170. 000 mijë refugjatëve të luftës së vitit 2001 ishte me përkatësi etnike shqiptare. Shumica dërmuese e banorëve të larguar nga vendbanimet e tyre nën rrezikun imediat të luftës ishin po ashtu shqiptarë. Shembuj të shumtë të largimit masiv të civilëve shqiptarë të përballur drejtpërsëdrejti me veprime luftarake e me këtë edhe në rrezik për jetët e tyre si ato në fshatrat Sellcë, Poroj e Xhermë të Komunës së Tetovës, rajonit Lipkovë apo edhe në rajonin e Kumanovës si Mateç, Sllupçan etj dhe të pasqyruar gjerësisht edhe nga autorë dhe organizata të huaja<sup>113</sup>, gjenden rrallë ose aspak tek bashkëqytetarët e tyre maqedonas siç është rasti me fshatin Zilçe apo Haraçinë në periferi të Shkupit.

Një temë shumë e ndjeshme janë edhe personat e humbur të dyja përkatësive etnike, maqedonas dhe shqiptarë për fatin e të cilëve nuk ka informata, por besohet të jenë likuiduar nga palët në konflikt. Sipas Organizatës ndërkombëtare për Persona të Zhdukur, në Maqedoninë e veriut janë 22 vetë nga periudha e vitit 2001 që konsiderohen të kësaj kategorie<sup>114</sup>, <sup>115</sup>.

### **2.3 Marrëveshja Kornizë e Ohrit si një zgjidhje gjysmake për të dyja palët**

Si kompromis për ndaljen e veprimeve të dhunshme që rrezikonin të destabilizonin mbarë rajonin dhe nën një presion të shtuar ndërkombëtar, palët e përfshira në konflikt u detyruan të ndalin ato dhe të përfshihen në negociata të drejtpërdrejta për ti dhënë fund gjendjes së konfliktit ushtarak. Negociatat që rezultuan me nënshkrimin e Marrëveshjes së Ohrit ishin të vështira dhe të mundimshme. Palët nuk ishin të kënaqura me arritjet e tyre<sup>116</sup> pas një periudhe mëse njëvjeçare të përballjeve të armatosura. Nacionalistët maqedonas kërkonin nga qeveria vazhdimin e konfliktit dhe një zgjidhje ushtarake për problemin e quajtur sipas tyre ‘terrorist’

---

<sup>112</sup> Conflict Studies Research Center. The 2001 Conflict in FYROM – Reflections. Institute of War and Peace Reporting. June 2004. Faqe 11. ([https://www.files.ethz.ch/isn/44460/2001\\_Confl\\_FYROM.pdf](https://www.files.ethz.ch/isn/44460/2001_Confl_FYROM.pdf))

<sup>113</sup> Global IDP, Profile of Internal Displacement: Macedonia, 2004, Faqe 24 (Versioni PDF në: <https://reliefweb.int/sites/reliefweb.int/files/resources/9B3512EA0E9DBC4885256E460058AECB-nrc-mkd-26feb.pdf>)

<sup>114</sup> ICMP. Missing Persons issue in FYROM/Macedonia. (<https://www.icmp.int/press-releases/missing-persons-issues-in-macedonia/>)

<sup>115</sup> ICMP, International Commission on Missing Persons. Statement by the International Commission on Missing Persons. Sarajevo, 11<sup>th</sup> April, 2008. Faqe 2. ([https://tbinternet.ohchr.org/Treaties/CAT/Shared%20Documents/MKD/INT\\_CAT\\_NGO\\_MKD\\_40\\_9662\\_E.pdf](https://tbinternet.ohchr.org/Treaties/CAT/Shared%20Documents/MKD/INT_CAT_NGO_MKD_40_9662_E.pdf))

<sup>116</sup> Conflict Studies Research Center. The 2001 Conflict in FYROM: Reflections. Institute of War and Peace Reporting. Balkans Series. 04/15. June 2004. Faqe 29. ([https://www.files.ethz.ch/isn/44460/2001\\_Confl\\_FYROM.pdf](https://www.files.ethz.ch/isn/44460/2001_Confl_FYROM.pdf))

dhe të importuar nga Kosova. Mediat në gjuhën maqedonase në këtë kohë janë të mbushura me artikuj që kërkonin zgjidhje ushtarake për problemin e UÇK dhe nacionalizmit shqiptar në vend.

Nuk ishin të pakta rastet kur konfliktit i jepej konotacion religjioz duke quajtur shqiptarët talibanë të Ballkanit<sup>117</sup> për të përfituar simpatitë e botës perëndimore. Në periudhën imediate pas nënshkrimit të Marrëveshjes madje pati edhe akte të mirëfillta terroriste nga struktura të caktuara të MPB për të sjellë shqiptarët në lidhje me qarqet terroriste të lindjes së mesme. Kështu në një aksion të MPB u tha që u eliminuan muxhahedinë të ardhur në Maqedoni për të ndihmuar UÇK. Gjithsesi në fund doli që Policia në një akt të mirëfilltë çnjerëzor dhe terrorist, kish ekzekutuar refugjatë klandestinë pakistanezë dhe indianë<sup>118</sup> të cilët tentoi ti paraqiste si radikalë islamistë të ardhur nga larg.

Këto dhe raste tjera tensionuan në vijimësi situatën e sigurisë. Nga ana e UÇK pati probleme të natyrës tjetër. Në skenë doli një Armatë e re Kombëtare e cila thuhej që nuk pranon Marrëveshjen e Ohrit dhe përbëhej nga ushtarë të pakënaqur me zgjidhjet e ofruara në këtë Marrëveshje. Gjithashtu në zonat e banuara me shumicë shqiptare situata e sigurisë nuk ishte në nivele të duhura pasi popullsia vuante gjendjen e kaosit të pas konfliktit.

Në fund, edhe pse të pakënaqura palët u dakorduan. Maqedonasit pranuan Marrëveshjen duke ruajtur karakterin unitar të shtetit kurse shqiptarët hoqën dorë nga zgjidhjet territoriale të konfliktit ushtarak duke shpresuar në përmirësimin e statusit të tyre politik pas ndryshimeve kushtetuese të dakorduara në Ohër.

Faktori ndërkombëtar nga ana tjetër nënshkrimin e Marrëveshjes e pa si sukses të diplomacisë dhe sidomos të strukturave të sapongritura për politikë të jashtme të Bashkimit Europian.

## **2.4 Perceptimi shqiptar për Marrëveshjen e Ohrit**

Në vazhdim do të shohim si është parë Marrëveshja e Ohrit në momentin e firmosjes dhe fill pas nënshkrimit nga opinionet respektive publike, maqedonase dhe shqiptare në Maqedoninë e Veriut.

Në momentin e nënshkrimit të Marrëveshjes situata ushtarake në teren ishte e paqartë. Duket se forcat maqedonase të sigurisë të ndihmuara, trajnuara dhe në masë edhe armatosura nga shtete fqinje si dhe aktorë më të largët<sup>119</sup> nuk ishin në gjendje ti jepnin zgjidhje ushtarake çështjes. UÇK dukej komode në mbrojtjen e territoreve të çliruara si dhe kohë pas kohe godiste me sukses

---

<sup>117</sup> SEENPM/BHRN. Instituti Maqedonas per Media. Maqedonia: Konflikti dhe Mediat. Shkup, 2003. Faqe 104

<sup>118</sup> Nicholas Wood. A Fake Macedonia Terror Tale that Led to Deaths. New York Times. May 17, 2004.

(<https://www.nytimes.com/2004/05/17/world/a-fake-macedonia-terror-tale-that-led-to-deaths.html>)

<sup>119</sup> Stephan Israel. Mazedonien: Rusten - so gut es geht. Mazedoniens Armee macht mobil – die rebellen sind beweglicher. Der Tagesspiegel. 27/06/2001. (<https://www.tagesspiegel.de/kultur/mazedonien-ruesten-so-gut-es-geht-mazedoniens-armee-macht-mobil-die-rebellen-sind-beweglicher/237164.html>)

aparatin policor ushtarak maqedonas. Prandaj edhe nënshkrimin palët e panë nga këndvështrime të ndryshme dhe mbetën përgjithësisht të pakënaqura.

Opinionit i gjerë publik shqiptar priste më shumë sesa qëndronte në dokumentet zyrtare. Statusi kushtetues juridik i komunitetit të dytë më të madh mbeti edhe më tutje i papërcaktuar. Edhe pse në numër të konsiderueshëm të popullsisë, shqiptarët nuk fituan statusin e elementit të dytë konstituiv në shtet<sup>120</sup>. Shteti nuk u ridefinua në Kushtetutë si i popullit Maqedonas dhe popullit Shqiptar por mbeti edhe tutje ekskluziviteti i popullit Maqedonas që i vetëm mbante sovranitetin e tij. Për të qenë fyerja më e rëndë, shqiptarët u degraduan në njëfarë mënyre në një grup popullsie të drejtat politike të cilëve vareshin nga famozja 20 % e numrit të përgjithshëm të banorëve së vendit.

Një opsion tjetër mjaft i diskutuar në opinionin publik shqiptar që në vitet 90 ishte edhe mundësia për të federalizuar territorialisht Republikën.<sup>121</sup> Edhe kjo nuk parashihej me Marrëveshjen e Ohrit. Gjithsesi, në zgjedhjet e mëvonshme, partia shqiptare që mbronte dhe identifikohesh me një zgjidhje të tillë federaliste të çështjes shqiptare në Maqedoni kishte vetëm një deputet në Parlamentin Republikan. Partia Demokratike Kombëtare ishte në fakt partia e vetme politike shqiptare e cila duket të ketë injoruar në një kuptim që në fillim këtë Marrëveshje<sup>122</sup>, duke favorizuar zgjidhje më të drejta nacionale për shqiptarët.

Partitë politike shqiptare në atë kohë të gjendura nën presion të fortë ndërkombëtar, në interes të ndalimit të veprimeve luftarake si dhe për të dhënë shans paqes, e pranuan Marrëveshjen. PDSH, Partia Demokratike Shqiptare si parti qeverisëse në atë kohë ishte e qëndrimit që shqiptarët me këtë Marrëveshje kanë fituar minimumin e të drejtave kolektive<sup>123</sup>.

## 2.5 Perceptimi maqedonas për Marrëveshjen e Ohrit

Një pjesë e konsiderueshme e politikbërjes, Qeverisë, opozitës si dhe opinionit publik maqedonas ka parë tek Marrëveshja e Ohrit një disfatë të shtetit para sipas tyre, "dhunës së ekstremistëve shqiptarë". Në një pjesë të medias në gjuhën maqedonase pati edhe krahasime të MO me Marrëveshjen e Bukureshtit të vitit 1913 që ndau Maqedoninë gjeografike mes aleatëve ballkanikë<sup>124</sup>.

---

<sup>120</sup> Christina Eva Griessler. European Centre for Minority Issues. The Albanians in Macedonia: The Role of International Organizations in Empowering the ethnic Albanian Minority. Faqe 7. ([https://www.files.ethz.ch/isn/185198/ECMI\\_WP\\_79\\_Final.pdf](https://www.files.ethz.ch/isn/185198/ECMI_WP_79_Final.pdf))

<sup>121</sup> ARENA. Rikthet Federalizimi. Nr.6/ 28 Dhjetor/ 2009. Faqet 8, 9,10

<sup>122</sup> Etem Aziri. Partitë Politike, Zgjedhjet dhe Sistemet Zgjedhore. Tetovë, 2015. Faqe 153/154

<sup>123</sup> Menduh Thaci. Politika e Mbijetesës. Tetovë. 2009. Faqe 105.

<sup>124</sup> Ulf Brunnbauer. The Implementation of the Ohrid Agreement: Ethnic Macedonian Resentments. JEMIE. Journal on Ethnopolitics and Minority Issues in Europe. Issue 1/2002. Faqe 8. (<https://www.ecmi.de/fileadmin/downloads/publications/JEMIE/2002/nr1/Focus1-2002Brunnbauer.pdf>)



Në anketimet e atëhershme që organizata dhe media të huaja realizonin me komunitete të ndryshme etnike në Maqedoni, një pjesë e konsiderueshme e maqedonasve etnikë nuk kishin mendim pozitiv për Marrëveshjen për dallim nga qytetarët shqiptarë. Kryeministri Georgievski madje akuzonte mediatorët ndërkombëtarë për interferenca në punët e brendshme të Republikës shkakut i zgjidhjeve linguistike të ofruara në Marrëveshje<sup>125</sup>.

Qëndrimet e faktorit politik maqedonas kanë nuancë dallimesh të lehta por përmbajtësore. Opozita maqedonase e asaj kohe ka qenë përgjithësisht pro Marrëveshjes. Presidenti i Republikës, Trajkovski së paku publikisht ka insistuar në zgjidhje paqësore të konfliktit dhe këtu duket se ka gjetur mospajtimin e ministrave tjerë dhe Kryeministrit në detyrë. Edhe në qëndrimet tjera publike si ato në Parlamentin republikan, Kryeministri i vendit nga radhët e VMRO DPMNE, zoti Georgievski është deklaruar se kërkon falje që ka kandiduar një President si Trajkovski që deri në fund kërkoi zgjidhje paqësore të konfliktit<sup>126</sup>.

Parë në përgjithësi, si elita politike ashtu edhe popullsia maqedonase panë tek Marrëveshja e Ohrit një ndërhyrje të brendshme të ndihmuar nga jashtë me të cilën u rrezikua karakteri unitar i shtetit dhe identiteti nacional maqedonas. Frikërat maqedonase nga MO janë kuptuar dhe paraqitur edhe nga studiues dhe organizma të ndryshëm të huaj si një “kapitullim para interesave shqiptare nën presionin e madh të jashtëm<sup>127</sup>. Elita politike nga ana tjetër e bëri këtë kompromis sipas tyre të dhimbshëm duke shpresuar në ndihmën e SHBA dhe BE për realizimin e objektivave të tyre strategjike për integrim sa më të shpejtë të vendit në BE dhe NATO<sup>128</sup>.

## 2.6 Etniciteti si elementi kyç në kontekstin politik të RMV

Rregullimi i raporteve shoqërore në Maqedoni historikisht është bërë duke u nisur nga interesa e faktorë identitarë, kryesisht religjiozë apo etnikë linguistikë. Që në periudhën e sundimit otoman, masat ballkanike janë ndarë në mileti i krishterë apo ai rum dhe mileti turk apo mysliman. Në bazë të këtyre ndarjeve kryesore identitare janë përcaktuar dhe detyrimet dhe kanë dalë të drejtat e bashkësive përkatëse deri edhe tek dukuri të tilla si zgjedhja, lejimi apo ndalimi i profesioneve të caktuara ekonomike.

Luftërat ballkanike dhe largimi i perandorisë otomane, çlirimi i popujve ballkanikë dhe themelimi i shteteve kombe nuk ndryshoi shumë nga kjo traditë e pararendosur historike. Modeli i ndërlikohjes së raporteve politike me përkatësitë apo identitetet grupore vazhdoi dhe biles u

---

<sup>125</sup> Thede Kahl, Izer Maksuti, Albert Ramaj (Hg). Die Albaner in der Republik Mazedonien. Ost und Sudost Europa Institut. Wien. 2006. Faqe 112

<sup>126</sup> Aleksandar Comovski. 2001. Trajkovski za mirovno, Georgievski za voeno resene na konfliktot. Intervistë me Profesor Vlado Popovski për Deutsche Welle. 12.08.2011. (<https://www.dw.com/mk/2001/a-15312540>)

<sup>127</sup> ESI. European Stability Initiative. The Other Macedonian Conflict. ESI Discussion Paper. 20 February 2002. Faqe 11 ([https://www.esiweb.org/pdf/esi\\_document\\_id\\_32.pdf](https://www.esiweb.org/pdf/esi_document_id_32.pdf))

<sup>128</sup> Christina Eva Griessler. ECMI. Vepra e cituar. Faqe 6

përforcua edhe më shumë. Kjo edhe si rezultat i forcimit të shtetit komb dhe mekanizmave shtrëngues/koerciv dhe homogjenizues të tij si gjuha standarde, sistemi unik edukativ arsimor, media publike dhe faktorë tjerë unifikues. Kjo funksionoi në shoqëritë relativisht më homogjene etnike ku përqindjet e “tjerëve” apo të ndryshmëve nga kultura shumicë ishin të vogla dhe të papërfillshme.

Probleme të shumta të funksionimit shoqëror paraqitën në shtete shumetnike ku përkatësia e ‘gabuar’ etnokulturore nënkuptonte mbyllje të rrugëve dhe mundësive për zhvillim ekonomik, social, kulturor të komuniteteve që rastësisht ndodheshin në shtetin komb të një grupi tjetër etnik. Ky ishte rasti me shqiptarët por edhe me maqedonasit në periudhën mes dy luftërave botërore dhe me shqiptarët kryesisht pas formimit të Republikës socialiste të Maqedonisë. Këtë Republikë të re jugosllave, popullsia etnike maqedonase e ndjente dhe shihte si shtetin komb të tij, duke përjashtuar nga vendimmarrja politike në një kuptim grupin e dytë më të madh etnik, atë shqiptar.

Statusi kushtetues u degradua menjëherë në atë të një pakice kombëtare e cila dukej sikur rastësisht ndodhej në këto territore. Akumulimi historik i padrejtësive kolektive ndaj shqiptarëve si dhe prolongimi dhe moszgjidhja e tyre as pas pavarësimit të Maqedonisë dhe instalimit të sistemit demokratik shumëpartiak, çoi në shpërthimin e vitit 2001.

Marrëveshja historike e Ohrit jo vetëm që parandaloi një luftë të vërtetë civile, një Liban të dytë siç e quajti vetë Presidenti Trajkovski por vërtetoi tezën për natyrën ekskluzivisht etnike të sistemit politik maqedonas. Edhe përgjigjet në të gjitha çështjet e hapura në këtë Marrëveshje kanë prapavijë etnike. MO gjithsesi nuk duhet parë si një garanci për zgjidhjen e të gjitha kontesteve politike dhe etnike në vend apo për të ardhmen e demokracisë në Maqedoni<sup>129</sup>.

Në vazhdim do paraqesim në pika të shkurtra përmbajtjen e kësaj Marrëveshje si dhe impaktin që ajo ka në natyrën e sistemit politik dhe marrëdhëniet ndëretnike mes dy grupeve më të mëdha etnike, maqedonasve dhe shqiptarëve.

Fillimisht në të paraqiten parimet themelore në bazë të të cilave hidhet poshtë kategorikisht dhuna si mjet për arritjen e objektivave politikë<sup>130</sup>.

Në një lëshim të drejtpërdrejtë ndaj interesave të palës maqedonase, dokumenti i Ohrit ruan karakterin unitar të shtetit duke mos ofruar apo lejuar zgjidhje territoriale për çështjet etnike. Po ashtu kërkon ruajtjen e asaj që e quan si karakter multietnik i shtetit, kushtetutë moderne demokratike si dhe vlerëson vetëqeverisjen lokale.

---

<sup>129</sup> Kamelia R. Dimitrova. Municipal Decisions on the Border of Collapse: Macedonian Decentralization and the Challenges of Post – Ohrid Democracy. Në: South East European Politics. Volum V, No 2 -3. Pp. 172 – 186. December 2004. Faqe 173. (<http://www.seep.ceu.hu/archives/issue52/dimitrova.pdf>).

<sup>130</sup> Framework Agreement. OSCE. Skopje. 2001 (<https://www.osce.org/skopje/100622?download=true>)

Parimi i dytë kërkon ndërprerjen e pakusht të veprimeve luftarake, çarmatosjen e grupeve siç i emërton ‘të armatosura’ në mënyrë që ti hapet rruga misionit të NATO-s në vend. Parimi vijues kërkon ndërtimin e një qeverisje të decentralizuar ku përfshin edhe rregullimet e reja territoriale të sistemit të vetëqeverisjes lokale si dhe regjistrimin e popullsisë.

Parimi i katërt ka të bëjë me përfaqësimin e drejtë dhe adekuat të bashkësive në administratën publike dhe në shtet përgjithësisht.

Parimi i pestë flet për procedura të posaçme parlamentare ku bien në sy ligjet që kërkojnë votim të dyfishtë në rastet kur kemi të bëjmë me kulturën apo interesa tjera të komuniteteve jo shumicë.

Parimi i gjashtë ka të bëjë me arsimin në gjuhët amtare si dhe përdorimin zyrtar të gjuhëve në vend. Parimi i parafundit ka të bëjë me përdorimin e simboleve kombëtare me anë të të cilave shprehet identiteti kombëtar i komuniteteve /bashkësive etnike. Kjo pjesë mbyllet me modalitetet e implementimit të vetë Marrëveshjes.

Shtesa apo Aneksi A ka të bëjë me ndryshimet kushtetuese, Aneksi B me ndryshimet ligjore ku parashihen ndryshime dhe plotësime të një numri ligjesh me rëndësi për marrëdhëniet ndëretnike kurse Aneksi C me implementimin e Marrëveshjes dhe ndërtimin e masave të mirëbesimit.

MO pati sukses në fazën fillestare në objektivin më të rëndësishëm për të cilin ishte e interesuar kryesisht bashkësia ndërkombëtare, ndaljen e luftimeve dhe parandalimin e një lufte në shkallë të gjerë mes komuniteteve të ndryshme etnike në një vend europian në shekullin XXI. Në 18 vitet e kaluara nga miratimi, ky dokument akoma nuk është realizuar në tërësinë e tij. Për më shumë, duket sikur në momente, paraqitet edhe si pengesë për zgjerimin e lirive politike të shqiptarëve këtu në pajtim me vullnetin e shprehur politik, forcën e tyre numerike dhe shtrirjen territoriale.

Gjithsesi autorë të ndryshëm i shohin nga këndvështrime të ndryshme natyrën, ndikimin dhe efektet e saj në shoqërinë maqedonase. Kjo ka të bëjë me natyrën e sistemit të ndarjes së pushteteve ku duket të jetë përdorur një formë e dobët e modelit konsociacional të ndarjes së pushtetit<sup>131</sup>.

Komuniteti maqedonas nga ana tjetër e ka parë në vazhdimësi Marrëveshjen si diçka të imponuar e cila ofron pushtet joproporcional për komunitetin shqiptar si dhe etnizon natyrën e çështjeve politike në vend. Por etnizimi i sistemit politik është një proces i nisur që më herët nga vetë klasa politike maqedonase. Një formë apo model i këtillë i rregullimit të raporteve shoqërore dhe jetës sociale në përgjithësi në shoqërinë maqedonase është trashëgimi nga e kaluara. Ky model solli natyrshëm reagimin e faktorit shqiptar me rezultat zgjidhje etnike për çështjet e hapura në bazë të Marrëveshjes së Ohrit.

---

<sup>131</sup> Friedrich Ebert Stiftung. Power sharing and the Implementation of the Ohrid Framework Agreement. Office – Macedonia. Skopje 2008. Faqe 8, (<http://library.fes.de/pdf-files/bueros/skopje/06357.pdf>)

Ky model i trashëguar nga e kaluara jo e mire është i lidhur edhe me lojalitetet dhe dislojalitetet e komuniteteve të ndryshme ndaj shtetit. Komuniteti shqiptar në masë të madhe i përjashtuar nga jeta shoqërore nuk mund të ishte lojal ndaj shtetit maqedonas, një shtet që e kishte përjashtuar gati tërësisht nga jeta sociale, politike. Lojaliteti është në proporcion të drejtë me mosdiskriminimin etnopolitik dhe integrimin e suksesshëm në rrjedhat shoqërore. Shqiptarët si dhe çdo grup tjetër në fakt do ishin lojalë në atë masë sa do ishin të respektuar, të integruar dhe të barabartë me bashkëqytetarët e tyre maqedonas.

Implementimi i plotë i kësaj Marrëveshje që nuk u arit as pas 18 viteve nga pranimi i saj si dhe diskriminimi latent edhe pse në një formë më të butë por akoma ekzistent i shqiptarëve, janë arsye të gjendjes së tensionimit permanent të marrëdhënieve ndëretnike dhe i nivelit jo të kënaqshëm të tyre në këtë Republikë ish Jugosllave.

Nga ana tjetër, etniciteti mbetet akoma sot element i rëndësishëm në vendimmarrjen politike në Maqedoninë e veriut. Dhe këtu qeveritë e dominuar nga maqedonas etnikë me pak dallime prej nuancave ideologjike, shfaqin prirjen që të anashkalojnë territoret e banuara nga shqiptarë etnikë.

Për nivelin krejtësisht të pabarabartë të investimeve publike mes rajoneve të ndryshme të kushtëzuara nga përkatësia etnike e banorëve të atjeshëm, flasin të dhënat në vijim. Tabela pasqyron shumat e subvencioneve të Qeverisë qendrore dedikuar rajoneve në sferën e Kulturës për vitin buxhetor, 2012. Këto të dhëna janë reprezentative dhe të ngjashme edhe për sferat tjera të jetës shoqërore që financohen nga buxheti i përbashkët i Shtetit.

**Tabela 2** Shuma e subvencioneve qeveritare për kulturë dedikuar rajoneve statistikore për vitin 2012<sup>132</sup>

<b>Rajoni</b>	<b>Sipërfaqja (km2)</b>	<b>Popullsia</b>	<b>Shumat e transferuara /shpenzuara</b>
Pollogu	2.467	305.000	4.000.000 (rreth 0.06 mil. Eu)
Pellagonia	2.656	304.000	112.150.000 (mbi 1.8 mil. Eu)
Shkupi (pa Aerodromin dhe Butelin)	1.543	573.000	612.000.000 (rreth 10 mil. Eu)

<sup>132</sup> Abdylmenaf Bexheti. Në dekadën e dytë. Trende dhe variacione të mendimit ekonomik shkencor. Faqe 409

## Kapitulli

# III

## Marrëdhëniet mes dy komuniteteve kryesore pas vitit 2001

---

3.1 Konfliktualiteti dhe tensionimi permanent

3.2 Implementimi i MO

3.2.1 Ndarja e re territoriale

3.2.2 Ligji për gjuhët

3.2.3 Çështja me simbolet shtetërore dhe kombëtare

3.2.4 Arsimi i lartë në gjuhën shqipe. Zyrtarizimi i UT

3.2.5 Përfaqësimi i drejtë dhe adekuat në bazë të MO

- 3.3 Mosbesimi i ndërsjellë mes shqiptarëve dhe maqedonasve
- 3.4 Faktori ndërkombëtar si deterent mes palëve në konflikt të vazhdueshëm politik
- 3.5 Prospekte për të ardhmen e marrëdhënieve ndëretnike në RMV

### **3.1 Konfliktualiteti dhe tensionimi permanent**

Marrëdhëniet jo të mira ndëretnike në Maqedoni, dhe kur themi kështu i kemi parasysh ato mes maqedonasve etnikë dhe shqiptarëve etnikë, janë një konstantë e shoqërisë maqedonase që nga pavarësimi i saj nga federata Jugosllave në vitin 1991. Në këtë pjesë do të shtjellojmë disa momente kulmore të rrezikimit të paqes sociale në periudhën e pas konfliktit të armatosur të vitit 2001 dhe pas nënshkrimit të armëpushimit, ndërprerjes së veprimeve luftarake dhe nënshkrimit të marrëveshjes paqësore që i dha njëfarë zgjidhje problemit.

Ligji për Amnisti i miratuar më 18 Shkurt 2002<sup>133</sup>, i qetësoi deri diku dhe sipërfaqësisht marrëdhëniet ndërkomunitare dhe shënoi nismën për kthimin e besimit ndëretnik. Gjithsesi, nuk kaloi shumë kohë dhe forcat ekstremiste dhe hegjemoniste u rikthyen në skenë.

Në vitin 2002, në një skenar të përgatitur mirë, Policia maqedonase ekzekutoi një numër migrantësh ilegalë nga Azia duke i paraqitur në opinion si ekstremistë islamikë të ardhur në Maqedoni për të ndihmuar UÇK. Ky akt i rëndë terrorist u organizua nga Ministria e Punëve të Brendshme e cila në atë kohe kontrollohej tërësisht nga partia maqedonase në pushtet, VMRO. Këto aventura të përgjakshme që përkeqësonin marrëdhëniet ndëretnike dhe tensiononin situatën e përgjithshme në vend, bëheshin për të dhënë prova në luftën antiterror të shpallur nga perëndimi pas sulmeve të 11 shtatorit në SHBA. Realisht, një pjesë e rëndësishme e establishmentit etnik maqedonas përpigjej të përfshijë një pjesë të shtetasve të vendit në sulme të

---

<sup>133</sup> Mahi Nesimi. Shqiptarët e Maqedonisë dhe ardhmëria e Shtetit. Tetovë. 2019. Faqe 176

imagjinuara terroriste. Për pasojë, perëndimi do hiqte dorë nga mbrojtja dhe ndihma që u jepte sipas tyre shqiptarëve.

Miratimi i ndryshimeve kushtetuese me bazë MO u bë në Kuvendin republikan gjatë seancave në vitet 2001 /2002. Ishin këto ndryshime që u shoqëruan me debate të ashpra si në vetë Parlamentin republikan ashtu edhe në opinionin publik. Debatet me tone të rënda të urrejtjes etnike kontribuuan në atë që e kemi quajtur tensionim permanent të marrëdhënieve mes dy grupeve etnike. Ngjashëm mund të thuhet edhe për referendumin e dështuar të iniciuar nga qarqe hegjemoniste maqedonase të mbledhura rreth opozitës së atëhershme në lidhje me ndarjen e re territoriale në vitin 2004.

Në vitin 2006 pati edhe një shkelje të parimit të ndarjes së pushtetit në frymën e MO. Partia VMRO ftoi në bashkëqeverisje strukturën e dytë shqiptare për nga numri i deputetëve duke vështirësuar procedurat për votimin e dyfishtë<sup>134</sup> si dhe duke injoruar në një mënyrë votën etnike shqiptare në vend. Edhe kjo krizë me modelin konsociacional të ndarjes së pushtetit mes grupeve etnike shkaktoi momente të reja përballjesh politike dhe mosbesimi ndëretnik.

Kjo e përkeqësoi gjendjen e sigurisë me kulminacionin e arritur në ngjarjet në Brodec ku pas ndërhyrjes krejtësisht jonormale dhe të dhunshme të policisë humbën jetën 6 persona. Çarmatosja dhe identifikimi i grupeve të armatosura dhe me qëndrim ilegal në vend është e drejtë e organeve shtetërore, por ushtrimi disproporcional i dhunës, rrahja dhe shkatërrimi i pronës së banorëve lokalë apo burgosja dhe dënimi i një numri prej tyre s'është gjë tjetër veç veprim i shtyrë nga urrejtja etnike.

Për më tepër që një ngjarje e tillë e rëndë ndodhi në një moment crucial për rajonin kur intensifikohehin përpjekjet e Bashkësisë ndërkombëtare për gjetjen e një zgjidhje për statusin e Kosovës, si dhe Samitit të NATO të Bukureshtit që kishte si objektiv ftesën për anëtarësim në NATO të Kroacisë, Maqedonisë dhe Shqipërisë<sup>135</sup>.

Referendumi i dështuar iniciuar nga VMRO DPMNE nëpërmjet Kongresit Botëror Maqedonas, për organizimin territorial dhe Ligji për ndarjen e re territoriale të Komunave më 2004, solli një moment tjetër të rëndë për marrëdhëniet ndëretnike. Diskursi publik dominohej nga elementë ekstremistë të cilët kërkonin të parandalonin realizimin ligjor dhe praktik të një prej elementëve të dakordësuar nga palët në MO, siç ishte organizimi i ri territorial.

Enciklopedia e botuar nga një institucion serioz, faktikisht institucioni më i lartë shkencor në vend, Akademia e Shkencave dhe Arteve në vitin 2009, solli në skenë një nivel të pabesueshëm falsifikimesh dhe fyerjesh ndaj komunitetit të dytë numerikisht, shqiptarëve autoktonë. Ndër qëndrimet krejtësisht jonormale dhe të papranueshme në to mund të veçohen emërtimi si

<sup>134</sup> Friedrich Ebert Stiftung. Vepra e cituar. Skopje 2008. Faqe 25 ( <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/skopje/06357.pdf>)

<sup>135</sup> BBC Macedonian. Sestmina zagainati vo Akcijata na MVR. 07. Noemvri 2009. ([http://www.bbc.co.uk/macedonian/news/story/2007/11/printable/071107\\_mac\\_mvr\\_brodec.shtml](http://www.bbc.co.uk/macedonian/news/story/2007/11/printable/071107_mac_mvr_brodec.shtml))

kriminel i mundshëm luftë<sup>136</sup> i liderit të UÇK gjatë luftës së vitit 2001 dhe udhëheqës i Partisë më të madhe të shqiptarëve etnikë pas luftës, zotit Ahmeti, tjetërsimin e qëllimshëm të identitetit kombëtar të nobelistes shqiptare, Nënë Terezës<sup>137</sup> apo fyerje mjaft të ulëta me fjalor të papranueshëm për komunitetin shqiptar. Kjo shkaktoi një valë reagimesh të intelektualëve, qytetarëve dhe shoqërisë civile shqiptare<sup>138</sup> në vend duke polarizuar shoqërinë edhe ashtu të brishtë në kampe etnike përballë njëri tjetrit.

Në fakt gabimet ishin të rënda dhe gjuha e përdorur krejtësisht jonormale saqë Akademia e tërhoqi vetë përkohësisht nga qarkullimi për ta përmirësuar këtë vepër antishkencore<sup>139</sup>.

Situata e sigurisë me impakt në marrëdhëniet ndëretnike ka mbetur në këtë periudhë kohore e tensionuar me debate permanente në opinionin publik dhe me qëndrime diametralisht të kundërta në lidhje me MO. Nga shqiptarët kryesisht kanë prevaluar ankesa për moszbatimin dhe kërkesa për përshpejtimin e realizimit të saj, kurse nga pjesa më e madhe e opinionit publik maqedonas këto kërkesa janë parë me mosbesim dhe si vërtetim i perceptimit të tyre për shqiptarizimin e sferës publike e me këtë edhe të shtetit.

Nga ngjarjet tragjike dhe serioze përgjatë viteve mund të përmenden vrasja e pesë të rinjve maqedonas në afërsi të Shkupit për të cilën Gjykata ka dhënë dënime për një pjesë të të akuzuarve<sup>140</sup>, gjuajtja nga persona të panjohur e ndërtesës së Qeverisë në Shkup më 2014 si dhe incidenti në zonën kufitare me Kosovën në Goshincë. Një incident i rëndë me impakt rajonal, por që u menaxhua disi nga faktori brendshëm dhe jashtëm dhe nuk degjeneroi në konflikt më të gjerë ndëretnik ishte ngjarja e 9 majit 2015 në qytetin e Kumanovës. Dhjetëra të vrarë dhe të plagosur nga forcat e sigurisë si dhe nga grupi i armatosur i gjendur në qytet ishte<sup>141</sup> rezultati i kësaj përplasje të armatosur. Dy vite më vonë Gjykata e Shkupit dënoi me burgime të gjata pasi shpalli fajtorë 33 nga 37 të burgosur të këtij grupi të armatosur<sup>142</sup>.

Pa marrë parasysh interesat e ndryshme që mund të ishin prapa kësaj ngjarje të rëndë (këtu kemi parasysh dyshimet për një vepër të Qeverisë për të larguar vëmendjen e opinionit nga skandali përgjimeve që zhvillohej në atë kohë), vetë natyra e këtij konflikti kish pasoja për raportet etnike, pasi pjesa më e madhe e forcave të sigurisë ishin me përkatësi etnike maqedonase kurse i gjithë

---

<sup>136</sup> Andreas Ernst. Mazedonische Enzyklopadie emport die Albaner. NZZ. 25.9.2009 ([https://www.nzz.ch/mazedonische\\_encyklopaedie\\_empoert\\_die\\_albaner-1.3664277](https://www.nzz.ch/mazedonische_encyklopaedie_empoert_die_albaner-1.3664277))

<sup>137</sup> Koha. Enciklopedia – Reagime. Botim i Gazetës Koha, Shkup, 2009, Faqe 336

<sup>138</sup> Makfax. Protesten Mars vo Tetovo. Ucesnicite so navredi do Makedoncite. 30 Septemvri 2009. <https://makfax.com.mk/makedonija/92356/>

<sup>139</sup> Radio Slobodna Evropa. MANU ja povlekuva Enciklopedijata. Vesti. Septemvri 30, 2009. (<https://www.slobodnaevropa.mk/a/1840311.html>)

<sup>140</sup> Sinisa Jakov Marusic. Macedonia: Deadly Shootout Tests Ethnic Relations. BIRN. December 30, 2015. <https://balkaninsight.com/2015/12/30/macedonia-deadly-shootout-tests-ethnic-relations-12-29-2015/>

<sup>141</sup> BBC, 11 May, 2015 (<https://www.bbc.com/news/world-europe-32695909>)

<sup>142</sup> Ilcho Cvetanoski. "Kumanovo group", heavy convictions for the 2015 shootout. Osservatorio Balcani e Caucaso. Transeuropa. 27/11/2017. <https://www.balcanicaucaso.org/eng/All-the-news/Kumanovo-group-heavy-convictions-for-the-2015-shootout-184346>



grupi i armatosur ishte etnikisht shqiptar dhe me raste edhe i uniformuar dhe me simbole kombëtare shqiptare. Kjo solli edhe kthimin e skenave të vitit 2001 në memorien e shumë banorëve të vendit. Pas ngjarjeve të rënda të Kumanovës nga maji i 2015 në territorin e Republikës nuk janë shënuar incidente të përmasave të këtilla.

## **3.2 Implementimi i MO**

Qëllimi thelbësor i nënshkrimit të Marrëveshjes së Ohrit ishte të shpëtohej vendi nga lufta e përgjithshme civile si dhe të adresoheshin ankesat e shqiptarëve për diskriminim dhe përjashtim nga sistemi politik ekonomik i Maqedonisë. Më tutje, synohej që me anë të integrimit të shqiptarëve në administratën shtetërore dhe publike të forcohej kohezioni i brendshëm social si dhe të kapeshin synimet madhore të çdo qeverisje maqedonase të periudhës së pas pavarësimit, integrimi i plotë në Bashkimin Europian dhe në Paktin Veriatlantik. Për pasojë, Parlamenti maqedonas adoptoi ndryshimet kushtetuese duke i pranuar ato në frymën e këtij kompromisi.

### **3.2.1 Ndarja e re territoriale**

Ligji i parë i miratuar në pajtim me Marrëveshjen e Ohrit dhe me shumë rëndësi për shqiptarët ishte Ligji për organizimin territorial të vetëqeverisjes lokale, që u miratua në vitin 2004 pas negociatave të gjata në momente edhe prapa kuintave mes përfaqësuesve të partnerëve qeveritarë, LSDM dhe BDI. Organizimi i ri uli numrin e njërive të vetëqeverisjes lokale në 84 me kryeqytetin Shkupin si njësi me status të veçantë të përbërë nga 10 komuna të bashkuara. Me organizimin e ri në Shkup u formua një komunë e re me shumicë shqiptare të popullsisë, numri i shqiptarëve u rit në disa komuna si rezultat i bashkimit të disa komunave rurale ndaj atyre urbane, si në Tetovë, Gostivar apo edhe në Struge dhe Kërçovë. Rasti i Kërçovës është më specifik pasi bashkimit iu dha një afat më i gjatë si një nga rastet e shumta të moszbatimit të parimit të decentralizimit dhe rregullimit të ri territorial të paraparë me MO. Bashkimi i Kërçovës urbane me komunat rurale të Zajazit, Oslomesë, Vraneshticës dhe Drugovës u bë vetëm në vitin 2013 me rastin e zgjedhjeve lokale.

Refuzimet dhe kritikrat më të mëdha erdhën nga opozita maqedonase përfaqësuar në atë kohë nga VMRO DPMNE dhe nga disa organizata të jashtme si Kongresi Botëror Maqedonas por edhe nga opozita shqiptare në lidhje me kufijtë e Komunës së Çairit në Shkup p.sh. Numrat në Parlament bënë që marrëveshja të votohet dhe të kalojë. Më 7 Nëntor 2004 Referendumi dështoi pasi në të morën pjesë më pak se 51% e trupit votues<sup>143</sup>. Organizimi i Referendumit kaloi në një atmosferë të tensionimit ndëretnik me mesazhe të ashpra në opinionin publik. U dalluan në këtë drejtim sidomos partitë opozitare maqedonase që shihnin në Ligjin e ri mundësinë e ndarjes etnike të vendit si dhe lëshime të rënda të Qeverisë majtiste ndaj interesave shqiptare. Shqiptarët

---

<sup>143</sup> OSCE. Former Yugoslav Republic of Macedonia. 7 November 2004 Referendum. OSCE/ODIHR Final Report. Warsaw, 2 February 2005. Faqe 22 (<https://www.osce.org/odihr/elections/fyrom/40863?download=true>)

nga ana tjetër nuk është se fituan shumëçka nga ky Ligj. Në fakt duke hequr dorë nga e drejta e rregullimeve territoriale të çështjeve etnike, organizimi i ri territorial dhe decentralizimi ishte minimumi që mbronte të drejtat kolektive të shqiptarëve dhe integronte ata në sistemin shtetëror dhe politik të vendit.

Gjithsesi, ndryshimet territoriale me Ligjin e ri nuk sollën edhe përfitime të mëdha për banorët me shumicë shqiptare të këtyre Komunave pasi përgjithësisht funksionimi i tyre më efikas varet nga procesi i decentralizimit fiskal i cili nuk është kompletuar akoma në Maqedoni. Sa i takon dotacioneve nga fondet qeveritare për komunat për të plotësuar financimin e tyre edhe pas miratimit të ligjit ka pasur diskrepanca të mëdha mes tyre, duket sipas kriterëve etnike. Kështu sipas qarkores buxhetore të Ministrisë së Ekonomisë drejtuar komunave nga viti 2006, pra dy vite pas miratimit të organizimit të ri territorial të njërive të vetëqeverisjes lokale, fondi për rrugë lokale të komunave Manastir e Prilep ishte gati sa dyfishi i atyre për rrugë lokale në Tetovë e Gostivar<sup>144</sup>. Nga viti 2013 nuk kemi ndryshime të tjera në këtë Ligj me rëndësi që buron nga MO.

### 3.2.2 Ligji për gjuhët

Një Ligj tjetër mjaft i rëndësishëm dhe vital për interesat komunitare shqiptare është ai që ka të bëjë me përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe. Në MO nuk ka emërtim të drejtpërdrejtë të shqipes, por flitet për gjuhë që e flasin së paku 20% e popullsisë. Partnerët qeveritarë miratuan fillimisht një Ligj të Gjuhëve në vitin 2008, që u quajt me emrin e plotë, Ligji për përdorimin e gjuhës që e flasin më së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe në njësitë e vetëqeverisjes lokale<sup>145</sup>.

Përsëri tekstualisht nuk përmendet fare gjuha shqipe dhe e njëjta reduktohet në një 20 % të paemër. Edhe me këtë Ligj shqipja nuk fitoi status të barabartë me gjuhën maqedonase. Sipas Ligjit të vitit 2008, përdorimi i zyrtar kufizohej me raste në Kuvend nga deputetët që flasin gjuhë të ndryshme nga maqedonishtja që e flasin 20 % e qytetarëve, pastaj në komunikimin e qytetarëve me Ministrinë, në procedura gjyqësore, në procedurat me Avokatin e Popullit, në procesin zgjedhor, në disa dokumente dhe procedura pranë gjendjes civile si ato personale. Parë në tërësinë e tij, ky Ligj nuk plotësonte kërkesat e popullit shqiptar në Maqedoni për trajtim të barabartë, d.m.th. zyrtarizim të plotë të gjuhës së tij amtare.

<sup>144</sup> Abdylmenaf Bexheti. Një dekadë e mendimit ekonomik dhe politik. Analiza, vlerësime e projeksione në prizmin e sfidave vendore. Logos A, 2006. Faqe 539

<sup>145</sup> Sluzben Vesnik na RM. Broj 101. 13 Avgust 2008.

<http://www.slvesnik.com.mk/Issues/DE07B4F6DDFBE948A0DFE2CFF240F02C.pdf>

Në vitin 2011, Kuvendi miratoi disa ndryshime me të cilat zgjeroi përdorimin e gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve, përveç deputetëve edhe tek Ministrat nëpër trupat punuese<sup>146</sup>. Të gjitha këto ndryshime edhe pse në frymën e MO, ishin kozmetike dhe nuk i jepnin një zgjidhje finale kësaj çështje me interes parësor për identitetin nacional të shqiptarëve.

Kjo çështje u rihap edhe njëherë më 2018 nga Qeveria e re e qendrës së majtë. Në janar shumica Parlamentare miratoi Ligjin për përdorimin e gjuhëve ku shqipja nuk evidentohet si e tillë por përsëri si gjuhë që e flasin më së paku 20% e qytetarëve. Pas shumë turbulencave politike dhe përplasjeve në Kuvend mes liderit të opozitës etnike maqedonase dhe Kryetarit të Kuvendit nga partia fituese shqiptare, si dhe pas refuzimit të prerë nga Presidenti i Republikës për të dekretuar Ligjin, Kryetari i Kuvendit me Dekret e shpalli atë më 14 Mars 2018 në Gazetën Zyrtare, edhe atë pa nënshkrimin e Presidentit të Republikës<sup>147</sup>. Ligji në fjalë e zgjeron gamën e përdorimit të shqipes, një detyrim ky nga Marrëveshja e Ohrit dhe synon të zbusë marrëdhëniet ndëretnike në Maqedoninë e Veriut. Në një akt shumë simbolik, me Ligjin e ri kreu i Kuvendit mund të udhëheqë punën e Kuvendit në gjuhën shqipe. Por edhe me ndryshimet e fundit ligjore në fushën e përdorimit të gjuhëve, nuk i jepet zgjidhje finale kërkesës themelore të shqiptarëve për barazimin e plotë të dy gjuhëve mazhoritare në Maqedoni, maqedonishtes dhe shqipes.

### 3.2.3 Çështja me simbolet shtetërore dhe kombëtare

Një Ligj tjetër me rëndësi për shqiptarët këtu dhe që buron nga dispozitat e MO është edhe ai që duhet të rregullojë çështjen e simboleve kombëtare apo siç thuhet aty, shprehjes apo afirmimit të identitetit kombëtar. Në fakt, maqedonasit kanë shpallur me vetiniciativë simbolet e tyre kombëtare si simbole shtetërore. Duke pasur parasysh raportet e forcës në të kaluarën kjo gjendje është çimentuar edhe në aktin më të lartë politik juridik të vendit, në Kushtetutën në fuqi. Kjo mbetet një pikë mosmarrëveshje pasi shqiptarët nuk identifikohen me simbolet shtetërore duke qenë se këto janë njëkohësisht edhe simbole kombëtare të komunitetit maqedonas. Në këtë pikë ndryshimi i parë në pajtim me MO është nga viti 2005, kur më 15 korrik është shpallur Ligji mbi përdorimin e flamujve të bashkësive në RM. Më vonë me insistimin e VMRO DPMNE, Gjykata Kushtetuese ka revokuar disa nene të tij që solli dorëheqjen e anëtarëve shqiptarë të kësaj Gjykate më të lartë në shtet. Në vitin 2011, Ligji është plotësuar me një Ligj të ri të quajtur, 'Mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për përdorimin e flamujve të bashkësive në RM'<sup>148</sup>, me të cilin supozohet ti jepet zgjidhje përfundimtare përdorimit të simboleve kombëtare.

<sup>146</sup> DW. Sobranieto gi izglasa promenite vo zakonot za jazicite. 16.07.2011. <https://www.dw.com/mk/a-15239724>

<sup>147</sup> Sobranie na Republika Makedonija. Ukaz za proglasuvane na Zakonot za upotreba na Jazicite. 14 Mart, 2018. Skopje. (<https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2019/01/Zakon-za-upotreba-jazitsite-14-01-2019.pdf>)

<sup>148</sup> Sluzben Vesnik na RM. Zakon za izmena i dopolnuvane na Zakonot za upotreba na znamenata na zaednicite vo Republika Makedonija. Skopje. Broj 100. 25 Juli 2011. ([http://www.slvnik.com.mk/Issues/47D56301AAB3324281A085DAAC0AEF98.pdf?fbclid=IwAR2ZFY1H79tedCxJeww1\\_J0XwrLloLQmYcbrG-7FFwe2xh8rqRrMQ7i7kwo](http://www.slvnik.com.mk/Issues/47D56301AAB3324281A085DAAC0AEF98.pdf?fbclid=IwAR2ZFY1H79tedCxJeww1_J0XwrLloLQmYcbrG-7FFwe2xh8rqRrMQ7i7kwo))

Sipas Ligjit në fuqi, aty ku bashkësitë përbëjnë mbi 50% të numrit të banorëve organet e vetëqeverisjes lokale në objektet me karakter publik pranë flamurit shtetëror mund të shpalojnë edhe flamurin e bashkësisë. Përmasat e flamurit të bashkësisë caktohen me nenin 8-a, sipas të cilit përmasat e flamurit shtetëror janë për një të tretën më të mëdha se ato të bashkësisë përkatëse. Është ky një diskriminim i llojit të veçantë me të cilin qytetarët shqiptarë por edhe politika e tyre nuk janë pajtuar, por janë të detyruar ta pranojnë si zgjidhje kalimtare.

### 3.2.4 Arsimi i lartë në gjuhën shqipe. Zyrtarizimi i UT

Çështja më e rëndësishme e kauzës shqiptare në Maqedoninë e Veriut ka qenë arsimi në gjuhën amtare. Numri i nxënësve që kanë mësuar në gjuhën shqipe sidomos në arsimin sipëror ka qenë veçanërisht i ulët. Edhe në Marrëveshjen e Ohrit kësaj çështje i kushtohet pasazhi i cili kërkon që arsimi sipëror për gjuhën që e flasin së paku 20% e popullsisë të jetë i financuar nga shteti. Por zgjidhja e afruar aty nuk ka qenë e kënaqshme për shqiptarët. Pas shumë debateve parlamentare dhe në një situatë të tensionuar nga reagimet e opozitës etnike maqedonase, në kuadër të rregullimeve të veçanta juridike, Kuvendi ka miratuar Ligjin për themelimin e Universitetit shtetëror në Tetovë në fund të Dhjetorit 2003<sup>149</sup>. Në fakt me këtë ligj është legalizuar Universiteti i Tetovës i themeluar në vitin 1994 nga Kuvendet Komunale të tre Komunave por që vepronte ilegalisht dhe nuk pranohej nga Shteti.

Edhe pse në sferën e shkollimit në gjuhën amtare duket që gjendjet janë përmirësuar ndjeshëm në krahasim me të kaluarën, duhet thënë që përsëri gjenden reminishenca të padrejtësive me sfond etnik. Kështu p.sh në vitin mësimor 2013/14, numri i filloristëve me mësim në gjuhën shqipe ka qenë 61.298 që kanë mësuar në vetëm 291 shkolla kurse për 122, 929 nxënësit me mësim në gjuhën maqedonase ka pasur 729 objekte shkollore<sup>150</sup>. Situata jonormale vërehen edhe me numrat e nxënësve nëpër paralele, ku ato shqiptare prirën të jenë të mbingarkuara kurse ato maqedonase në numra shpeshherë simbolikë.

Një problematikë të veçantë paraqesin edhe mungesat kronike të investimeve në Universitetet publike me mësim në gjuhën shqipe apo edhe ndarja e padrejtë e mjeteve buxhetore. Dallimet janë të qarta dhe të prekshme. Kështu për vitin buxhetor 2018, Ministria Arsimit kishte paraparë 1.352.174 denarë për Universitetin me mësim në gjuhën maqedonase Shën Kirili dhe Metodi në Shkup dhe vetëm 330.346 denarë për Universitetin Shtetëror të Tetovës me mësim kryesisht në gjuhën shqipe<sup>151</sup>.

<sup>149</sup> Framework Convention on National Minorities. ADI. Faqe 130

<sup>150</sup> Portalb. 50% e nxënësve në Maqedoni janë Shqiptarë. 16.04.2015. (<https://portalb.mk/162686-50-e-nxenesve-ne-maqedoni-jane-shqiptare/>)

<sup>151</sup> Alsat-M. Shteti më pak para për Universitetet shqiptare. 15.04.2018. (<https://ina-online.net/shteti-me-pak-para-per-universitetet-shqiptare/>)

Një pikë e rëndësishme në MO është parimi i votimit të dyfishtë për Ligje që kanë të bëjnë me kulturën dhe identitetin e shqiptarëve përgjithësisht. Me këtë ndërmjetësit ndërkombëtarë kanë tentuar të evitojnë praktikën negative dhe të shumëpërdorur nga shumica etnike maqedonase në vitet 90 të shekullit të kaluar, atë të mbivotimit të çdo kërkesë të deputetëve shqiptarë për avancim të gjendjes së Popullit tonë në Maqedoni. Parimi i quajtur Badinter është përdorur në vijimësi në punët e Kuvendit republikan.

### 3.2.5 Përfaqësimi i drejtë dhe adekuat me bazë MO

Pjesëtarët e komunitetit shqiptar në Maqedoninë e Veriut kanë qenë historikisht të diskriminuar në qasjen e tyre tek Institucionet publike. Ka qenë kjo pjesë e politikës diskriminuese ndaj tyre që në epokën jugosllave që si për inerci vazhdoi deri në vitin 2001. Ndër arsyt kryesore të konflikteve të dhunshme të vitit në fjalë përpos pjesës së diskriminimit kushtetues mund të shihet edhe pengimi sistematik i integritimit apo mospërfshirja e shqiptarëve në Institucionet publike. Qasja e munguar në tregun publik të punës ka pasur për pasojë shifrat e larta të papunësisë si dhe standardin e ulët jetësor të shqiptarëve, e pranuar kjo edhe nga autorë të veçantë maqedonas<sup>152</sup>.

MO i kushton një vëmendje të veçantë kësaj gjendje që në legjislacionin pozitiv është rregulluar me amendamentin VI, që ka ndryshuar alinenë 2 të nenit 8 të Kushtetutës<sup>153</sup>. Përfaqësimi i shqiptarëve në Administratën publike dhe shtetërore shënon një rritje të ngadalshme por konstante që nga viti 2002. Edhe pse në një numër rastesh kemi të bëjmë me punësime të natyrës partiake dhe jashtë kritereve e standardeve të pranueshme profesionale, përsëri vetë procesi është me rëndësi kardinale për demokracinë dhe stabilitetin afatgjatë të vendit. Shumica dërmuese e të punësuarve shqiptarë i plotësojnë kushtet e kërkuara dhe japin një kontribut me rëndësi në funksionimin e aparatit shtetëror dhe atij publik.

Të dhëna konkrete dhe transparencë në lidhje me ecurinë e procesit fillimisht kishte shumë pak. Nga pikëpamja e dhënies së informacioneve për publikun, çështjen më konkretisht e ka mbuluar Sekretariati për Implementimin e Marrëveshjes së Ohrit, por edhe organe të tilla si Avokati i Popullit apo organizatat e ndryshme ndërkombëtare që veprojnë këtu. Kështu në vitet 2007 – 2013 duke u bazuar në pasqyrën krahasuese të paraqitur nga Institucioni i Avokatit të Popullit, numri i përgjithshëm i të punësuarve shqiptarë në Institucionet buxhetore është rritur nga 6429 në vitin 2007 në 19.565 në vitin 2013. Por edhe numri i maqedonasve në të njëjtën periudhë kohore ka shkuar nga 49.923 më 2007 në 81.406 në vitin 2013.

<sup>152</sup> Nano Ruzin. Vo ocekuvanie na Balkanskiot Big Mac. Makedonija vo 2001: Inverzija na lesniot Optimizam. Në: Armijata na Republika Makedonija i nezhinite Reformi. Faqe 75 ([http://morm.gov.mk/wp-content/uploads/forum\\_mak\\_4.pdf](http://morm.gov.mk/wp-content/uploads/forum_mak_4.pdf))

<sup>153</sup> Mersim Maksuti. E Drejta Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë. Tetovë, 2010. Faqe 261

**Tabela 3** Pasqyra tabelore krahasuese e përfaqësimit të maqedonasve dhe shqiptarëve në Institucionet buxhetore për periudhën 2007 -2013<sup>154</sup>

Viti	Gjithsej të punësuar	Maqedonas		Shqiptarë	
		Gjithsej	%	Gjithsej	%
2013	108 078	81 406	75.3	19 565	18.1
2012	107 851	81 095	75.2	19 151	17.8
2011	102 103	77 879	76.3	17 598	17.2
2010	82 555	63 761	77.23	13 966	16.92
2009	69 148	55 266	79.92	9712	14.05
2008	67 728	55 193	81.49	8642	12.76
2007	59 629	49 923	83.72	6429	10.78

Nga të dhënat krahasuese të Institucioneve buxhetore që vetë kanë ofruar të tilla, shihet qartë që gjer në vitin 2013 me gjithë përparimin e dukshëm nuk është plotësuar një nga parimet e rëndësishme të Kompromisit të Ohrit.

Për periudhën 2014 – 2017, gjithnjë duke iu referuar të dhënave nga zyra e Avokatit të Popullit, vërehet edhe një rritje e lehtë e numrit të të punësuarve shqiptarë nëpër Institucionet publike, por gjithnjë poshtë përqindjes së shqiptarëve në numrin e përgjithshëm të popullsisë.

**Tabela 4** Pasqyra tabelore krahasuese e përfaqësimit të maqedonasve dhe shqiptarëve në Institucionet buxhetore për periudhën, 2014 -2017<sup>155</sup>

Viti	Gjithsej të punësuar	Maqedonas		Shqiptarë	
		Gjithsej	%	Gjithsej	%
2017	131.488	97.542	74.2	25.173	19.2
2016	130.309	96.631	74.2	25.020	19.2
2015	120.513	89.967	74.7	22.651	18.8
2014	108.848	81.387	74.8	20.197	18.6

Për të dhënat më të sakta dhe përfundimtare, duhet pasur parasysh që një numër i Institucioneve publike nuk kanë dorëzuar të dhëna tek Avokati Popullit në lidhje me përfaqësimin e drejtë dhe adekuat edhe pas insistimeve telefonike apo tjera të Institucionit në fjalë. Sipas Raportit të

<sup>154</sup> Republika e Maqedonisë. Avokati i Popullit. RAPORT VJETOR për nivelin e sigurimit të respektimit, avancimit dhe mbrojtjes së lirisë dhe të drejtave të njeriut. 2013. Shkup, Mars 2014, Faqe 72

<sup>155</sup> Republika Makedonija. Narodni Pravobranitel. Izvestaj za sledeneto na primenata na naceloto na soodvetna i pravica zastapenost za 2017 godina. Skopje, Juni 2018 godina. Faqe 5 (<http://ombudsman.mk/upload/documents/SPZ/SPZ-2017-Mk.pdf>)

Avokatit të Popullit nga qershori 2017, vetëm 1276 Institucione nga 1339 të cilave u është dërguar kërkesë kanë dorëzuar raporte. Mungojnë informacionet edhe nga 63 të tilla.

Edhe nga tabela e dytë krahasimore për periudhën, 2014 – 2017 vërehet një rritje konstante e numrit të të punësuarve në organet publike, por që nuk arin dot të kapi 25.2%<sup>156</sup> e pranuar zyrtarisht si numër i shqiptarëve nga censusi i vitit 2002. Të dhëna konkrete për vitin 2018 nuk janë botuar në organet zyrtare të Avokatit të Popullit apo të Sekretariatit për Implementimin e marrëveshjes së Ohrit. Për më tepër, Sekretariati është në prag shpërbërje sipas informacioneve më të fundit qeveritare nga viti 2019.

Parë në tërësinë e saj, fatkeqësisht, as më 2019, gati dy dekada pas nënshkrimit, MO nuk është implementuar në tërësinë e saj. Nga ana tjetër, komuniteti shqiptar për vetë forcën e tij numerike si dhe shtrirjen e gjerë territoriale me anë të forcave të reja politike, i sheh në masë të madhe si të tejkaluara dhe rigjide dispozitat e kësaj marrëveshje dhe është duke kërkuar ndryshimin e Kushtetutës dhe barazinë e plotë me komunitetin maqedonas. Këto janë kërkesa racionale në kuadër të demokracisë moderne parlamentare dhe frymës europiane në të cilën jetojmë gjithë bashkë sot në kontinentin europian.

Me rastin e ndryshimeve të fundit kushtetuese si rezultat i Marrëveshjes së Prespës në lidhje me ndryshimin e emrit zyrtar të Republikës, kërkesat e opinionit të gjerë publik shqiptar për ndryshimin e dhe plotësimin e Kushtetutës në mënyrë që të arrihet barazia e plotë kushtetuese mes dy komuniteteve më të mëdha etnike, nuk u morën parasysh nga partnerët qeveritarë por as nga faktorë të caktuar nga bashkësia ndërkombëtare që e përgatiti Marrëveshjen. Kështu shqiptarët në RMV mbeten edhe mëtej me një status të dyzuar kushtetues, mes atij të një minoriteti të madh me të drejta të gjera por minoritare dhe elementit shtetformues të shtetit.

### **3.3. Mosbesimi i ndërsjellë etnik**

Marrëdhëniet ndëretnike në Maqedoninë e Veriut mbeten peng i mosbesimit të thellë etnik që ekziston në Shoqëri. Kjo i ka rrënjët në politikën diskriminuese dhe përjashtuese të qeverive maqedonase në të kaluarën por edhe në vazhdimin e këtij diskriminimi akoma sot, edhe pse në një formë dhe mënyrë shumë më të moderuar dhe diskrete. Edhe pse gjendja e sotme jonormale e përgjithshme e marrëdhënieve etnike nuk mund të krahasohet me dekadat apo edhe vitet e shkuara, ajo është omniprezente në shoqëri.

Kontaktet sociale mes pjesëtarëve të komuniteteve të ndryshme etnike janë të pakta përveç minimumit të domosdoshëm për realizimin e veprimtarive të përditshme në ndërmarrjet apo Institucionet ku janë të punësuar persona me përkatësi të ndryshme etnike. Edhe në qytete të mëdha qytetarët shfaqin prirjen të jetojnë në zona apo lagje ku banojnë kryesisht pjesëtarë nga i

<sup>156</sup> Central Intelligence Agency. The World Factbook. Europe: North Macedonia. Population. Ethnic Groups. May 29, 2019. <https://www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook/geos/mk.html>

njëti komunitet. Edhe hapësira urbane duket të jetë e ndarë në blloqe etnike me pak ose aspak kontakt social me njëri tjetrin.

Martestat ndëretnike janë në shifra të papërfillshme për të mos thënë inekzistente. Në fakt, kemi të bëjmë me dy grupe të mëdha etnike që jetojnë bashkërisht, me raste edhe afër njëri tjetrit por që nuk përzihen me njëri tjetrin. Niveli i pëlqimit për njëri tjetrin siç del edhe nga hulumtimet e kryera në teren nuk është në nivelet e duhura. Kështu në anketimet e shumta serbët apo bullgarët janë më të pranueshëm për maqedonasit sesa bashkëqytetarët e tyre shqiptarë. E njëjta ndodh edhe tek shqiptarët për të cilët është e natyrshme të parapëlqejnë bashkëkombësit e tyre nga Shqipëria apo Kosova para bashkështetasve të tyre maqedonas etnikë. Në votimet online për festivalin paneuropian Eurovision që është një tregues ekselent i parapëlqimeve kulturore, maqedonasit etnikë votojnë në shumicë për këngët nga Serbia apo Bullgaria kurse shqiptarët etnikë në masë të madhe për përfaqësuesin e Shqipërisë. Edhe në eventet sportive me pjesëmarrje masive të publikut, përsëriten rregullisht përvojat e njëjta të mospëlqimit madje edhe fyerjeve en bllok për grupin tjetër etnik.

Politika dhe jeta publike mbetet me sfond kryesisht etnik. Partitë e kanë shumicën absolute të elektoratit nga prapavija e ngjashme apo përafërt kulturore e botëkuptimore kurse kandidatët apelojnë kryesisht tek baza e njëjtë etnokulturore. Votat për kandidatët nga komuniteti tjetër shkojnë vetëm në raste të rralla, por edhe në ato momente me mendimin e përfitimit për interesat grupore të komunitetit. Kjo vërehet më mirë në zgjedhjet presidenciale ku një numër shumë i vogël i votuesve shqiptarë dalin në raundin e dytë. Në fakt me eliminimin e kandidatëve shqiptarë, bie edhe interesi i pjesës më të madhe të votuesve shqiptarë për të votuar për kandidatë maqedonas në raundin tjetër. Në këtë raund votojnë kryesisht militantët për interesa partikulare partiake, jo qytetari shqiptar me vullnet e bindje të lirë për interesa të përgjithshme nacionale.

Zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të vitit 2016 duket sikur thyen për herë të parë në historinë e pluripartizmit këto praktika me opozitarët majtistët maqedonas të LSDM, që thithën befasisht një numër të konsiderueshëm votash shqiptare<sup>157</sup>. Por ky fenomen ndodhi në hapësirë e kohë të caktuar dhe si rezultat i krizës së thellë politike që përfshiu partnerët qeveritarë dhe partitë politike shqiptare në qeveri e opozitë bashkë, pas bërjes publike të skandalit të përgjimit joligjor të mijëra qytetarëve nga organet shtetërore dhe keqpërdorimit të këtyre të dhënave nga Qeveria.

Zbardhjet konsektive të përgjimeve edhe të anëtarëve të kabinetit ku vërtetohej qartë papërgjeshmëria e tyre ndaj interesit publik si dhe përfshirja e mundshme në afera korruptive, bënë që të bie legjitimiteti i partive qeveritare. Në këto rrethana të jashtëzakonshme për praktikën qeveritare dhe për sistemin politik përgjithësisht ndodhi që opozita maqedonase të mund të thithë vota shqiptarësh në Shkup kryesisht, ku shqiptarët janë pakicë e popullsisë dhe në

<sup>157</sup> NDI. Orderly Voting Process Characterized Macedonia's 2016 Parliamentary Elections. Saturday, December 17, 2016. (<https://www.ndi.org/our-stories/orderly-voting-process-characterized-macedonias-2016-parliamentary-elections>)



zona tjera në Maqedoninë qendrore, kurse shumë pak ose aspak në zonat e banuara me shumicë dërmuese shqiptare të popullsisë në veriperëndim dhe perëndim të vendit.

Zgjedhjet presidenciale vijuese e rikuperuan menjëherë këtë anomali. Kandidati maqedonas etnik i LSDM në zgjedhjet presidenciale të vitit 2019 sidomos në raundin e parë kur vota është kryesisht etnike, as për së afërmi nuk mori ato vota shqiptare si partia e tij në zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të 2016. Zakonisht, kandidatët maqedonas marrin vota shqiptare në zonat periferike ku shqiptarët janë pakicë absolute e popullsisë, kanë qenë në të kaluarën të diskriminuar tmerrësisht si dhe kryesisht në zgjedhje lokale. Këto janë praktika të njohura shoqërore kur grupet e marginalizuara dhe diskriminuara përpiqen që të ndryshojnë pozitën e tyre të palakmueshme shoqërore duke votuar për kandidatët më të moderuar të grupit tjetër etnik.

Por në zonën perëndimore të Republikës përgjatë gjithë gjatësisë së kufirit me Republikën e Shqipërisë ku shqiptarët përbëjnë shumicën e popullsisë, vota është kryesisht etnike dhe tradicionalisht për kandidatët shqiptarë pa marrë parasysh proveniencën ideologjike.

Parë në përgjithësi, niveli i paragjyqimit dhe mosbesimit mes dy komuniteteve më të mëdha mbetet i lartë. Edhe në fushatën për zgjedhjet e fundit parlamentare, partia fituese maqedonase VMRO DPMNE mobilizoi dhe apeloj tek zgjedhësit e saj me moton e mbrojtjes së shtetit nga shqiptarët, të cilët në marrëveshje me ‘armikun e brendshëm dhe të huajt’<sup>158</sup> konspirojnë për dëmtimin e vendit. Një fjalor apo diskurs i tillë publik nga struktura kryesore e organizuar politike e komunitetit zyrtarisht më të madh, nuk kontribuon në zbutjen e tensioneve etnike në vend. Për më shumë, fjalori i tillë është në vazhden e traditës dhe përvojave jo të mira nga e kaluara e këtyre raporteve.

Kjo vërteton edhe njëherë tezën e këtij punimi për mosbesimin e shumëpërhapur dhe të gjithëpranishëm mes dy grupeve kryesore etnike në Maqedoninë e Veriut, paragjyqimet e shumta, mosdurimin etnik dhe në instancë të fundit, marrëdhëniet e përgjithshme jo të mira ndëretnike në Republikë. Këtë nuk ka arritur ta evitojë as praktika e përhershme e përfshirjes në qeverisje të partive politike shqiptare pasi edhe mëtutje vazhdojnë mosmarrëveshjet apo fërkimet mes dy grupeve të mëdha etnike<sup>159</sup>. Duhet thënë që në këtë aspekt, Maqedonia e Veriut nuk bën dallim nga shoqëri tjera ballkanike ku niveli i mosbesimit apo edhe mosdurimit etnik është akoma në nivele shumë të larta, të pakrahasueshme me pjesën tjetër të Europës.

### **3.4 Faktori ndërkombëtar si deterent mes palëve në konflikt të vazhdueshëm politik**

---

<sup>158</sup> Dane Talevski. The Elections in Macedonia brought Political balance, but will they bring stability or restore democracy? December 14<sup>th</sup>, 2016. (<https://whogoverns.eu/the-elections-in-macedonia-brought-political-balance-but-will-they-bring-stability-or-restore-democracy/>)

<sup>159</sup> United Nations Country Team, Skopje. Partnership for Sustainable Development. United Nations Strategy for 2016 -2020. Faqe 12. (<http://www.un.mk/docs/UNDAF20162020.pdf>)

Një rol të rëndësishëm në pavarësimin, njohjen ndërkombëtare dhe mbrojtjen e Maqedonisë së Veriut nga synime të caktuara territoriale apo tjera të fqinjëve të caktuar ka luajtur tradicionalisht faktori ndërkombëtar. Roli i Bashkimit Europian, SHBA dhe Paktit Veriatlantik në momente ka qenë i pazëvendësueshëm. Që në hapat e parë të pavarësimit të kësaj republike të vogël ish Jugosllave, diplomacia europiane dhe amerikane kanë dhënë kontributin e tyre.

Që me fillimin e krizës jugosllave Bashkësia e atëhershme dymbëdhjetë anëtarëshe Europiane tentoi të involvohej në krizën në zhvillim e sipër, në kuptim të evitimit të luftërave civile ndërmjet Republikave dhe Krahinave Jugosllave. Në kuadër të ndihmës juridike, BE themeloi një Komision arbitrazhi të quajtur me emrin e kryesuesit të tij, z.Robert Badinter, President i Gjykatës Kushtetuese të Francës<sup>160</sup>. Mendimi i Komisionit në lidhje me Maqedoninë ishte që vendi i plotëson kriteret e vëna nga Këshilli i Ministrave të Bashkësisë Europiane për tu pavarësuar por me kushtin e ndryshimit të dy neneve në Kushtetutë. Kjo erdhi si rezultat i kërkesave dhe ndërhyrjeve greke në Komision. Nga ana tjetër, Komisioni nuk pati parasysh kërkesat e faktorit politik shqiptar në atë kohë në lidhje me plotësimin e standardeve europiane në fushën e lirive e të drejtave kolektive politike dhe të njeriut të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut.

Anëtarësimi i Maqedonisë në OKB me emrin e përkohshëm Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, u bë më 8 Prill 1993<sup>161</sup>. Edhe kjo e arritur kombëtare nga pikëpamja etnike maqedonase u realizua në masë të madhe me ndikimin e faktorëve amerikanë dhe europianë të cilët nuk donin një zgjerim apo shtrirje të konfliktit të armatosur në jug të Ballkanit. Prezenca ndërkombëtare në Maqedoni e njohur me emrin UNPROFOR (United Nations Prevention Force), u përforcua edhe me 300 ushtarë amerikanë të cilët patrullonin kufijtë veriorë dhe përëndimorë të vendit. Misioni i OKB në IRJM e atëhershme kishte për detyrë mbikëqyrjen e kufirit mes saj dhe Jugosllavisë Federale dhe raportimin e të dhënave tek Komanda e OKB<sup>162</sup>. Gjithsesi, vetë prezenca fizike ndërkombëtare shërbente si vërejtje ndaj ndonjë aventure të mundshme ushtarake serbe në jug. Në vitet 1995 – 1999, OKB i ndryshoi emrin Misionit në UNPREDEP, por vetë ai si dhe objektivat e shpallur mbeteshin edhe mëtej të vjetrat.

Me rastin e ndërhyrjeve brutale të forcave kryesisht monoetnike të sigurisë në vitet 1994 në themelimin e Universitetit më mësim në gjuhën shqipe në Tetovë, pastaj në vitin 1997 me rastin e vendosjes së flamujve shqiptarë në Komunitat e Tetovës dhe Gostivarit nga kryetarët përkatës, komuniteti ndërkombëtar me gjithë hedhjen poshtë pa ekuivoke të dhunës si mjet për zgjidhjen e kontesteve politike, pati reagim të butë dhe të kujdesshëm ndaj Qeverisë maqedonase. Madje as

---

<sup>160</sup> Alain Pellet. The Opinions of the Badinter Arbitration Committee A Second Breath for the Self Determination of Peoples. EJIL (1992) 178, Faqe 1. (<http://ejil.org/pdfs/3/1/1175.pdf>)

<sup>161</sup> James Poulton. Vepra e cituar. Faqe 177

<sup>162</sup> Charles Edward Kirkpatrick. Ruck it Up!": the post Cold War transformation of the V Corps. 1990 – 2001. Washington D.C. Department of the Army. Faqe 276. (E- Book)

organizma të rëndësishëm ndërkombëtarë si OSBE apo OKB<sup>163</sup> nuk ushtruan kritika të drejtpërdrejta ndaj Qeverisë për shkelje të lirive e të drejtave të njeriut edhe pas përplasjeve të para me katër viktima civile në Gostivar.

Mosmarrëveshjet me Republikën e Greqisë në lidhje me emrin zyrtar të vendit zgjatën nga viti 1991 gjer më 2018, kur dy shtetet nënshkruan Marrëveshjen e Prespës me të cilën i dhanë fund krizës në marrëdhëniet dypalëshe. Në gjithë këtë periudhën e ndërmjetme një rol me rëndësi në evitimin e kontradiktave dhe përfrimin e qëndrimeve ka pasur ndërmjetësi amerikan Matthew Nimetz si përfaqësues special i OKB për çështjen e emrit dhe Bashkimi Europian nëpërmjet influencës së drejtpërdrejtë në Athinë dhe Shkup. Nga ana tjetër, Marrëveshja finale e Prespës që mbylli kontestin 26 vjeçar mes fqinjëve erdhi si rezultat i përpjekjes masive të diplomacisë europiane dhe amerikane.

Rolin më të rëndësishëm komuniteti ndërkombëtar e ka pasur në ruajtjen e stabilitetit të brendshëm në vend, edhe pse kjo duket të jetë arritur në kurriz apo së paku duke vonuar realizimin e interesave të natyrshme dhe racionale politike të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut. Faktorët politikë amerikanë që nga hapja e Zyrës ndërlidhëse në Shkup më 3 Dhjetor 1993<sup>164</sup>, kanë luajtur një rol të vazhdueshëm proaktiv në ruajtjen e stabilitetit, forcimin e institucioneve, uljen e tensioneve etnike dhe në forcimin e demokracisë së brendshme në republikë. Në vitin e krizës 2001, diplomacia amerikane ndërhyri në mënyrë energjike për të gjetur një zgjidhje paqësore të konfliktit. Edhe nga vetë pjesëtarë të lëvizjeve politike ushtarake të kohës, roli amerikan shihet pozitivisht dhe vlerësohet si i rëndësishëm parësore për ndërprerjen e kryengritjes së armatosur<sup>165</sup>. Edhe pse në qarqe ekstreme maqedonase kjo ndërhyrje u cilësua si ndihmë amerikane për faktorin shqiptar, nga një distancë kohore dydekadëshe mund të shihet që ndërhyrja amerikane ka qenë në interes të mbijetesës së Maqedonisë së Veriut si shtet i pavarur dhe subjekt i së të drejtës ndërkombëtare, synime këto parësore të deklaruara të vetë maqedonasve etnikë.

Parë nga pikëpamja e interesave shqiptare në Maqedoninë e Veriut, ndërhyrja amerikane për kohën dhe momentin ka qenë pozitive, neutrale dhe e pranueshme. Ajo që me MO nuk janë plotësuar interesat e ligjshme shqiptare në tërësinë dhe gjerësinë e tyre, nuk mund të merret si dështim i diplomatëve të huaj pasi në instancë të fundit MO ishte një kompromis mes dy palëve dhe si çdo kompromis nuk paraqet një zgjidhje perfekte<sup>166</sup> për palët e përfshira në të.

Një rol me rëndësi në arritjen e Marrëveshjes kishte edhe Bashkimi Europian me përfaqësuesin e drejtpërdrejtë në negociatë, Françoise Leotard por edhe në forma e mënyra tjera të rëndësishme

<sup>163</sup> Human Rights Watch. Macedonia. Police Violence in Macedonia. Role of the International Community. Vol 10. No 1. April 1998. ([https://www.hrw.org/legacy/reports/reports98/macedonia/maced2a.htm#\\_1\\_16](https://www.hrw.org/legacy/reports/reports98/macedonia/maced2a.htm#_1_16))

<sup>164</sup> U.S Embassy in North Macedonia. Policy and History. U.S – North Macedonia relations.

(<https://mk.usembassy.gov/our-relationship/policy-history/>)

<sup>165</sup> Ibrahim Kelmendi, Shqiptarët dhe sfidat e tyre në Maqedoni, Tetovë, dhjetor 2005, Faqe 40

<sup>166</sup> Ambassador James W. Pardew. Diplomatic History of the OFA. 10 Years Ohrid Framework Agreement. SEEU, 2011. Faqe 23

për arritjen e një zgjidhje paqësore mes palëve. Bashkimi European u ka dhënë një rëndësi të veçantë marrëdhënieve me Maqedoninë e Veriut. Kështu vendi që më 2004 ka nënshkruar me BE Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA), kurse pas Marrëveshjes së emrit me Greqinë më 2018, pritet të fillojë negociatat për anëtarësim.

Në raportet e deritanishme që Institucionet e BE përgatisin për Maqedoninë e Veriut, shihen kryesisht vlerësime realiste të gjendjes politike, ekonomike dhe sociale të vendit. Për më tepër shtysa për integrim në BE bën që Qeveritë e ndryshme maqedonase me pak dallime të angazhohen për të realizuar kriteret e parapara për anëtarësim. Ky prospekt bën që edhe faktori politik shqiptar të duket më i durueshëm në kërkesat dhe përpjekjet për avancim socio ekonomik, pasi shpresohet që integrimi european do të zgjidhë përfundimisht çështjen e diskriminimit politik ekonomik të shqiptarëve këtu. Në instancë të fundit duket që mundësia e integritit european luan rolin e një qetësuesi të marrëdhënieve ndëretnike dhe menaxhuesi krizash potenciale në Maqedoninë e Veriut.

Parë realisht, Bashkimi European dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës nëpërmjet politikave të tyre parandaluese dhe asistuese kanë qenë dhe mbeten, garantë si të paqes së brendshme sociale mes komuniteteve etnike ashtu edhe të mbijetesës së Republikës në skenën ndërkombëtare apo edhe integritit të saj përfundimtar në strukturat euroatlantike.

### **3.5 Prospekte për të ardhmen e marrëdhënieve ndëretnike në Maqedoninë e Veriut**

Progresraporti i fundit i Bashkimit European për Maqedoninë e veriut që mbulon periudhën mars 2018 – mars 2019<sup>167</sup>, edhe pse marrëdhëniet etnike i cilëson si të qeta, përsëri pranon tensionet e kohëpaskohshme. Është gjendja faktike në shoqëri, në opinionin publik, në media, në jetën e përditshme ajo që tregon realitetin e këtyre marrëdhënieve dhe që nuk lejon zbulimin e tyre, me gjithë tendencat e kohëpaskohshme me natyrë ideologjike por edhe makiaveliste për të mbuluar me fasadë suksesesh këtë realitet.

Duke thënë këtë dhe për të qenë neutralë në shpjegimin apo përshkrimin e realiteteve shoqërore, duhet thënë që qeveria e re e qendrës së majtë ka krijuar në shikim të parë një klimë më ndryshe në këto marrëdhënie. Nuk ka në publik deklarata antishqiptare apo fyerje me natyrë etnike nga

---

<sup>167</sup> European Commission. North Macedonia 2019 Report. Brussels, 29.5.2019. SWD(2019) 218 Final. Faqe 3. (<https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-north-macedonia-report.pdf>)

ekspozentë të lartë qeveritare si më herët. Edhe diskursi politik i kryeministrit aktual Zaev, është më tolerant dhe gjithëpërfshirës, në një ndarje të qartë nga retorikat polarizuese dhe irituese të qeveritarëve në të kaluarën. Segmente të caktuara të partisë së tij janë përpjekur të afrojnë madje edhe votues e kandidatë shqiptarë në zgjedhjet e fundit, edhe pse me rezultate minimale.

Kjo s'do të thotë që raportet mes dy grupeve më të mëdha janë krejtësisht ndryshe nga më herët apo se diskriminimi i shqiptarëve në baza etnike është eliminuar tërësisht. Marrëveshja e Ohrit, një zgjidhje kompromisi si çështje vlerësuar nga vëzhgues të paanshëm e neutralë, nuk është realizuar plotësisht as më 2019. Shqiptarët vazhdojnë të mbeten prapa tjerëve në treguesit ekonomikë, socialë dhe ato të zhvillimit human. Edhe përcaktimet e fundit të investimeve publike lënë për të dëshiruar. Rajonet nuk arrijnë të marrin investime të barabarta për kokë banori pa marrë parasysh përkatësitë etnike, edhe pse edhe këtu qeveria e re priret të tregohet së paku deklarativisht ndryshe nga të mëparshmet.

Partia e dytë më e madhe etnike maqedonase momentalisht në opozitë, vazhdon me diskursin e vjetër divizion me raste edhe urrejtës në opinionin publik. Kjo me automatizëm tensionon raportet mes grupeve të ndryshme etnike.

Raportet aktuale politiko etnike nuk janë aq të tensionuara sa në të kaluarën e afërt, por jo edhe aq të mira dhe relaksuese siç paraqiten nga propaganda e pushtetit të tanishëm.

Çështja më e rëndësishme nga të cilat do varen raportet etnike në të ardhmen do jetë akomodimi final i statusit kushtetues të komunitetit të dytë më të madh këtu, atij shqiptar. MO si e tillë e inkorporuar në kushtetutën e vendit nëpërmjet ndryshimeve kushtetuese, nuk duket se i përgjigjet gjendjes cilësisht të re të shqiptarëve në Maqedoninë e veriut. Mbyllja e çështjeve të këtilla kryesore kushtetuese do ishte kontributi më i madh i establishmentit etnik maqedonas në drejtim të ruajtjes së ardhmërisë së vendit. Pa një barazi të plotë nacionale dhe kushtetuese të shqiptarëve dhe maqedonasve nuk do ketë paqe etnike dhe situata do mbetet gjithnjë e tensionuar. Tensionimi permanent sjell afër mundësinë e përsëritjes së konflikteve serioze dhe të dhunshme nga e kaluara.

Një çështje e dytë e cila do të stabilizonte këto marrëdhënie janë investimet e shtuara publike në zonat shqiptare, të anashkaluara tradicionalisht nga të gjitha qeveritë e periudhës së post pavarësisë. Barazia e plotë madje edhe aksioni afirmativ për rajonet e anashkaluara gjatë kohë në investime publike, do relaksonin deri diku raportet mes komuniteteve dhe do bindnin qytetarët shqiptarë për një ndryshim real dhe jo vetëm deklarativ të politikës shtetërore ndaj tyre.

Një faktor i tretë por jo më pak i rëndësishëm mbetet edhe integrimi europian dhe lidhur me të demokratizimi i përgjithshëm i shoqërisë. Rrugëtimi i përsheptuar drejt BE ka gjasa të relaksojë po ashtu marrëdhëniet ndër-etnike. Në këtë drejtim, prezenca ndërkombëtare në vend në formë të institucioneve apo organizmave këshillues europianë duhet të vazhdojë dhe mundësisht të zgjerohet. Roli i BE këtu duhet vlerësuar edhe në prizmin e stabilizimit përfundimtar të rajonit

pasi problematikat duken të ndërlidhura dhe krizat në fqinjësi të afërt shfaqin tendenca për tu zgjeruar.

Refuzimi i barazisë së plotë kushtetuese të dy komuniteteve më të mëdha, maqedonasve dhe shqiptarëve dhe përpjekjet për kthim prapa drejt praktikave majorizuese dhe diskriminuese nga ana tjetër do ishin të rrezikshme për marrëdhëniet ndëretnike dhe për vazhdimësinë e Maqedonisë së Veriut si shtet i pavarur. Ky duket të jetë kushti mbijetesës dhe ndërtimit të një shoqërie demokratike, konsociacionale dhe funksionale, pa tensione etnike apo tjera dhe të integruar në BE.

## Kapitulli

# IV

## Shpalosja e rezultateve nga hulumtimi i mendimit të qytetarëve

---

Një nga rrugët më të sigurta dhe të drejtpërdrejta të mbledhjes së të dhënave në lidhje me qëndrime apo me fenomene të caktuara, është metoda e anketimit të drejtpërdrejtë të pjesëtarëve

të grupeve të prekura shoqërore. Edhe pse me mangësi të caktuara shkaku i pamundësisë së intervistimit të mijëra qytetarëve në një hapësirë më të madhe gjeografike, duhet thënë që shembujt reprezentativë japin një pasqyrë të përafërt të mendimeve apo edhe qëndrimeve të caktuara politike të grupeve etnike, racore, religjioze, gjinore apo tjera.

Në interes të vërtetimit të hipotezave të hedhura në letër, në pjesën e fundit të punimit, do të ofrojmë të dhëna konkrete empirike nga hulumtimi i mendimit të qytetarëve të Tetovës në lidhje me bashkëqytetarin apo “tjetrin” në komunitet.


Pyetjet janë përpiluar në mënyrë të tillë që në to të gjejnë veten strukturat moshore, profesionale dhe gjinore. Prej atyre më pak të ‘rënda’, më shumë rinore dhe shkollore në lidhje me frekuentimin e lokaleve, gjuhët obligative nëpër shkolla apo tifozllëkun dhe aktivitetet sportive tek klubet e komunitetit tjetër drejt atyre më serioze në lidhje me anëtarësimin e mundshëm në apo votimin e subjekteve të komunitetit tjetër. Pjesës politike të themi të pyetjeve mund ti shtohen edhe ato në lidhje me besueshmërinë në institucionet shtetërore/publike apo për mundësitë e konflikteve me natyrë etnike në vend.

Nuk mund të mungonin edhe pyetjet me natyrë personale emocionale që janë shumë të rëndësishme në përcaktimin e distancave apo afërsisë që individët si pjesëtarë të grupit kanë për pjesëtarët e grupit tjetër.


Për fund të kësaj hyrje sqaruese, duhet të themi që % e dala nga Pyetësori i kemi rumbullakësuar në interes të efikasitetit dhe paraqitjes sa më të qartë, të thjeshtë dhe të kuptueshme për lexuesin.

Grafiku i parë ilustron ndarjen gjinore të anketuarve. Numri i meshkujve dhe i femrave është ndarë në mënyrë të barabartë. Ndarja etnike dhe gjinore është si vijon: 500 qytetarë shqiptarë të ndarë në mënyrë të barabartë në 250 meshkuj dhe 250 femra dhe 200 qytetarë me përkatësi etnike maqedonase të ndarë po ashtu në mënyrë të barabartë, 100 meshkuj dhe 100 femra.

**Graf 2.0 (Struktura gjinore – Shqiptarë, 250 Meshkuj dhe 250 Femra)**




**Graf 2.0 (Struktura gjinore – Maqedonas, 100 Meshkuj dhe 100 Femra)**




Grafiku i dytë tregon strukturën moshore të të anketuarve. Kështu, janë anketuar 700 persona të grupmoshave të ndryshme ku prevalon ajo mes 18 – 25 vjeç me afro 60% të të anketuarve, pjesë e këtij grupi moshor. 25 – 55 vjeçarët janë rreth 30% kurse personat më të moshuar mes 55 – 65 vite përbëjnë afër 10% të numrit të përgjithshëm të të anketuarve. Ndarja është përafërsisht e njëjtë për pjesëtarët e të dyja komuniteteve.



**Graf. 2.1 (Moshë - Shqiptarët)**




**Graf. 2.1 (Moshë - Maqedonasit)**




Grafiku në vijim ilustron prejardhjen gjeografike të të anketuarve apo më saktë vendbanimin e tyre. Edhe këtu i kemi qëndruar besnikë ndarjes së barabartë të qytetarëve të anketuar pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike. Pra, 70% prej tyre vijnë nga zona urbane, kurse 30 % nga fshatra apo zonat rurale përreth qytetit të Tetovës.

**Graf. 2.2 (Vendbanimi – Shqiptarët)**




**Graf. 2.2 (Vendbanimi – Maqedonasit)**




Pyetja e parë në pyetësin e përpiluar për këtë qëllim dhe parashtruar qytetarëve të anketuar, ka qenë në lidhje me përbërjen etnike të vendbanimit ku ata jetojnë.

**Graf 2.3 Në vendbanimin ku jetoni a ka pjesëtarë të komuniteteve tjera etnike? (Maqedonas)**



Shqiptarët i janë përgjigjur kësaj pyetjeje në 73 % të rasteve me po dhe në 27% prej tyre me jo. Përqindja e madhe pohuese e shqiptarëve shpjegohet me koncentrimin tonë kryesisht në qytet dhe në disa zona rurale por me popullatë të përzier etnike gjatë anketimit të pjesëtarëve të këtij grupi etnik.


**Graf. 2.3 Në vendbanimin ku jetoni a ka pjesëtarë të komuniteteve tjera etnike? (Shqiptarë)**



Pyetjes së njëjtë, 74% e maqedonasve i janë përgjigjur pozitivisht kurse resti prej 26% nuk kanë persona të përkatësisë etnike shqiptare në vendbanimin e tyre. Rastet e këtilla tek maqedonasit paraqiten më shumë në fshatra të pastra etnike sepse në mbarë rajonin e Tetovës ku dominon elementi etnik shqiptar, mundësia që mos të ketë asnjë shqiptar të vetëm në çdo pjesë të qytetit është shumë e vogël, për të mos thënë inekzistente.


Pyetja e dytë është parashtruar për të parë nivelin e njohjes së gjuhës së tjetrit me të cilin jetojmë kaq pranë por në raste edhe kaq larg.

**Graf. 2.4 A e flisni gjuhën maqedonase (Shqiptarë)**



44% e të anketuarve shqiptarë janë përgjigjur që e njohin mirë maqedonishten, 48% mesatarisht mirë kurse pjesa e mbetur prej 8% e shqiptarëve nuk e njohin maqedonishten.


**Graf. 2.4 A e flisni gjuhën shqipe (Maqedonas)**



Tek maqedonasit, vetëm 4 % e njohin mirë shqipen, 13 % mesatarisht mirë kurse një numër i lartë prej 83 % e maqedonasve të anketuar nuk e njohin fare shqipen. Kjo është sa trashëgimi nga e kaluara kur komuniteti maqedonas kishte pozitë kushtetuese dhe të autoritetit për të imponuar gjuhën e tij në përdorim të përditshëm kurse me statusin e saj inferior kushtetues, shqipja mungonte krejtësisht nga diskursi publik. Ndryshimet graduale të 20 viteve të fundit që përmirësuan statusin e shqipes, duket se nuk kanë ndikuar ose kanë ndikuar shumë pak që maqedonasit etnikë të kenë njohje të shqipes.


Pyetja e radhës ka të bëjë me preferencat e shkollarëve për gjuhën e tjetrit.

**Graf. 2.5 Cilën gjuhë tjetër preferoni për ta mësuar në shkollë? (Shqiptarë)**



93% e të pyeturve shqiptarë do preferonin një gjuhë tjetër kurse vetëm 7 % maqedonishten. Këtu duket qartë parapëlqimi i madh tek shqiptarët për një gjuhë tjetër në krahasim me maqedonishten.

**Graf. 2.5 Cilën gjuhë tjetër preferoni për ta mësuar në shkollë? (Maqedonas)**




Edhe tek të anketuarit maqedonas vërehet një distancë e theksuar nga shqipja, edhe pse pakëz më e ulët se e shqiptarëve. 87 % e tyre do preferonin një gjuhë tjetër në krahasim me 13 % që do dëshironin të mësonin shqipen në shkollë.


Pyetja në vazhdim është më shumë teknike pasi kurikulat për arsimin publik por edhe atë privat dhe me këtë edhe çështjet e gjuhëve që përdoren në sistemin arsimor, rregullohen në bazë të ligjeve në fuqi. Kështu në sistemin publik maqedonishtja në pajtim me statusin si gjuhë e vetme zyrtare në mbarë territorin e Republikës, është obligative për gjithë nxënësit e sistemit arsimor.

Kurse shqipja në pajtim me statusin e saj si gjuhë zyrtare rajonale nuk është obligative për nxënësit e përkatësive tjera etnike.

**Graf. 2.6 A mësoni gjuhën dhe letërsinë maqedonase si obligative në shkollën tuaj (Shqiptarë)**




**Graf. 2.6 A mësoni gjuhën dhe letërsinë shqipe si obligative në shkollën tuaj (Maqedonas)**




Pyetja në vazhdim është me karakter social dhe ilustron nivelin e ndërveprimit human të dy grupeve kryesore etnike.

**Graf. 2.7 A keni shokë/shoqe pjesëtarë të komuniteteve tjera etnike (Shqiptarë)**




74% e shqiptarëve të anketuar nuk kanë njohje nga grupi tjetër kurse 26 % janë përgjigjur që kanë. Tek maqedonasit shifrat variojnë nga 79% që përgjigjen me jo tek 21 % që kanë njohje shqiptare.

**Graf. 2.7 A keni shokë/shoqe pjesëtarë të komuniteteve tjera etnike (Maqedonas)**




Pyetja tjetër ka të bëjë gjithashtu me marrëdhëniet më të drejtpërdrejta njerëzore apo ndërveprimin human mes komuniteteve.

**Graf. 2.8 A frekuentoni lokale ku dominojnë të rinjtë/rejat nga komuniteti tjetër/Maqedonas ?**



Shqiptarët në masë të madhe, mbi 66 % janë përgjigjur që frekuentojnë këto lokale, pak mbi 20% që nuk i frekuentojnë ato kurse më rrallë janë përgjigjur pjesa më e vogël e të anketuarve.

**Graf. 2.8 A frekuentoni lokale ku dominojnë të rinjtë/rejat nga komuniteti tjetër/Shqiptar?**




Tek maqedonasit vihet re që përgjigjet janë diametralisht të kundërta ku mbi 80 % e tyre kanë thënë që nuk frekuentojnë lokale shqiptare, nën 20 % që frekuentojnë dhe një përqindje e vogël janë përgjigjur me rrallë.

Pyetja vijuese ka të bëjë me një çështje që shpeshherë është në qendër të vëmendjes së mediave të këtushme dhe ka të bëjë me raportet në sferën e sporteve.


**Graf. 2.9 A do kishit participuar ju personalisht në skuadra sportive maqedonase? (Shqiptarë)**





83 % e shqiptarëve kryesisht të rinj janë përgjigjur me po, kjo edhe si pasojë e statusit më të lartë social të disa klubeve maqedonase të traditës sidomos në kryeqytet dhe vetëm 17 % negativisht, që nuk do ishin bërë pjesë e kolektiveve sportive maqedonase.


**Graf. 2. 9 A do kishit participuar ju personalisht në skuadra sportive shqiptare? (Maqedonas)**



Tek maqedonasit, po ashtu përqindja e përgjigjeve pozitive në këtë pyetje është po ashtu e lartë, paradoksalisht, 86 % kurse negative vetëm 14 %.


Pyetja vijuese na kthen në realitetin e raporteve etnike në vend. Tek suporti personal që individët u japin klubeve në varësi të përkatësisë etnike, del në shesh atituda reale e të rinjve për grupin tjetër etnik.

**Graf. 3.0 A do bënit tifo për klube sportive maqedonase? (Shqiptarë)**



Kështu, një shumicë dërmuese prej 91 % e të anketuarve shqiptarë nuk do bënin tifo për klube sportive maqedonase. Vetëm 9 % do ta bënin një gjë të tillë.


**Graf. 3.0 A do bënit tifo për klube sportive shqiptare? (Maqedonas)**



Tek maqedonasit etnikë përgjigja, Jo-ja, është akoma më bindëse duke kapur 94 % e të anketuarve me një minorancë absolute prej vetëm 6 % që do kishin suportuar një skuadër sportive shqiptare. Dallimet në këtë pikë duken të mëdha.


Edhe pyetja vijuese është me natyrë emocionale dhe me qëndrime diametralisht të kundërta.

**Graf. 3.1 Për cilën kombëtare bëni tifo ju personalisht? (Shqiptarë)**




95 % e respondentëve shqiptarë në rast se do zgjidhnin mes Maqedonisë dhe Shqipërisë do bënin tifo për këtë të fundit dhe vetëm 1 % për shtetin në të cilin jetojnë. Vërehet një distancë e madhe e të rinjve shqiptarë dhe mosidentifikim gati absolut me ngjyrat e Kombëtares maqedonase.

**Graf. 3.1 Për cilën kombëtare bëni tifo ju personalisht? (Maqedonas)**




Tek maqedonasit dallimet janë edhe më të shprehura me 99 % për Maqedoninë, 1 % tjetër dhe asnjë për Shqipërinë.

**Graf. 3.2 A do pranoni të jeni pjesë e ndonjë subjekti politik maqedonas? (Shqiptarë)**



Mbi 96 % e shqiptarëve etnikë të intervistuar për qëllimin e këtij hulumtimi nuk do bëheshin pjesë e ndonjë partie politike maqedonase, me vetëm 3 % që kanë dhënë përgjigje afirmative.


**Graf 3.2 A do pranoni të jeni pjesë e ndonjë subjekti politik shqiptar? (Maqedonas)**



Tek maqedonasit etnikë dallimi është akoma më i shprehur. 98 % nuk do pranoni të jenë pjesë e ndonjë subjekti politik shqiptar dhe vetëm 2 % do e bënin një veprim të tillë. Nga këto të dhëna shihet një mosbesim i qartë tek strukturat politike të komunitetit tjetër.


Qëndrimet afrohen pak në pyetjen vijuese.

**Graf. 3.3 A do kishit votuar për një kandidat maqedonas si deputetin tuaj në zgjedhjet parlamentare? (Shqiptarë)**




28 % e shqiptarëve edhe mund të votojnë për një kandidat maqedonas si deputet të tyrin në zgjedhje të përgjithshme, kurse 72 % nuk do kishin votuar për një kandidat të tillë.

**Graf. 3.3 A do kishit votuar për një kandidat shqiptar si deputetin tuaj në zgjedhjet parlamentare? (Maqedonas)**




Tek maqedonasit refuzimi vjen më i qartë. 83 % prej tyre nuk do kishin votuar një kandidat shqiptar si deputet të tyrin, me vetëm 17 % që do e bënë një zgjedhje të tillë politike.

**Graf 3.4 A do ishit martuar me maqedonas/maqedonase etnik? (Shqiptarë)**




Në këtë pyetje me ngarkesë emocionale ku ndërhyjnë faktorë të shumtë si personalë ashtu edhe kulturorë, identitarë etj, përgjigjet e dhëna janë krejtësisht refuzuese. Këtu vërehet më qartë se në çdo pyetje tjetër distanca e madhe etnike, kulturore, botëkuptimore mes maqedonasve dhe shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut. 99 % e shqiptarëve dhe 98 % e maqedonasve nuk do ishin martuar me një pjesëtar nga komuniteti tjetër. Grupet pra jetojnë pranë njëri-tjetrit, por jo me njëri-tjetrit.

**Graf. 3.4 A do ishit martuar me shqiptar/shqiptare etnik? (Maqedonas)**




**Graf. 3.5 Çfarë mendimi keni për popullin dhe kulturën maqedonase përgjithësisht? (Shqiptarë)**




Vetëm 13 % e respondentëve shqiptarë kanë mendim pozitiv për popullin maqedonas. Neutrale është shumica dërmuese prej 63 % kurse me qëndrim jo edhe aq të mirë janë 24 %. Tek maqedonasit shifrat janë akoma më shqetësuese me 45 % që kanë një mendim jo edhe aq të mirë për shqiptarët, 35% neutralë dhe vetëm 20 % me qëndrime pozitive ndaj popullit dhe kulturës shqiptare.

**Graf. 3.5 Çfarë mendimi keni për popullin dhe kulturën shqiptare përgjithësisht? (Maqedonas)**




**Graf. 3.6 A u besoni përgjithësisht institucioneve shtetërore në Maqedoni? (Shqiptarë)**




Teza që kemi dhënë në tekst, që shumica maqedonase e percepton, e ndjen dhe e sheh në një kuptim shtetin si të vetin kurse shqiptarët nuk e ndjejnë si të tyrin, vërtetohet nga të dhënat në vijim në lidhje me besimin në institucionet shtetërore. Vetëm 12 % e shqiptarëve besojnë në këto institucione, përkundrajt 52 % të maqedonasve etnikë. Nga ana tjetër. Vetëm 18 % e maqedonasve nuk u besojnë organeve të shtetit por mbi 70 % e shqiptarëve nuk besojnë tek to. 18 % e të anketuarve shqiptarë besojnë shumë pak tek institucionet kurse 30 % e maqedonasve.

**Graf 3.6 A u besoni përgjithësisht institucioneve shtetërore në Maqedoni? (Maqedonas)**






**Graf. 3.7 A mendoni që në Maqedoni ka diskriminim në baza etnike? (Shqiptarë)**




E njëjta diskrepancë që vërteton tezën e mosbesimit të thellë etnik dhe qëndrimeve shumë të ndryshme për realitetet e marrëdhënieve ndëretnike apo për mënyrën e funksionimit të shtetit, vërehet nga përgjigjet në lidhje me ekzistencën ose jo të diskriminimit etnik në republikë. 80 % e shqiptarëve shprehen që një diskriminim i tillë ekziston me nëntekstin e qartë që ata vetë janë viktima në këtë rast e një shteti të kontrolluar përgjithësisht nga grupi etnik maqedonas. Një pakicë prej 20 % e shqiptarëve nuk sheh të këtë diskriminim të tillë në vend. Këtë diskriminim nuk e shohin as 83 % e respondentëve maqedonas, ndërsa vetëm 17 % prej tyre pranojnë të këtë padrejtësi të tilla etnike. Qëndrimet janë shumë të ndryshme dhe që këtu fillon mosbesimi ndërkomunitar dhe tensionimi latent dhe i përhershëm i marrëdhënieve ndëretnike, për të cilin flasin si autorët e huaj ashtu edhe institucionet ndërkombëtare.

**Graf. 3.7 A mendoni që në Maqedoni ka diskriminim në baza etnike? (Maqedonas)**




Për të sqaruar çështjen kemi përpiluar dy pyetjet vijuese që janë edhe më të drejtpërdrejta.

**Graf 3.8 A ka dominancë nga grupi më i madh etnik maqedonas ndaj atij më të vogël shqiptar? (Shqiptarë)**




90 % e shqiptarëve në një vijë logjike me qëndrimet e mësipërme pohojnë që ka një dominancë ndaj tyre. 10 % e shqiptarëve nuk shohin dominancë maqedonase në shoqëri. 95 % e maqedonasve nga ana tjetër nuk shohin të ketë dominancë maqedonase përkundër 5 % që pohojnë këtë.

**Graf 3.8 A ka dominancë nga grupi më i madh etnik Maqedonas ndaj atij më të vogël shqiptar? (Maqedonas)**




**Graf. 3.9 Në cilin sektor mendoni që ka më së shumti diskriminim në baza etnike?  
(Shqiptarë)**




Në lidhje me pyetjen në cilin sektor ka më shumë diskriminim në baza etnike, qëndrimet janë në vijë me ato më lartë. 18 % e shqiptarëve japin sektorin privat kurse 82 % atë publik/shtetëror si mjedisin me më shumë diskriminim etnik. Tek maqedonasit shifrat përmbysen plotësisht ku afër 80 % e tyre japin sektorin privat si vend ku ekziston diskriminimi etnik dhe vetëm 20 % atë shtetëror. Në këto shifra duket ndikon fakti që pjesa më e madhe e sektorit privat në Tetovë është në pronësi të shumicës së popullsisë, d.m.th. shqiptarëve.

**Graf.3.9 Në cilin sektor mendoni që ka më së shumti diskriminim në baza etnike?  
(Maqedonas)**




**Graf. 4.0 A mendoni se marrëdhëniet ndëretnike në një të ardhme të afërt mund të përkeqësohen dhe të çojnë në konflikt të hapur? (Shqiptarë)**




67 % e shqiptarëve duke ndjerë se janë të diskriminuar mendojnë se ekziston mundësia e një konflikti ndëretnik dhe ky skenar është i afërt, 33 % nuk besojnë në përkeqësim dhe konflikt ndëretnik. Tek maqedonasit që këtu ndjehen në pozita më komode vetëm 22 % e shohin një mundësi të tillë në një të ardhme të afërt, 78 % nuk ndajnë mendim .

**Graf. 4.0 A mendoni se marrëdhëniet ndëretnike në një të ardhme të afërt mund të përkeqësohen dhe të çojnë në konflikt të hapur? (Maqedonas)**




**Graf. 4.1 Mendoni që mundësia e ndarjes së vendit në baza etnike është akoma sot reale? (Shqiptarë)**




Në të njëjtën vijë mendimi, 71 % e shqiptarëve mendon që mundësia e ndarjes etnike akoma sot është reale, kurse 29 % nuk besojnë në një skenar të tillë. 72 % e maqedonasve nuk e mendojnë një gjë të tillë si reale. Vetëm 28 % besojnë që ekziston një mundësi e tillë.

**Graf. 4.1 Mendoni që mundësia e ndarjes së vendit në baza etnike është akoma sot reale? (Maqedonas)**




**Graf. 4.2 Mendoni që anëtarësimi i Maqedonisë së Veriut në BE dhe në NATO do të ulë tensionet etnike në vend? (Shqiptarë)**




